

STANDARDI NDERKOMBETAR I MENAXHIMIT TË CILESISE 1**MENAXHIMI I CILËSISË PËR FIRMAT që KRYEJNË AUDITIME OSE RISHIKIME të PASQYRAVE
FINANCIARE, OSE SIGURI të TJERA APO ANGAZHIME të SHËRBIMEVE të LIDHURA**

(Hyn në fuqi me datën 15 Dhjetor 2022)

PERMBAJTJA	
	Paragrafi
Hyrje	
Objekti i këtij SNMC	1-5
Sistemi i menaxhimit të cilësisë së firmës	6-11
Autoriteti i këtij SNMC	12
Hyrja në fuqi	13
Objektivi	14-15
Përkufizimet	16
Kërkesat	
Zbatimi dhe pajtueshmëria me kërkesat përkatëse	17-18
Sistemi i menaxhimit të cilësisë	19-22
Procesi i vlerësimit të rrezikut të firmës	23-27
Qeverisja dhe lidërsia	28
Kërkesat përkatëse etike	29
Pranimi dhe vazhdimi i marrëdhënieve me klientin dhe angazhimet specifike	30
Performanca (kryerja) e angazhimit	31
Burimet	32
Informacioni dhe komunikimi	33
Reagimet specifike	34
Monitorimi dhe procesi i korrigjimit të mangësive	35-47
Kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit	48-52
Vlerësimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë	53-56
Dokumentimi	57-60
Zbatimi dhe materiali tjetër shpjegues	
Objekti i këtij SNMC	A1-A2
Sistemi i menaxhimit të cilësisë së firmës	A3-A5
Autoriteti i këtij SNMC	A6-A9
Përkufizimet	A10-A28
Zbatimi dhe pajtueshmëria me kërkesat përkatëse	A29
Sistemi i menaxhimit të cilësisë	A30-A38
Procesi i vlerësimit të rrezikut të firmës	A39-A54
Qeverisja dhe lidërsia	A55-A61
Kërkesat përkatëse etike	A62-A66
Pranimi dhe vazhdimi i marrëdhënieve me klientin dhe angazhimet e veçanta	A67-A74

Performanca (kryerja) e angazhimit	A75-A85
Burimet	A86-A108
Informacioni dhe komunikimi	A109-A115
Reagimet specifike	A116-A137
Monitorimi dhe procesi i korrigjimit të mangësive	A138-A174
Kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit	A175-A186
Vlerësimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë	A187-A201
Dokumentimi	A202-A206

Standardi ndërkombëtar për menaxhimin e cilësisë (SNMC) 1, Menaxhimi i cilësisë për firmat që kryejnë auditime ose rishikime të pasqyrave financiare ose angazhime të sigurive të tjera apo të shërbimeve të lidhura, duhet të lexohet i lidhur ngushte me Parathënien për Deklaratat Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë, Auditimit, Rishikimit, Sigurive të tjera dhe Shërbimeve të Lidhura,

Hyrje

Objekti i këtij SNMC

- Standardi ndërkombëtar i menaxhimit të cilësisë (SNMC) trajton përgjegjësitë e firmave për të hartuar, zbatuar dhe venë në funksionim një sistem të menaxhimit të cilësisë për auditimet ose rishikimet e pasqyrave financiare apo angazhime të sigurive të tjera dhe të shërbimeve të lidhura.
- Rishikimet e cilësisë së angazhimit janë pjesë përbërëse e sistemit të menaxhimit të cilësisë së firmës dhe:
 - Ky SNMC trajton përgjegjësinë e firmës për të vendosur politika ose procedura për të adresuar angazhimet që kërkohet t'i nënshtrohen rishikimeve për cilësinë e angazhimit.
 - SNMC 2 trajton caktimin dhe kriteret për rishikuesin e cilësisë së angazhimit dhe performancën e dokumentimin e rishikimit të cilësisë së angazhimit.
- Deklarimet e tjera të Bordit të standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe të sigurisë (BSNAS):
 - Mbajnë parasysh faktin që firma i nënshtrohet SNMC-ve ose kërkesave kombëtare, të cilat mund të jenë me shume kërkuese¹; dhe
 - Përfshijnë kërkesa që duhet të përmbushin partnerët e angazhimit dhe anëtarët e tjerë të grupit të angazhimit në lidhje me menaxhimin e cilësisë në nivel angazhimi. Për shembull, SNA 220 (i rishikuar) trajton përgjegjësitë e veçanta të audituesit në lidhje me menaxhimin e cilësisë në nivel të një auditimi të pasqyrave financiare dhe përgjegjësitë përkatëse të partnerit të angazhimit. (Ref: Para. A1) 4.

¹ SNMC 2 Rishikimet e cilësisë së angazhimit.

Shiko për shembull, paragrafin 3, të Standardit ndërkombëtar të auditimit (SNA) 220 (i rishikuar), *Menaxhimi i cilësisë për një auditim të pasqyrave financiare* (i rishikuar)

4. Ky SNMC duhet të lexohet i lidhur ngushtë me kërkesat përkatëse etike. Ligji, rregulli ose kërkesat përkatëse etike mund të përcaktojnë përgjegjësi të tjera për menaxhimin e cilësisë së firmës, të cilat shkojnë përtej përgjegjësisë që përshkruhen në këtë SNMC. (Ref: Para. A2)
5. Ky SNMC zbatohet nga të gjitha firmat që kryejnë auditime ose rishikime të pasqyrave financiare, apo angazhime të tjera të sigurisë ose shërbime të lidhura (d.m.th., ky SNMC do të zbatohet nëse firma kryen ndonjë nga këto angazhime dhe sistemi i menaxhimit të cilësisë, i vendosur në pajtim me kërkesat e këtij SNMC, bën të mundur që për të gjithë angazhimet, performanca e firmës të jetë njëjtë (koherente))

Sistemi i menaxhimit të cilësisë së firmës

6. Një sistem i menaxhimit të cilësisë funksionon në mënyrë të vazhdueshme dhe përsëritëse dhe i përgjigjet ndryshimeve në natyrën dhe rrethanat e firmës dhe angazhimet të saj. Ai nuk funksionon në mënyrë lineare. Megjithatë, për qëllimet e këtij SNMC-je, një sistem i menaxhimit të cilësisë adreson tetë elementët e mëposhtëm: (Ref: Para. A3)
 - (a) Procesin e vlerësimit të rrezikut të firmës;
 - (b) Qeverisjen dhe lidhësin;
 - (c) Kërkesat përkatëse etike
 - (d) Pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientin dhe angazhimet specifike;
 - (e) Performancën e angazhimit;
 - (f) Burimet;
 - (g) Informacionin dhe komunikimin; dhe
 - (h) Procesin e monitorimit dhe të korrigjimit të mangësive.
7. Ky SNMC kërkon që firma të zbatojë një metodë të bazuar në rrezik për hartimin, zbatimin dhe funksionimin e elementëve të sistemit të menaxhimit të cilësisë në një mënyrë të ndërlidhur dhe të koordinuar të atillë që firma të menaxhojë në mënyrë pro aktive cilësinë e angazhimeve të kryera prej saj. (Ref: Para. A4)
8. Metoda e bazuar në rrezik është trupëzuar në kërkesat e këtij SNMC, nëpërmjet:
 - (a) Përcaktimit të objektivave të cilësisë. Objektivat e cilësisë të vendosura nga firma konsistojnë në objektiva, të lidhura me përbërësit e sistemit të menaxhimit të cilësisë, që duhet të arrihen nga firma. Firma kërkohet të vendosë objektivat për cilësinë të cilat janë specifikuar në këtë SNMC, si edhe objektiva shtesë të cilësisë, të cilat konsiderohen prej saj të nevojshme për të arritur objektivat e sistemit të menaxhimit të cilësisë.
 - (b) Identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve për arritjen e objektivave të cilësisë (të referuara në këtë standard si rreziqe të cilësisë). Firma kërkohet të identifikojë dhe vlerësojë rreziqet e cilësisë për të patur një bazë për hartimin dhe zbatimin e përgjigjeve/reagimeve.

(c) Hartimit dhe zbatimit të reagimeve (përgjigjeve) për të adresuar rreziqet e cilësisë. Natyra, afatet dhe shtrirja e reagimeve të firmës për të adresuar rreziqet e cilësisë janë bazuar dhe janë reaguese të saj ndaj arsyeve për vlerësimet e dhëna për rreziqet e cilësisë.

9. Ky SNMC kërkon që, të paktën çdo vit, individët, të cilët kanë përgjegjësinë përfundimtare dhe japin llogari për sistemin e menaxhimit të cilësisë, duhet, në emër të firmës, të vlerësojnë sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe të konkludojnë nëse sistemi i menaxhimit të cilësisë e pajis firmën me sigurinë e arsyeshme se janë arritur objektivat e sistemit të dhëna në paragrafin 14 (a) dhe (b),. (Ref: Para. A5)

Zbatimi i shkallëzuar

10. Kur zbaton një metodë të bazuar në rrezik, firma kërkohet të mbajë parasysh:

- (a) Natyrën dhe rrethanat e firmës; dhe
- (b) Natyrën dhe rrethanat e angazhimeve të kryera nga firma.

Për rrjedhojë, do të ndryshojë forma e sistemit të menaxhimit të cilësisë së firmës dhe në veçanti, kompleksiteti dhe formaliteti i tij. Për shembull, një firmë që kryen lloje të ndryshme angazhimesh për një gamë të gjerë entitetesh, përfshirë auditimet e pasqyrave financiare të entiteteve të listuara, ka të ngjarë të ketë nevojë për një sistem më kompleks dhe më të formalizuar të menaxhimit të cilësisë dhe dokumentimin mbështetës, se sa një firmë që kryen vetëm rishikime të pasqyrave financiare ose angazhime për të hartuar pasqyrat financiare.

Rrjetet dhe ofruesit e shërbimeve

11. Ky SNMC adreson përgjegjësitë e firmës, kur kjo e fundit:

- (a) I përket një rrjeti dhe firma zbaton kërkesat e rrjetit ose përdor shërbimet e rrjetit në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë apo në kryerjen e angazhimeve, ose
- (b) Përdor burimet e një ofruesi shërbimesh në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë ose në kryerjen e angazhimeve

Edhe nëse firma zbaton kërkesat e rrjetit ose përdor shërbimet e rrjetit apo burimet e një ofruesi të shërbimeve, firma e ka vetë përgjegjësinë për sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë

Autoriteti i këtij SNMC

12. Paragrafi 14 përmban objektivin e firmës në lidhje me zbatimin e këtij SNMC. Ky SNMC përmban: (Ref: Para. A6)

- (a) Kërkesat, të cilat synojnë t'i japin mundësi firmës të plotësojë objektivat e dhëna në paragrafin 14; (Ref: Para. A7)

- (b) Udhëzimin përkatës në formën e materialit për zbatim dhe shpjegimet përkatëse ; (Ref: Para. A8)
- (c) Materialin hyrës që jep kontekstin për të kuptuar siç duhet këtë SNMC; dhe
- (d) Përkufizimet. (Ref: Para. A9)

Hyrja në fuqi

13. Sistemet e menaxhimit të cilësisë sipas këtij SNMC kërkohet të hartohen dhe të zbatohen duke filluar nga data 15 Dhjetor 2022, dhe vlerësimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë, i kërkuar nga paragrafët 53–54 të këtij SNMC, duhet të bëhet brenda një viti nga data 15 Dhjetor 2022, që është data e hyrjes në fuqi.

Objektivi

14. Objektivi i firmës është të hartojë, zbatojë dhe verë në funksionim një sistem të menaxhimit të cilësisë për auditimet ose rishikimet e pasqyrave financiare, angazhimet e tjera të sigurisë apo shërbimet e lidhura të kryera nga firma, i cili i jep firmës një siguri të arsyeshme se:
- (a) Firma dhe personeli i saj përmbushin përgjegjësitë e tyre në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, dhe kryejnë angazhimet në përputhje me këto standarde dhe kërkesa; dhe
 - (b) Raportet e angazhimit të lëshuara nga firma ose partnerët e angazhimit janë të përshtatshme për rrethanat.
15. Interesit publik i shërbehet përmes kryerjes në vazhdimësi dhe me koherencë të angazhimeve cilësore. Hartimi, zbatimi dhe vënia në funksionim e sistemit të menaxhimit të cilësisë bën të mundur kryerjen në vazhdimësi të angazhimeve cilësore, pasi i jep firmës sigurinë e arsyeshme se janë arritur objektivat e sistemit të menaxhimit të cilësisë, të përcaktuara në paragrafin 14 (a) dhe (b). Angazhimet cilësore arrihen përmes planifikimit dhe kryerjes së angazhimeve dhe raportimit mbi to në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Arritja e objektivave të këtyre standardeve dhe respektimi e zbatimi i kërkesave të ligjeve dhe rregullave të zbatueshme përfshin ushtrimin e gjykit profesional dhe, kur është e zbatueshme, në varësi të llojit të angazhimit, ushtrimin e skepticizmit profesional.

Përkufizimet

16. Për qëllime të këtij SNMC, termat në vijim kanë këto kuptime:
- (a) Mangësi në sistemin e menaxhimit të cilësisë të firmës (referuar në këtë SNMC si “mangësi”)- Kjo ekziston kur: (Ref. Para. A10, A159-A160)
 - (i). Nuk është përcaktuar një objektivi i cilësisë që kërkohet për të arritur objektivin e sistemit të menaxhimit të cilësisë;

- (ii). Nuk është identifikuar ose vlerësuar siç duhet një rrezik i cilësisë, ose një kombinim i rreziqeve të cilësisë; (Ref: Para A11)
 - (iii). Një reagim ose kombinim i reagimeve nuk e zvogëlon në një nivel të ulët të pranueshëm mundësinë që një rrezik i lidhur me cilësinë të ndodhë, sepse reagimi ose përgjigja (et) nuk është hartuar siç duhet, nuk zbatohet apo nuk ka funksionuar në mënyrë efektive; ose
 - (iv). Mungon një aspekt tjetër i sistemit të menaxhimit të cilësisë, ose nuk është hartuar në mënyrën e duhur, nuk zbatohet apo nuk ka funksionuar në mënyrë efektive, në atë shkallë sa që një kërkesë e këtij SNMC nuk është adresuar. (Ref: Para. A12)
- (b) Dokumentimi i angazhimit - Regjistrimi i punës së kryer, rezultateve të arritura dhe përfundimeve që profesionisti kontabël ka arritur (shpesh here përdoren termat "dokumente të punës" ose "letra pune")
 - (c) Partneri i angazhimit² – Partneri ose individët e tjerë, të emëruar nga firma, i cili ka përgjegjësinë për angazhimin dhe performancën e tij dhe për raportin që lëshohet në emër të firmës, dhe kur kërkohet, ka autorizimin (njohjen) e duhur nga një organizëm profesional, ligjor ose rregullator.
 - (d) Rishikimi i cilësisë së angazhimit - Një vlerësim objektiv i gjykimeve të rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit dhe i përfundimeve të arritura prej tyre, i kryer nga rishikuesi i cilësisë së angazhimit dhe i përfunduar në datën e raportit të angazhimit ose para kësaj date.
 - (e) Rishikuesi i cilësisë së angazhimit - Një partner, një individ tjetër në firmë, ose një individ i jashtëm, i emëruar nga firma për të kryer rishikimin e cilësisë së angazhimit.
 - (f) Grupi i angazhimit - Të gjithë partnerët dhe stafi, të cilët kryejnë angazhimin, dhe çdo individ tjetër që kryen procedura për angazhimin, duke përjashtuar një ekspert të jashtëm³ dhe audituesit e brendshëm, të cilët japin ndihmë të drejtpërdrejtë në një angazhim. (Ref: Para. A13)
 - (g) Inspektimet e jashtme - Inspektimet ose investigimet e ndërmarra nga një autoritet mbikëqyrës i jashtëm, në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë të firmës ose për angazhimet e kryera nga firma. (Ref: Para. A14)
 - (h) Gjetjet (në lidhje me një sistem të menaxhimit të cilësisë) - Informacionet në lidhje me formën, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, të cilat janë akumuluar nga kryerja e aktiviteteve monitoruese, të inspektimeve të jashtme dhe nga burime të tjera përkatëse, që tregojnë se mund të ekzistojë një ose më shumë mangësi. (Ref: Para. A15 – A17)

² "Partneri i angazhimit" dhe "partnerët" duhet të lexohen me reference edhe në sektorin publik kur kjo është e mundur.

³ Përkufizimi i termit eksperti i audituesit është dhënë në SNA 620, *Përdorimi i punës së një eksperti të audituesit*, paragrafi 6(a)

- (i) Firmë - Një profesionist person fizik, partneritet ose korporatë apo entitet tjetër i profesionistëve kontabël ose ekuivalentët e tyre në sektorin publik. (Ref: Para. A18)
- (j) Entitet i listuar - Një entitet, pjesët, aksionet ose borxhi i të cilit janë të kuotuar ose të listuar në një burse të njohur apo tregtohen sipas rregulloreve të një burse të njohur ose një organi tjetër ekuivalent
- (k) Firmë rrjet - Një firmë ose entitet që i përket rrjetit të firmës.
- (l) Rrjeti - Një strukturë e madhe, e cila: (Ref: Para. A19)
 - (i) ka si qëllim bashkëpunimin; dhe
 - (ii) qartësisht synon arritjen e fitimit ose ndarjen e kostos apo pronësinë e përbashkët të aksioneve, kontrollit ose menaxhimit, politikat ose procedurat e zakonshme të menaxhimit të cilësisë, strategji biznesi të përbashkët, përdorimin e një emri të njëjtë (brand) ose një pjesë të rëndësishme të burimeve profesionale.
- (m) Partner - Çdo individ që ka autoritetin të angazhojë firmën për kryerjen e një angazhimi të shërbimeve profesionale.
- (n) Personeli - Partnerët dhe stafi në firmë. (Ref: Para. A20 – A21)
- (o) Gjykimi profesional - Aplikimi i trajnimit, njohurive dhe përvojës përkatëse, brenda kontekstit të standardeve profesionale, për marrjen e vendimeve të informuara në lidhje me drejtimit e veprimit, të cilat janë të përshtatshme për hartimin, zbatimin dhe vënin në funksionim të sistemit të menaxhimit të cilësisë së firmës.
- (p) Standarde profesionale - Standardet e angazhimit të IAASB, siç janë përkufizuar në *Parathënien e IAASB-së, për deklaratat ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë, auditimit, rishikimit, sigurive të tjera e të shërbimeve të lidhura*, dhe kërkesat përkatëse etike.
- (q) Objektivat e cilësisë - Rezultatet e dëshiruara në lidhje me përbërësit e sistemit të menaxhimit të cilësisë që duhet të arrihen nga firma.
- (r) Rreziku i cilësisë - Një rrezik që ka një mundësi të arsyeshme të:
 - (i) Ndodhjes; dhe
 - (ii) Individualisht, ose në kombinim me rreziqe të tjera, ndikon negativisht në arritjen e një ose më shumë objektive të cilësisë.
- (s) Siguri e arsyeshme - Në kontekstin e SNMC-ve, një nivel i lartë, por jo absolut, i sigurisë.
- (t) Kërkesat përkatëse etike - Parimet e etikës profesionale dhe kërkesat etike që janë të zbatueshme për profesionistët kontabël, kur ata ndërmarrin angazhime që janë auditime ose rishikime të

pasqyrave financiare ose angazhimeve të tjera të sigurisë apo të shërbimeve të lidhura. Kërkesat përkatëse etike zakonisht përfshijnë dispozitat e Kodit IESBA në lidhje me auditimet, rishikimet e pasqyrave financiare ose angazhimet e sigurive të tjera apo të shërbimeve të lidhura, së bashku me kërkesat kombëtare që janë më kufizuese (shtrënguese). (Ref: Para. A22 – A24, A62)

(u) Përgjigja/reagimi (në lidhje me një sistem të menaxhimit të cilësisë) - Politikat ose procedurat e hartuara dhe të zbatuara nga firma për të adresuar një ose më shumë rreziqe të cilësisë: (Ref: Para. A25 – A27, A50)

(i) Politikat janë deklarata që tregojnë se çfarë duhet ose çfarë nuk duhet të bëhet për të adresuar një rrezik të cilësisë. Këto deklarata mund të dokumentohen, të deklarohen shprehimisht në komunikime ose të bëhen detyruese nëpërmjet veprimeve dhe vendimeve.

(ii) Procedurat janë veprime që kryhen për të zbatuar politikat.

(v) Ofruesi/dhënësi i shërbimit (në kontekstin e këtij SNMC) - Një individ ose organizatë e jashtme për firmën, i cili jep një burim që përdoret në sistemin e menaxhimit të cilësisë ose në kryerjen e angazhimeve. Ofruesit e shërbimeve përjashtojnë rrjetin e firmës, firmat e tjera të rrjetit ose strukturat apo organizatat e tjera në rrjet. (Ref: Para. A28, A105)

(w) Stafi - Profesionistët, të ndryshëm nga partnerët, përfshirë çdo ekspert që angazhon firma.

(x) Sistemi i menaxhimit të cilësisë - Një sistem i hartuar, zbatuar dhe vene në funksionim nga një firmë për ta pajisur firmën me sigurinë e arsyeshme që:

(i) Firma dhe personeli i saj përmbushin përgjegjësitë e tyre në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore e rregullatore, dhe kryejnë angazhimet në përputhje me këto standarde dhe kërkesa; dhe

(ii) Raportet e angazhimit të lëshuara nga firma ose partnerët e angazhimit janë të përshtatshme në rrethanat përkatëse.

Kërkesat

Zbatimi dhe pajtueshmëria me kërkesat përkatëse

17. Firma do të zbatojë çdo kërkesë të këtij SNMC, përveç nëse kërkesa nuk ka lidhje me firmën, për shkak të natyrës dhe rrethanave të firmës dhe angazhimeve të saj (Ref: Para A29)

18. Individ (individët) të cilit i është caktuar përgjegjësia përfundimtare dhe llogaridhënia për sistemin e menaxhimit të cilësisë së firmës dhe individ apo individët, që kanë përgjegjësinë për zbatimin e sistemit e menaxhimit të cilësisë së firmës, duhet të njohin objektivin e këtij SNMC, përfshirë pjesën e zbatimit dhe materialin shpjegues të standardit dhe të dinë të zbatojnë kërkesat në mënyrën e duhur.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë

19. Firma do të hartojë, zbatojë dhe vere në funksionim një sistem të menaxhimit të cilësisë. Për të bere këtë, firma do të ushtrojë gjykimin profesional, të mbaje parasysh natyrën dhe rrethanat e firmës dhe angazhimet e saj. Komponenti i qeverisjes dhe lidhsipit, i sistemit të menaxhimit të cilësisë, krijon mjedisin që mbështet hartimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë. (Ref: Para. A30 – A31)

Përgjegjësitë

20. Firma do të caktojë: (Ref: Para. A32 – A35)
- (a) drejtorin ekzekutiv ose partnerin drejtues të firmës (apo ekuivalentin e tij) ose, nëse është e përshtatshme, bordin e partnereve drejtues (ose ekuivalentin e tyre) të firmës, me përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë;
 - (b) Përgjegjësitë për funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë;
 - (c) Përgjegjësitë për funksionimin e aspekteve të veçanta të sistemit të menaxhimit të cilësisë, përfshirë:
 - (i) Pajtueshmëria me kërkesat e pavarësisë; dhe (Ref: Para. A36)
 - (ii) Procesin e monitorimit dhe korrigjimit të mangësive.
21. Ne caktimin e individëve në rolet që kërkohen në paragrafin 20, firma do të mbaje parasysh që individ (et): (Ref: Para. A37)
- (a) të kenë eksperiencën e nevojshme, njohuritë, ndikimin dhe autoritetin brenda firmës dhe kohë të mjaftueshme, për të përmbushur përgjegjësinë e caktuar; dhe (Ref: Para. A38)
 - (b) te kuptojnë rolet që ju janë caktuar dhe faktin që janë përgjegjës për përmbushjen e tyre.
22. Firma do të përcaktojë që individ (ët) të cilit i është caktuar përgjegjësia për funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, pajtueshmërisë me kërkesat e pavarësisë dhe procesin e monitorimit dhe korrigjimit të mangësive, kanë një linjë të drejtpërdrejtë të komunikimit me individin (at) e caktuar me përgjegjësinë përfundimtar dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë.

Procesi i vlerësimit të rrezikut të firmës

23. Firma do të hartojë dhe zbatojë një proces të vlerësimit të rrezikut për të përcaktuar objektivat e cilësisë, identifikojë dhe vlerësojë rreziqet e cilësisë dhe hartojë e zbatojë reagimet/përgjigjet për të adresuar rreziqet e cilësisë (Ref: Para. A37-A41)
24. Firma do të vendosë objektivat e cilësisë të specifikuar nga ky SNMC dhe ndonjë objektiv tjetër shtesë për cilësinë, i konsideruar prej saj i nevojshëm për të arritur objektivat e sistemit të menaxhimit të cilësisë. (Ref: Para. A42 – A44)

25. Firma do të identifikojë dhe vlerësojë rreziqet e cilësisë për të patur një bazë për hartimin dhe zbatimin e reagimeve. Duke vepruar në këtë mënyrë, firma do të:

(a) Siguroje njohjen dhe kuptimin e kushteve, ngjarjeve, rrethanave, veprimeve ose mosveprimeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të cilësisë, përfshirë: (Ref: Para. A45–A47)

(i) Në lidhje me natyrën dhe rrethanat e firmës, çështjet që kanë të bëjnë me:

- a. Kompleksitetin dhe karakteristikat e funksionimit të firmës;
- b. Vendimet dhe veprimet strategjike dhe të funksionimit, proceset e biznesit dhe modelin e biznesit të firmës;
- c. Karakteristikat dhe stilin e menaxhimit të lidërsipit;
- d. Burimet e firmës, përfshirë burimet e siguruara nga ofruesit e shërbimeve;
- e. Ligjin, rregullat, standardet profesionale dhe mjedisin në të cilin operon firma; dhe
- f. Në rastin e një firmë që i përket një rrjeti, natyrën dhe shtrirjen e kërkesave të rrjetit dhe shërbimet e rrjetit, nëse ka.

(ii) Në lidhje me natyrën dhe rrethanat e angazhimeve të kryera nga firma, çështjet që kanë të bëjnë me:

- a. Llojet e angazhimeve të kryera nga firma dhe raportet që do të lëshohen; dhe
- b. Llojet e entiteteve për të cilat janë ndërmarrë këto angazhime.

(b) Mbajë parasysh mënyrën dhe shkallën në të cilën, kushtet, ngjarjet, rrethanat, veprimet ose mosveprimet në paragrafin 25 (a) mund të ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të cilësisë. (Ref: Para. A48)

26. Firma do të hartojë dhe zbatojë reagimet/përgjigjet për të adresuar rreziqet e cilësisë në një mënyrë është e bazuar dhe, reaguese, ndaj arsyeve të vlerësimeve të dhëna për rreziqet e cilësisë. Reagimet e firmës do të përfshijnë gjithashtu, përgjigjet e specifikuar në paragrafin 34. (Ref: Para. A49 – A51)

27. Firma do të vendose politika ose procedura që kanë si synim të identifikojnë informacionin që tregon objektivat shtesë të cilësisë ose rreziqet të cilësisë apo reagime shtesë ose të modifikuara, që janë të nevojshme për shkak të ndryshimeve në natyrën dhe rrethanat e firmës ose angazhimet e saj. Kur identifikohet një informacion i tillë, firma do të shqyrtojë informacionin dhe, kur është e përshtatshme: (Ref: Para. A52 – A53)

(a) Vendos objektiva shtesë të cilësisë ose modifikon objektivat shtesë të cilësisë të vendosura nga firma; (Ref: Para. A54)

(b) Identifikon dhe vlerëson rreziqet shtesë të cilësisë, modifikon ose rivlerëson rreziqet e cilësisë; ose

(c) Harton dhe zbaton reagime/ përgjigje shtesë, ose modifikon përgjigjet/reagimet.

Qeverisja dhe lidërsipi

28. Firma do të vendosë objektivat e mëposhtme për cilësisë, që adresojnë qeverisjen dhe lidërshtipin e firmës, të cilat krijojnë mjedisin që mbështet sistemin e menaxhimit të cilësisë:
- (a) Firma demonstroi një angazhim ndaj cilësisë përmes një kulture që ekziston në të gjithë firmën, e cila pranon dhe përforcon: (Ref: Para. A55 – A56)
 - (i). Rolin e firmës në shërbim të interesit publik duke kryer vazhdimisht angazhime cilësore;
 - (ii). Rëndësinë e etikës profesionale, vlerave dhe qëndrimeve;
 - (iii). Përgjegjësinë e të gjithë personelit për cilësinë që lidhet me kryerjen e angazhimeve ose aktiviteteve brenda sistemit të menaxhimit të cilësisë, dhe sjelljen e tyre e pritshme; dhe
 - (iv). Rëndësinë e cilësisë në vendimet dhe veprimet strategjike të firmës, përfshirë prioritetet financiare dhe operacionale të firmës.
 - (b) Lidërshtipi është përgjegjës dhe jep llogari (është llogaridhënës) për cilësinë. (Ref: Para. A57)
 - (c) Lidërshtipi demonstroi një angazhim ndaj cilësisë përmes veprimeve dhe sjelljeve të tij. (Ref: Para A58)
 - (d) Struktura organizative dhe caktimi i roleve, përgjegjësi dhe i autoritetit është i përshtatshëm për të mundur hartimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së firmës. (Ref: Para. A32, A33, A35, A59)
 - (e) Nevojat për burime, përfshirë burimet financiare, janë planifikuar dhe burimet janë siguruar, alokuar ose caktuar në përputhje me angazhimin e firmës për cilësinë. (Ref: Para A60 – A61)

Kërkesat përkatëse etike

29. Firma do të vendosë objektivat e mëposhtëm të cilësisë, që adresojnë përmbushjen e përgjegjësi në përputhje me kërkesat përkatëse etike, përfshirë ato që lidhen me pavarësinë: (Ref: Para A62 – A64, A66)
- (a) Firma dhe personeli i saj:
 - (i). Kuptojnë kërkesat përkatëse etike të cilave duhet t'i nënshtrohet firma dhe angazhimet e firmës; dhe (Ref: Para. A22, A24)
 - (ii). Përmbushin përgjegjësitë e tyre në lidhje me kërkesat përkatëse etike që duhet t'i nënshtrohet firma dhe angazhimet e firmës;
 - (b) Të tjerët, përfshirë rrjetin, firmat e rrjetit, individët në rrjet ose firmat e rrjetit, apo ofruesit e shërbimeve, të cilët i nënshtrohen kërkesave përkatëse etike, të cilave ju nënshtrohet firma dhe angazhimet e firmës:
 - (i). Kuptojnë kërkesat përkatëse etike që zbatohen ndaj tyre; dhe (Ref: Para. A22, A24, A65)
 - (ii). Përmbushin përgjegjësitë e tyre në lidhje me kërkesat përkatëse etike që zbatohen ndaj tyre.

Pranimi dhe vazhdimi i marrëdhënieve me klientin dhe angazhimet specifike

30. Firma do të vendosë objektivat e mëposhtëm të cilësisë të cilat adresojnë pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientin dhe angazhimet specifike:
- (a) Gjykimet e firmës për faktin nëse ajo do të pranojë ose do të vazhdojë një marrëdhënie me klientin ose angazhimin specifik, janë bazuar në mënyrë të përshtatshme në:

- (i). Informacionin e siguruar në lidhje me natyrën dhe rrethanat e angazhimit dhe integritetin e vlerat etike të klientit (përfshirë drejtimin, dhe, kur është e përshtatshme, personat e ngarkuar me qeverisjen) që është i mjaftueshëm për të mbështetur këto gjykime; dhe (Ref: Para A67 – A71)
- (ii). Aftësinë e firmës për të kryer angazhimin në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. (Ref: Para. A72)
- (b) Prioritetet financiare dhe të funksionimit të firmës nuk çojnë në gjykime të papërshtatshme rreth faktit nëse duhet të pranoje ose do të vazhdoje një marrëdhënie me klientin ose një angazhim specifik. (Ref: Para. A73– A74)

Performanca (kryerja)e angazhimit

31. Firma do të vendose objektivat e mëposhtëm të cilësisë, të cilat adresojnë kryerjen e angazhimeve cilësore:

- (a) Grupet e angazhimit kuptojnë dhe përmbushin përgjegjësitë e tyre në lidhje me angazhimet, duke përfshirë, sipas rastit, përgjegjësinë e përgjithshme të partnerëve të angazhimit për menaxhimin dhe arritjen e cilësisë në angazhim dhe përfshirjen e tyre në mënyrë të mjaftueshme dhe të përshtatshme gjatë gjithë angazhimit. (Ref: Para. A75)
- (b) Natyra, afatet dhe shtrirja e drejtimit dhe mbikëqyrjes së grupeve të angazhimit dhe rishikimi i punës së kryer është i përshtatshëm, bazuar në natyrën dhe rrethanat e angazhimeve dhe burimet e caktuara ose të vëna në dispozicion për grupet e angazhimit, dhe puna e kryer nga anëtarët e grupit të angazhimit me më pak me përvojë është drejtuar, mbikëqyrur dhe rishikuar nga anëtarët e grupit të angazhimit më me përvojë. (Ref: Para. A76 – A77)
- (c) Grupet e angazhimit ushtrojnë gjykimin e duhur profesional dhe skepticizmin profesional në varësi të llojit të angazhimit, kur kjo është e zbatueshme. (Ref: Para. A78)
- (d) Për çështje të vështira ose të diskutueshme kryhen konsultime dhe zbatohen përfundimet e rena dakord. (Ref: Para. A79 – A81)
- (e) Sillen në vëmendje të firmës dhe zgjidhen diferencat në opinion brenda grupit të angazhimit ose midis grupit të angazhimit dhe rishikuesit të cilësisë së angazhimit, apo individëve që kryejnë aktivitete brenda sistemit të menaxhimi të cilësisë firmës. (Ref: Para. A82)
- (f) Dokumentacioni i angazhimit mblidhet dhe sistemohet në kohën e duhur pas datës së raportit të angazhimit dhe mbahet e ruhet në mënyrë të përshtatshme për të përmbushur nevojat e firmës dhe për të qenë në pajtim me ligjin, rregullat dhe kërkesat përkatëse etike ose standardet profesionale. (Ref: Para. A83–A85)

Burimet

32. Firma do të vendosë objektivat e mëposhtëm të cilësisë, të cilat adresojnë sigurimin, zhvillimin, përdorimin, mbajtjen, alokimin dhe caktimin e burimeve në kohën e duhur, për të mundësuar hartimin, zbatimin dhe vënien në funksionim të sistemit të menaxhimit të cilësisë: (Ref: Para. A86 – A87)

Burimet njerëzore

- (a) Personeli që punësohet, zhvillohet dhe mbahet, ka kompetencën dhe aftësitë për të: (Ref: Para. A88 – A90)
 - (i). Realizuar vazhdimisht angazhime cilësore, përfshirë marrjen e njohurive ose përvojës përkatëse për angazhimet që kryen firma; ose
 - (ii). Kryer aktivitete ose mbajtur përgjegjësi në lidhje me funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të firmës.
- (b) Personeli demonstroi një angazhim ndaj cilësisë përmes veprimeve dhe sjelljeve të tij, zhvillohet dhe mban kompetencën e duhur, për të kryer rolet përkatëse dhe mbahet përgjegjës ose shpërblehet përmes vlerësimeve, kompensimit, promovimit dhe stimuljeve të tjerë. (Ref: Para A91 – A93)
- (c) Kur firma nuk ka personel të mjaftueshëm ose të përshtatshëm për të mundësuar funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të firmës ose kryerjen e angazhimeve, firma angazhon individë nga burime të jashtme (p.sh., nga rrjeti, një firmë tjetër e rrjetit ose nga një ofrues i shërbimit). (Ref: Para A94)
- (d) Për çdo angazhim caktohen anëtarët e grupit të angazhimit, përfshirë një partner angazhimi, të cilët kanë kompetencën, aftësinë e duhur dhe kohën e mjaftueshme për të kryer vazhdimisht angazhime cilësore. (Ref: Para. A88 – A89, A95 – A97)
- (e) Për të kryer aktivitete brenda sistemit të menaxhimit të cilësisë caktohen individë të cilët kanë kompetencën dhe aftësitë e duhura dhe kohë të mjaftueshme, për ta kryer këto aktivitete.

Burimet teknologjike

- (f) Sigurohen ose zhvillohen, zbatohen, mbahen dhe përdoren burimet e duhura teknologjike që bëjnë të mundur funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të firmës dhe performancën e angazhimeve. (Ref: Para. A98 – A101, A104)

Burimet Intelektuale

- (g) Sigurohen ose zhvillohen, zbatohen, mbahen dhe përdoren burimet e duhura intelektuale, të cilat bëjnë të mundur funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të firmës dhe kryerjen e angazhimeve cilësore në vazhdimësi, burimet intelektuale janë në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore e rregullatore të zbatueshme, kur kjo është e zbatueshme. (Ref: Para. A102 – A104)

Ofruesit e shërbimeve

- (h) Burimet njerëzore, teknologjike ose intelektuale nga ofruesit e shërbimeve janë të përshtatshme për t'u përdorur në sistemin e menaxhimit të cilësisë së firmës dhe në kryerjen e angazhimeve, duke mbajtur parasysh objektivat e cilësisë në paragrafin 32 (d), (e), (f) dhe (g). (Ref: Para. A105 – A108)

Informacioni dhe komunikimi

33. Firma do të vendose objektivat e mëposhtëm të cilësisë, të cilat adresojnë sigurimin, gjenerimin ose përdorimin e informacionit në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe komunikimin në kohë të informacionit brenda firmës dhe tek palët e jashtme, për të mundësuar hartimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë: (Ref: Para. A109)
- (a) Sistemi i informacionit identifikon, kap, përpunon dhe mban informacionet përkatëse dhe të besueshme, të cilat mbështetin sistemin e menaxhimit të cilësisë, qoftë nga burimet e brendshme ashtu edhe ato të jashtme. (Ref: Para. A110 – A111)
 - (b) Kultura e firmës pranon dhe përforcon përgjegjësinë e personelit për shkëmbim e informacionit me firmën dhe me njëri -tjetrin. (Ref: Para. A112)
 - (c) Informacioni përkatës dhe i besueshëm shkëmbehet në të gjithë firmën dhe me grupet e angazhimit, duke përfshirë faktin që: (Ref: Para. A112)
 - (i).Informacioni i komunikohet personelit dhe grupeve të angazhimit, dhe natyra, afatet dhe shtrirja e informacionit është e mjaftueshme për t'u mundësuar atyre të kuptojnë dhe mbajnë përgjegjësitë e tyre në lidhje me kryerjen e aktiviteteve brenda sistemit të menaxhimit të cilësisë ose angazhimit; dhe
 - (ii).Personeli dhe grupet e angazhimit i komunikojnë informacion firmës kur kryejnë aktivitetet brenda sistemit të menaxhimit të cilësisë ose angazhimit.
 - (d) Informacioni përkatës dhe i besueshëm ju komunikohet palëve të jashtme, duke përfshirë:
 - (i).Informacioni komunikohet nga firma për rrjetin apo brenda tij ose tek ofruesit e shërbimeve të firmës, nëse ka, duke mundësuar që rrjeti ose ofruesit e shërbimeve të përmbushin përgjegjësitë e tyre në lidhje me kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit apo burimet që ju janë dhënë atyre; dhe (Ref: Para. A113)
 - (ii).Informacioni komunikohet për palët e jashtme, kur kërkohet nga ligji, rregullat ose standardet profesionale, apo për të mbështetur njohjen dhe kuptimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë nga palët e jashtme. (Ref: Para. A114 – A115)

Reagimet specifike

34. Në hartimin dhe zbatimin e reagimeve në përputhje me paragrafin 26, firma do të përfshijë përgjigjet e mëposhtme: (Ref: Para. A116)
- (a) Firma përcakton politika ose procedura për:
 - (i).Identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e kërcënimeve ndaj pajtueshmërisë me kërkesat përkatëse etike; dhe (Ref: Para. A117)
 - (ii).Identifikimin, komunikimin, vlerësimin dhe raportimin e çdo shkelje të kërkesave përkatëse etike dhe reagimin e duhur, në kohën e duhur, ndaj shkaqeve dhe pasojave të shkeljeve. (Ref: Para. A118 – A119)
 - (b) Te paktën një here në vit nga i gjithë personeli, i cili sipas kërkesave përkatëse etike duhet të jetë i pavarur, firma siguron një konfirmim të dokumentuar të pajtueshmërisë së saj me kërkesat e pavarësisë.

- (c) Firma vendos politika ose procedura për marrjen, investigimin dhe zgjidhjen e ankesave dhe pretendimeve për mos kryerjen e punës në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, ose për papajtueshmëritë me politikat ose procedurat e firmës, të vendosura në përputhje me këtë SNMC. (Ref: Para. A120 – A121)
- (d) Firma vendos politika ose procedura që adresojnë rrethanat kur:
 - (i). Pas pranimit ose vazhdimit të marrëdhënies me një klient ose marrjes së një angazhimi specifik, firma vihet në dijeni të informacionit, i cili nëse do të ishte njohur para pranimit ose vazhdimit të marrëdhënies me klientin apo para marrjes së angazhimit specifik, do të bënte që firma të refuzonte marrëdhënien me klientin ose angazhimin specifik; ose (Ref: Para. A122 – A123)
 - (ii). Firma është e detyruar nga ligji ose rregulli, që të pranojë një marrëdhënie me klientin ose angazhimin specifik. (Ref: Para. A123)
- (e) Firma vendos politika ose procedura, të cilat: (Ref: Para. A124 – A126)
 - (i). Kërkojnë komunikimin me personat e ngarkuar me qeverisjen kur kryhet një auditim i pasqyrave financiare të entiteteve të listuara, lidhur me mënyrën se si sistemi i menaxhimit të cilësisë mbështet kryerjen në vazhdimësi të angazhimeve cilësore të auditimit; (Ref: Para. A127– A129)
 - (ii). Adresojnë, kur është nevoja, komunikimin me palët e jashtme, në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë së firmës; dhe (Ref: Para. A130)
 - (iii). Adresojnë informacionin që do të sigurohet kur komunikohet me palët e jashtme në përputhje me paragrafët 34 (e) (i) dhe 34 (e) (ii), përfshirë natyrën, afatet dhe shtrirjen e formën e duhur të komunikimit. (Ref: Para. A131 – A132)
- (f) Firma vendos politika ose procedura që adresojnë rishikimet e cilësisë së angazhimit në përputhje me SNMC 2, dhe kërkon kryerjen e një rishikimi të cilësisë së angazhimit për:
 - (i). Auditimet e pasqyrave financiare të entiteteve të listuara;
 - (ii). Auditimet ose angazhimet e tjera, për të cilat nga ligji ose rregullat kërkohet një rishikim i cilësisë së angazhimit; dhe (Ref: Para. A133)
 - (iii). Auditimet ose angazhimet e tjera, për të cilat firma përcakton se një rishikim i cilësisë së angazhimit është një përgjigje e përshtatshme për të adresuar një ose më shumë rreze të cilësisë. (Ref: Para A134-A137)

Monitorimi dhe procesi i korrigjimit të mangësive

35. Firma do të vendose një proces të monitorimit dhe korrigjimit të mangësive për te: (Ref: Para. A138)
- (a) Siguruar informacionin përkatës, të besueshëm dhe në kohën e duhur, në lidhje me hartimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë.
 - (b) Ndërmarrë veprimet e duhura për t'iu përgjigjur mangësive të identifikuara siç janë mangësitë që janë korrigjuar në kohë.

Hartimi dhe kryerja e aktiviteteve të monitorimit

36. Firma do të hartojë dhe kryejë aktivitete të monitorimit për të patur një bazë për identifikimin e mangësive.

37. Në përcaktimin e natyrës, afateve dhe shtrirjes së aktiviteteve të monitorimit, firma do të mbajë parasysh: (Ref: Para. A139 – A142)
- (a) Arsyet për vlerësimet e dhëna ndaj rreziqeve të cilësisë;
 - (b) Formën e përgjigjeve /reagimeve;
 - (c) Procesin e vlerësimit të rrezikut të firmës dhe procesin e monitorimit dhe korrigjimit të mangësive; (Ref: Para. A143 – A144)
 - (d) Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të cilësisë; (Ref: Para. A145)
 - (e) Rezultatet e aktiviteteve të mëparshme të monitorimit, pavarësisht nëse aktivitetet e mëparshme të monitorimit vijnë të jenë të përshtatshme për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të firmës dhe faktin nëse veprimet e korrigjimit të mangësive kanë qenë efektive për të adresuar mangësitë e identifikuara më parë; dhe (Ref: Para. A146–A147)
 - (f) Informacione të tjera të përshtatshme, përfshirë ankesat dhe pretendimet për mos kryerjen e punës në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore apo papajtueshmërinë me politikat ose procedurat e firmës, të vendosura në përputhje me këtë SNMC, informacionin nga inspektimet e jashtme dhe informacionin nga ofruesit e shërbimeve. (Ref: Para A148 – A150).
38. Në aktivitetet e saj monitoruese, firma do të përfshijë inspektimin e angazhimeve të përfunduara dhe do të përcaktojë se cilat angazhime dhe partnerë angazhimi do të zgjidhen për inspektim. Për këtë, firma do të: (Ref: Para A141, A151 – A154)
- (a) Mbajë parasysh çështjet në paragrafin 37;
 - (b) Konsiderojë natyrën, afatet dhe shtrirjen e aktiviteteve të tjera monitoruese të ndërmarra nga firma dhe angazhimet e partnerët e angazhimit, të cilat i nënshtrohen aktiviteteve monitoruese; dhe
 - (c) Zgjedhë, mbi një bazë ciklike, e cila përcaktohet nga firma, të paktën një angazhim të përfunduar për secilin partner të angazhimit.
39. Firma do të vendosë politika ose procedura, të cilat:
- (a) Kërkojnë që individët të cilët kryejnë aktivitetet e monitorimit të kenë kompetencën dhe aftësitë, përfshirë kohën e mjaftueshme, për të kryer aktivitetet e monitorimit në mënyrë efektive; dhe
 - (b) Adresojnë objektivitetin e individëve që kryejnë aktivitetet e monitorimit. Këto politika ose procedura do të ndalojnë kryerjen e inspektimit të angazhimit, nga anëtarët e grupit të angazhimit ose rishikuesi i cilësisë së angazhimit. (Ref: Para. A155–A156)

Vlerësimi i gjetjeve dhe identifikimi i mangësive

40. Firma do të vlerësojë gjetjet, për të përcaktuar nëse ekzistojnë mangësi, përfshirë në se ka të tilla në procesin e monitorimit dhe korrigjimit të mangësive. (Ref: Para. A157 – A162)

Vlerësimi i mangësive të identifikuara

41. Firma do të vlerësojë seriozitetin (rëndësinë) dhe përhapjen e mangësive të identifikuara, nëpërmjet: (Ref: Para. A161, A163 – A164)

- (a) Investigimit të shkaqeve rrënjësore (kryesore) të mangësive të identifikuara. Në përcaktimin e natyrës, afateve dhe shtrirjes së procedurave për të investiguar shkaqet, firma do të mbaje parasysh natyrën e mangësive të identifikuara dhe shkallen e seriozitetit të tyre të mundshëm. (Ref: Para. A165 – A169)
- (b) Vlerësimit të efektit të mangësive të identifikuara në sistem të menaxhimit të cilësisë, si individualisht ashtu edhe në tërësi.

Reagimi ndaj mangësive të identifikuara

- 42. Firma do të hartojë dhe zbatojë veprime për korrigjimin e mangësive, për të adresuar mangësitë e identifikuara të cilat i përgjigjen rezultateve të analizës së rrënjësore të shkaqeve. (Ref: Para. A170 – A172)
- 43. Individët që kanë përgjegjësi operacionale për procesin e monitorimit dhe të korrigjimit të mangësive do të vlerësojnë nëse veprimet përmirësuese (te korrigjimit të mangësive):
 - (a) për të adresuar mangësitë e identifikuara dhe shkaqet rrënjësore të tyre, janë hartuar në mënyrë të përshtatshme dhe tregojnë se ato janë zbatuar; dhe
 - (b) te zbatuara për të adresuar mangësitë e identifikuara më parë, janë efektive.
- 44. Nëse vlerësimi tregon se veprimet e korrigjimit të mangësive nuk janë hartuar dhe zbatuar në mënyrë të përshtatshme ose nuk janë efektive, individët, që kanë përgjegjësi operacionale për monitorimin dhe procesin e korrigjimit të mangësive, do të ndërmarrin veprimet e duhura për të përcaktuar nëse veprimet përmirësuese janë modifikuar në mënyrën e duhur për të qenë efektive.

Gjetjet rreth një angazhimi të veçantë

- 45. Firma do të përgjigjet sipas rrethanave, kur gjetjet tregojnë se ka një angazhim për të cilin mungojnë procedurat që kërkohen për kryerjen e angazhimit ose, kur raporti i lëshuar mund të jetë i papërshtatshëm. Përgjigja/reagimi i/e firmës do të përfshijë: (Ref: Para. A173)
 - (a) Marrjen masave të duhura për të qenë në përputhje me standardet përkatëse profesionale dhe kërkesat ligjore e rregullatore të zbatueshme; dhe
 - (b) Kur raporti konsiderohet i papërshtatshëm, vlerësimin e pasojave dhe marrjen masave të duhura, përfshirë faktin nëse duhet të merren këshilla ligjore.

Komunikimi i vazhdueshëm në lidhje me monitorimin dhe korrigjimin e mangësive

- 46. Individët e ngarkuar me përgjegjësinë operacionale për procesin e monitorimit dhe korrigjimit të mangësive, duhet të komunikojnë në kohë kohën e duhur me individët që kanë përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe individët që kanë përgjegjësinë operacionale për sistemin e menaxhimit të cilësisë: (Ref: Para. A174)
 - (a) Një përshkrim të aktiviteteve të monitorimit të kryera;
 - (b) Mangësitë e identifikuara, përfshirë shkallen dhe përhapjen e mangësive; dhe

(c) Veprimet përmirësuese për të adresuar mangësitë e identifikuar.

47. Firma do të komunikojë çështjet e përshkruara në paragrafin 46 tek grupet e angazhimit dhe tek individët e tjerë, të cilëve ju janë caktuar aktivitete në kuadër të sistemit të menaxhimit të cilësisë, për të bërë të mundur që ata të marrin masa të shpejta dhe të kryejnë veprimet e duhura në përputhje me përgjegjësitë e tyre.

Kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit

48. Kur firma i përket një rrjeti, ajo do të njohe dhe kuptojë, kur është e aplikueshme: (Ref: Para. A19,A175)

- (a) Kërkesat e vendosura nga rrjeti në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë së firmës, përfshirë kërkesat për firmën, për të zbatuar ose përdorur burimet ose shërbimet e marra nga ose përmes rrjetit (d.m.th., kërkesat e rrjetit);
- (b) Çdo shërbim ose burim të ofruar nga rrjeti, që firma zgjedh të zbatojë ose përdorë për hartimin, zbatimin ose venin në funksionim të sistemit të menaxhimit të cilësisë të firmës (d.m.th. shërbimet e rrjetit); dhe
- (c) Përgjegjësitë e firmës për çdo veprim që nevojitet për zbatimin e kërkesave të rrjetit ose përdorimin e shërbimeve të rrjetit. (Ref: Para. A176)

Firma mbetet përgjegjëse për sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë, përfshirë gjykimet profesionale të bëra për hartimin, zbatimin dhe venin në funksionim të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Firma nuk do të zbatojë kërkesat e rrjetit ose përdore shërbimet e rrjetit për t'ju kundërvënë kërkesave të këtij SNMC. (Ref: Para. A177)

49. Bazuar në njohjen dhe kuptimin e siguruar sipas paragrafit 48, firma do të:

- (a) Përcaktojë nëse kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit janë të përshtatshme për firmën dhesë ato janë mbajtur parasysh në sistemin e menaxhimit të cilësisë të firmës, përfshirë mënyrën e zbatimit të tyre; dhe (Ref: Para. A178)
- (b) Vlerësojë nëse dhe nëse po, të përcaktojë mënyrën se si do të përshtaten kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit apo plotësohen ato nga firma për të qenë të përshtatshme për përdorim në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë. (Ref: Para. A179 – A180)

Aktivitetet e monitorimit të ndërmarra nga rrjeti në sistemin e menaxhimit të cilësisë të firmës

50. Në rrethanat kur rrjeti kryen aktivitete monitorimi që lidhen me sistemin e menaxhimit të cilësisë firmës, firma do të:

- (a) Përcaktojë efektin e aktiviteteve monitoruese të kryera nga rrjeti në lidhje me natyrën, afatet dhe shtrirjen e aktiviteteve të monitorimit të firmës, të kryera në përputhje me paragrafët 36–38;

- (b) Përcaktoje përgjegjësitë e firmës në lidhje me aktivitetet e monitorimit, përfshirë ndonjë veprim të lidhur me to të kryer nga firma; dhe
- (c) Sigurojë, në kohën e duhur, rezultatet e aktiviteteve të monitorimit të rrjetit, si pjesë e vlerësimit të gjetjeve dhe identifikimit të mangësive në paragrafin 40. (Ref: Para. A181)

Aktivitetet e monitorimit të ndërmarra nga rrjeti për të gjithë firmat e rrjetit

51. Firma do të:

- (a) Njohë dhe kuptojë objektin e përgjithshëm të aktiviteteve të monitorimit, të ndërmarra nga rrjeti në të gjithë firmat e rrjetit, përfshirë aktivitetet e monitorimit për të përcaktuar nëse kërkesat e rrjetit janë zbatuar në mënyrë të përshtatshme në gjithë firmat e rrjetit, dhe mënyrën se si rrjeti do të komunikojë për firmën rezultatet e aktiviteteve të tij të monitorimit;
- (b) Sigurojë nga rrjeti, të paktën një herë në vit, informacione lidhur me rezultatet e përgjithshme të aktiviteteve monitoruese të rrjetit për të gjithë firmat e rrjetit, nëse është e aplikueshme, dhe: (Ref: Para. A182 – A184)
 - (i). Komunikojë informacionin për grupet e angazhimit dhe, sipas rastit, individët e tjerë që kanë detyra në sistemin e menaxhimit të cilësisë, për t'iu dhënë mundësi atyre të ndërmarrin veprime të shpejta dhe të përshtatshme në përputhje me përgjegjësitë e tyre; dhe
 - (ii). Konsiderojë efektin e informacioneve në sistemin e menaxhimit të cilësisë së firmës.

Mangësitë në kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit të identifikuar nga firma

52. Nëse firma identifikon një mangësi në kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit, firma do të: (Ref: Para A185)

- (a) Komunikojë për rrjetin informacionin përkatës në lidhje me mangësinë e identifikuar; dhe
- (b) Hartojë dhe zbatojë veprime përmirësuese të korigjimit të mangësive për të adresuar efektin e mangësisë së identifikuar në kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit, në përputhje me paragrafin 42. (Ref: Para. A186)

Vlerësimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë

53. Individët e caktuar me përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë do të vlerësojnë, në emër të firmës, sistemin e menaxhimit të cilësisë. Vlerësimi do të behet në një moment kohor të caktuar dhe do të kryhet të paktën çdo vit. (Ref: Para. A187 – A189)

54. Bazuar në vlerësimin, individët e caktuar me përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë do të konkludojnë, në emër të firmës, një nga sa me poshtë: (Ref: Para. A190, A195)

- (a) Sistemi i menaxhimit të cilësisë i jep firmës një siguri të arsyeshme se do të arrihen objektivat e sistemit të menaxhimit të cilësisë; (Ref: Para. A191)
- (b) Me përjashtim të çështjeve që lidhen me mangësitë e identifikuar, të cilat kanë një efekt të madh, por jo të përhapur mbi hartimin (formën) zbatimin dhe funksionimin e sistemit të

menaxhimit të cilësisë, sistemi i menaxhimit të cilësisë i jep firmës një siguri të arsyeshme se arrihen objektivat e sistemit të menaxhimit të cilësisë; ose (Ref: Para. A192)

- (c) Sistemi i menaxhimit të cilësisë nuk i jep firmës një siguri të arsyeshme se janë arritur objektivat e sistemit të menaxhimit të cilësisë. (Ref: Para. A192–A194)

55. Nëse individët e ngarkuar me përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë, arrijnë konkluzionet e përshkruara në paragrafin 54 (b) ose 54 (c), firma do të: (Ref: Para. A196)

(d) Kryeje veprime të shpejta dhe të përshtatshme; dhe

(e) Komunikojë me:

(i).Grupet e angazhimit dhe individët e tjerë të ngarkuar me aktivitete brenda sistemit të menaxhimit të cilësisë, deri në shkallen që kjo është e përshtatshme për përgjegjësitë e tyre; dhe (Ref: Para. A197)

(ii).Palët e jashtme në përputhje me politikat ose procedurat e firmës, të kërkuara nga paragrafi 34 (e). (Ref: Para. A198)

56. Firma do të kryeje vlerësime periodike të performancës së individëve të caktuar me përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë, dhe individët e caktuar me përgjegjësinë operacionale për sistemin e menaxhimit të cilësisë. Në këtë mënyrë, firma do të mbaje parasysh vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë. (Ref: Para. A199 – A201)

Dokumentimi

57. Firma do të përgatitë dokumentimin e sistemit të saj të menaxhimit të cilësisë, i cili është i mjaftueshëm për të: (Ref: Para A202 – A204)

(a) Mbështetur një njohje dhe kuptim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë nga personeli i firmës, përfshirë kuptimin e roleve dhe përgjegjësi të tyre në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe kryerjen e angazhimeve;

(b) Mbështetur zbatimin dhe funksionimin e vazhdueshëm e të qëndrueshëm të përgjigjeve; dhe

(c) Siguruar evidence të hartimit (formës), zbatimit dhe funksionimit të përgjigjeve, për të mbështetur vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë nga individët e caktuar me përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë.

58. Ne përgatitjen e dokumentimit, firma do të përfshijë:

- Identifikimin e individëve të caktuar me përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe me përgjegjësitë operacionale për sistemin e menaxhimit të cilësisë;
- Objektivat e cilësisë të firmës dhe rreziqet e cilësisë; (Ref: Para. A205)
- Një përshkrim të përgjigjeve dhe të mënyrës se si përgjigjet e firmës adresojnë rreziqet e cilësisë;
- Ne lidhje me procesin e monitorimit dhe korrigjimit të mangësive:
 - Evidencën e aktiviteteve të monitorimit të kryera;

- Vlerësimin e gjetjeve, mangësive të identifikuara dhe analizën e shkaqeve rrënjësore të tyre;
- Veprimet korrigjuese për të adresuar mangësitë e identifikuara dhe vlerësimin e formës dhe zbatimit të këtyre veprimeve korrigjuese përmirësuese; dhe
- Komunikimet rreth monitorimit dhe veprimeve korrigjuese përmirësuese; dhe
- Bazën për konkluzionet e arritura në zbatim të paragrafit 54.

59. Firma do të dokumentojë çështjet që përmenden në paragrafin 58 përsa ato lidhen me kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit dhe vlerësimin e kërkesave të rrjetit ose shërbimeve të rrjetit në përputhje me paragrafin 49 (b). (Ref: Para. A206)

60. Firma do të përcaktojë një periudhë kohe për ruajtjen e dokumentacionit për sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila është e mjaftueshme për firmën që ajo të mund të monitorojë hartimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së firmës ose për një periudhë më të gjatë nëse kërkohet nga ligji apo rregullat.

Zbatimi dhe materiali tjetër shpjegues

Objekti i këtij SNMC (Ref: Para. 3–4)

A1 Deklaratat e tjera të BSNAS-se, përfshirë SNAR 2400⁴ (i rishikuar) dhe SNAR 3000 (i rishikuar)⁵, gjithashtu, përcaktojnë kërkesa për partnerin e angazhimit për menaxhimin e cilësisë në nivel angazhimi.

A2 Kodi IESBA⁶ përmban kërkesa dhe materialin për zbatim për profesionistët kontabël, të cilat ju japin mundësi atyre të përmbushin përgjegjësinë e tyre për të vepruar në interes të publikut. Siç tregohet në paragrafin 15, në kontekstin e performancës së angazhimit siç përshkruhet në këtë SNMC, kryerja në vazhdimësi e angazhimeve cilësore është pjesë e përgjegjësisë së profesionistit kontabël për të vepruar në interesin e publikut.

Sistemi menaxhimit të cilësisë së firmës (Ref: Para. 6–9)

A3 Firma mund të përdorë terminologji ose kuadro të ndryshme, për të përshkruar komponentët e sistemit të saj të menaxhimit të cilësisë.

A4 Shembuj të natyrës së ndërlidhur të komponentëve përfshijnë sa vijon:

⁴ Standardi ndërkombëtar i angazhimeve për të rishikuar (SNAR) 2400 (i rishikuar) , *Angazhimet për të rishikuar pasqyrat financiare historike*

⁵ Standardi ndërkombëtar i angazhimeve për të rishikuar (SNAR) 3000 (i rishikuar) , *Angazhimet e sigurisë që ndryshojnë nga auditimet ose rishikimet e Informacioneve financiare historike*

⁶ Kodi i etikës për profesionistët kontabël (Kodi IESBA) i Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të etikës për profesionistët kontabël

- Procesi i vlerësimit të rrezikut të firmës, përcakton proceset që firma duhet të ndjekë për zbatimin e një metode të bazuar në rrezik në të gjithë sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- Komponenti i qeverisjes dhe lidershipit, përcakton mjedisin që mbështet sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- Burimet dhe informacioni dhe komponentët e komunikimit, mundësojnë dizajnin (formën), zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë.
- Procesi i monitorimit dhe korrigjimit të mangësive, është një proces i krijuar për të monitoruar të gjithë sistemin e menaxhimit të cilësisë. Rezultatet e procesit të monitorimit dhe korrigjimit të mangësive japin informacion që lidhet me procesin e vlerësimit të rrezikut të firmës.
- Ekzistenca e marrëdhënieve midis çështjeve të veçanta, për shembull, disa aspekte të kërkesave përkatëse etike janë të përshtatshme për pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientin dhe kryerjen e angazhimeve specifike.

A5 Siguria e arsyeshme arrihet kur sistemi i menaxhimit të cilësisë zvogëlon, deri në një nivel të ulët të pranueshëm, rrezikun që nuk do të arrihen objektivat e përcaktuara në paragrafin 14 (a) dhe (b). Siguria e arsyeshme nuk është një nivel sigurie absolut, sepse një sistem i menaxhimit të cilësisë ka kufizime të vetvetishme. Këto kufizime përfshijnë faktin që gjykimi njerëzor në vendimmarrje mund të jete i gabuar dhe faktin që dështimet në sistemin e menaxhimit të cilësisë së një firme mund të ndodhin, për shembull, për shkak të gabimeve ose sjelljeve njerëzore apo dështimeve në aplikacionet e teknologjisë së informacionit (TI).

Autoriteti i këtij SNMC (Ref: Paragrafi 12)

A6 Ky SNMC ka si objektiv të japë kontekstin në të cilin janë vendosur kërkesat e këtij SNMC, të përcaktojë rezultatin e dëshiruar të këtij SNMC-je dhe është parashikuar të ndihmojë firmën të kuptojë se çfarë duhet të arrihet dhe, kur është e nevojshme, mjetet e duhura për ta bërë këtë.

A7 Kërkesat e këtij SNMC shprehen duke përdorur përpara foljes formatin e kohës së ardhshme "do të".

A8 Aty ku është e nevojshme, zbatimi dhe materiali tjetër shpjegues japin shpjegime të mëtejshme për kërkesat dhe udhëzimet për zbatimin e tyre. Në veçanti, ai mund të:

- Shpjegoje më saktë se çfarë do të thotë ose synohet të mbulojë një kërkesë; dhe
- Përfshije shembuj që ilustrojnë se si mund të zbatohen kërkesat.

Ndonëse ky udhëzim në vetvete nuk imponon një kërkesë, ai është i rëndësishëm për zbatimin e duhur të kërkesave. Zbatimi dhe materiali tjetër shpjegues mund të japin gjithashtu, informacion baze mbi çështjet e trajtuara në këtë SNMC. Kur është e përshtatshme, në pjesën e zbatimit dhe materialit tjetër shpjegues, janë përfshirë disa konsiderata specifike shtesë për organizatat e auditimit të sektorit publik. Këto konsiderata shtesë ndihmojnë në zbatimin e kërkesave të këtij SNMC. Megjithatë, ato nuk kufizojnë apo zvogëlojnë përgjegjësinë e firmës për të qenë në pajtim me kërkesat në këtë SNMC.

- A9 Nën titullin "Përkufizime", ky SNMC përfshin, një përshkrim të kuptimeve që i atribuohen disa termave për qëllime të këtij SNMC. Këto përkufizime janë dhënë për të ndihmuar në zbatimin dhe interpretimin koherent të këtij SNMC, dhe nuk kanë për qëllim të anashkalojnë përkufizimet që mund të jenë dhënë për qëllime të tjera, qoftë në ligj, rregullore ose ndryshe. Fjalori i termave që lidhet me Standardet ndërkombëtare të publikuara nga BSNAS në Manualin e Deklaratave Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë, Auditimit, Rishikimit, Sigurimeve të Tjera dhe Shërbimeve të lidhura, të publikuar nga IFAC, përfshin termat e përkufizuar në këtë SNMC. Fjalori i termave përfshin gjithashtu, përshkrime të termave të tjerë, të gjetur në këtë SNMC, për të ndihmuar në interpretimin dhe përkthimin e njëjtë dhe të qëndrueshëm.

Përkufizimet

Mangësitë (Ref: Paragrafi 16 (a))

- A10 Firma identifikon mangësitë përmes vlerësimit të gjetjeve. Një mangësi mund të lindë nga një gjetje, ose një kombinim i gjetjeve.
- A11 Kur një mangësi është identifikuar si rezultat i një rreziku të cilësisë, ose kombinimit të rreziqeve të cilësisë, të cilat nuk kanë qenë identifikuar ose vlerësuar siç duhet, përgjigjet për të adresuar këto rreziqe të cilësisë gjithashtu, mund të mungojnë, ose mund të mos jenë hartuar ose zbatuar në mënyrë të përshtatshme.
- A12 Aspektet e tjera të sistemit të menaxhimit të cilësisë që konsistojnë në kërkesat në këtë SNMC adresojnë:
- Caktimin e përgjegjësive (paragrafët 20–22);
 - Procesin e vlerësimit të rrezikut të firmës;
 - Procesin e monitorimit dhe korrigjimit të mangësive; dhe
 - Vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Shembuj të mangësive që lidhen me aspekte të tjera të sistemit të menaxhimit të cilësisë

- Procesi i vlerësimit të rrezikut të firmës nuk arrin të identifikojë informacionin që tregon ndryshime në natyrën dhe rrethanat e firmës dhe angazhimet e saj dhe nevojën për të vendosur objektiva shtese për cilësinë ose për të modifikuar rreziqet për cilësinë apo reagimet ndaj tyre.
- Procesi i monitorimit dhe përmirësimit, përmes korrigjimit të mangësive të firmës, nuk është hartuar ose zbatuar në një mënyrë të atille që:
 - Te japë informacionin përkatës, të besueshëm dhe në kohë, në lidhje me hartimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë.
 - I jep mundësi firmës të ndërmarrë veprimet e duhura për t'iu përgjigjur mangësive të identifikuara, në mënyrë që mangësitë të korrigjohen në kohë.

- | |
|--|
| <ul style="list-style-type: none">• Individët që kanë përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë nuk kryejnë vlerësimin vjetor të sistemit të menaxhimit të cilësisë |
|--|

Grupi i angazhimit (Ref: Paragrafi 16 (f))

A13 SNA 220 (i rishikuar)⁷ jep udhëzime për zbatimin e përkufizimit të grupit të angazhimit në kontekstin e një auditimi të pasqyrave financiare.

Inspektimet e Jashtme (Ref: Paragrafi 16 (g))

A14 Në disa rrethana, një autoritet i jashtëm mbikëqyrës mund të ndërmarrë disa lloje të tjera inspektimesh, për shembull, rishikimet tematike që, për një përzgjedhje të firmave, fokusohen në aspekte të veçanta të angazhimeve të auditimit ose praktikat të përhapura të firmës.

Gjetjet (Ref: Para. 16 (h))

A15 Si pjesë e gjetjeve të akumuluar nga aktivitetet e monitorimit, inspektimet e jashtme dhe burime të tjera të përshtatshme, firma mund të identifikojë edhe vëzhgime të tjera në lidhje me sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë, siç janë rezultatet pozitive ose mundësitë që ka firma për të përmirësuar, ose përmirësuar më tej, sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë. Paragrafi A158 shpjegon mënyrën sesi mund të përdoren nga firma vëzhgimet e tjera, në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë.

A16 Paragrafi A148 jep shembuj të informacionit që merret nga burime të tjera të përshtatshme.

A17 Aktivitetet e monitorimit përfshijnë monitorimin në nivelin e angazhimit, siç është inspektimi i angazhimeve. Për më tepër, inspektimet e jashtme dhe burimet e tjera përkatëse, mund të përfshijnë informacione që kanë të bëjnë me angazhimet specifike. Si rezultat, informacioni në lidhje me hartimin (formën), zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë përfshin gjetjet në nivel angazhimi të cilat mund të jenë tregues të gjetjeve në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë.

Firma (Ref: Paragrafi 16 (i))

A18 Përkufizimi për "firmën" në kërkesat përkatëse etike mund të ndryshojë nga përkufizimi i dhënë në këtë SNMC.

Rrjeti (Ref: Paragrafi 16 (l), 48)

⁷ SNA 220 (i rishikuar), paragrafet A15-A25

A19 Rrjetet dhe firmat brenda rrjetit mund të strukturoren në mënyra të ndryshme. Për shembull, në kontekstin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së një firme:

- Rrjeti mund të vendosë kërkesa për firmën në lidhje me sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë, ose dhënien e shërbimeve që janë përdorur nga firma në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë apo në kryerjen e angazhimeve;
- Firmat e tjera brenda rrjetit mund të japin shërbime (p.sh., burime) që përdoren nga firma në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë apo në kryerjen e angazhimeve; ose
- Strukturat apo organizimet e tjera brenda rrjetit mund të vendosin kërkesa për firmën lidhur me sistemin e tij të menaxhimit të cilësisë, ose të dhënies së shërbimeve.

Për qëllimet e këtij SNMC, çdo kërkesë e rrjetit ose shërbimet e rrjetit që janë marre nga rrjeti, një firmë tjetër brenda rrjetit ose një strukturë apo një organizatë tjetër në rrjet, konsiderohen "kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit".

Personeli (Ref: Para. 16 (n))

A20 Përveç personelit (d.m.th., individëve në firmë), firma mund të përdorë individë të jashtëm për kryerjen e aktiviteteve në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë ose në kryerjen e angazhimeve. Për shembull, individë jashtë firmës mund të jenë individët nga firma të tjera të rrjetit (p.sh., individët në një qendër të dhënies së shërbimeve të një firmë rrjeti) ose individë të punësuar nga një ofrues shërbimi (p.sh., një auditues i komponentit nga një firmë tjetër, e cila nuk është brenda rrjetit të firmës).

A21 Personeli gjithashtu, përfshin partnerët dhe stafin në struktura të tjera të firmës, siç është një qendër e dhënies së shërbimeve në firmë.

Kërkesat përkatëse etike (Ref: Paragrafi 16 (t), 29)

A22. Kërkesat përkatëse etike, që janë të zbatueshme në kontekstin e një sistemi të menaxhimit të cilësisë, mund të ndryshojnë në varësi të natyrës dhe rrethanave të firmës dhe angazhimeve të saj. Termi "profesionist kontabël" mund të përkufizohet në kërkesat përkatëse etike. Për shembull, Kodi IESBA përcakton termin "profesionist kontabël" dhe shpjegon më tej objektin e dispozitave në Kodin IESBA që zbatohen për profesionistët kontabël individualë në praktikën publike dhe firmat e tyre.

A23 Kodi IESBA adreson rrethanat kur ligji ose rregullat e përjashtojnë profesionistin kontabël nga detyrimi për të qenë në pajtim me disa pjesë të Kodit IESBA. Më tej, ai pranon se disa juridiksione mund të kenë dispozita në ligj ose rregulla, të cilat ndryshojnë ose shkojnë përtej atyre të përcaktuara në Kodin IESBA dhe, profesionistët kontabël në këto juridiksione duhet të jenë të vetëdijshëm për këto diferenca dhe të jenë në pajtim me dispozitat më të rrepta, përveç nëse një gjë e tillë ndalohet me ligj ose rregulla.

A24 Dispozita të ndryshme të kërkesave përkatëse etike mund të zbatohen vetëm për individët në kontekstin e kryerjes së angazhimeve dhe jo për firmën në vetvete. Për shembull:

- Pjesa 2 e Kodit IESBA zbatohet për individët që janë profesionistë kontabël në praktiken publike, kur ata kryejnë aktivitete profesionale në përputhje me marrëdhëniet që kanë me firmën, qoftë si një i kontraktuar, punonjës ose pronar, dhe kjo mund të jetë e përshtatshme në kontekstin e kryerjes së angazhimeve.
- Disa kërkesa në Pjesët 3 dhe 4 të Kodit IESBA zbatohen gjithashtu për individët që janë profesionistë kontabël në praktikën publike kur ata kryejnë aktivitete profesionale për klientët.

Pajtueshmëria me këto kërkesa përkatëse etike nga individët mund të ketë nevojë të adresohet nga sistemi i menaxhimit të cilësisë së firmës.

Shembull i kërkesave përkatëse etike, të cilat janë të zbatueshme vetëm për individët dhe jo për firmën, dhe që lidhen me kryerjen e angazhimeve

Pjesa 2 e Kodit IESBA adreson presionin për të shkelur parimet themelore dhe përfshin kërkesa që një individ nuk do të:

- Lejoje që presioni nga të tjerët të rezultojë në një shkelje të pajtueshmërisë me parimet themelore ; ose
- Bëje presion mbi të tjerët, që profesionisti kontabël e di, ose ka arsye të besojë, se do të rezultonte shkeljen e parimeve themelore nga individët e tjerë.

Për shembull, rrethanat mund të lindin kur, gjatë kryerjes së një angazhimi, një individ konsideron se partneri i angazhimit ose një anëtar tjetër në nivel të lartë i grupit të angazhimit ju ka bërë presion atyre që të shkelin parimet themelore

Përgjigja/Reagimi (Ref: Paragrafi 16 (u))

A25 Politikat zbatohen përmes veprimeve të personelit dhe individëve të tjerë, veprimet e të cilëve i nënshtrohen politikave (përfshirë grupet e angazhimit), ose përmes vete kufizimit të tyre nga kryerja e veprimeve, të cilat do të binin ndesh me politikat e firmës.

A26. Procedurat mund të jenë mandatuara, përmes dokumenteve zyrtare apo komunikimeve të tjera, ose mund të rezultojnë nga sjelljet që nuk janë të mandatuara por janë më tepër të kushtëzuara nga kultura e firmës. Procedurat mund të detyrohen për zbatim përmes veprimeve të lejuara nga aplikacionet e TI -së, ose aspekte të tjera të mjedisit të TI -së të firmës.

A27 Nëse, për sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë ose për kryerjen e angazhimeve, firma përdor individë të jashtëm, ajo mund të ketë nevojë të hartojë politika ose procedura të ndryshme për të adresuar veprimet e individëve. SNA 220 (i rishikuar)⁸ jep udhëzime kur nga firma mund të hartojë

⁸ SNA 220 (i rishikuar), paragrafët A23-A25

politika ose procedura të ndryshme, për të adresuar veprimet e individëve jashtë firmës në kontekstin e një auditimi të pasqyrave financiare.

Ofruesi i Shërbimit (Ref: Paragrafi 16 (v))

A28 Ofruesit e shërbimeve përfshijnë audituesit e komponentëve nga firma të tjera që nuk janë brenda rrjetit të firmës.

Zbatimi dhe pajtueshmëria me kërkesat përkatëse (Ref. Para. 17)

- A29. *Shembuj të rasteve kur një kërkesë e këtij SNMC mund të mos jetë e përshtatshme për firmën*
- Firma është një profesionist kontabël praktikues (person fizik). Për shembull, mund të mos jenë të përshtatshme kërkesat që adresojnë strukturën organizative dhe caktimin e roleve, përgjegjësi dhe të autoritetit brenda firmës, drejtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e adresimin e diferencave në opinione.
 - Firma kryen vetëm angazhime që janë angazhime të shërbimeve të lidhura. Për shembull, nëse firma nuk kërkohet të ruajë pavarësinë për angazhimet e shërbimeve të lidhura, kërkesa për të marrë një konfirmim të dokumentuar të pajtueshmërisë me kërkesat për pavarësinë nga i gjithë personeli, nuk do të ishte e përshtatshme

Sistemi i menaxhimit të cilësisë

Hartimi, zbatimi dhe vënia në funksionim e një sistemi të menaxhimit të cilësisë (Ref: Para. 19)

A30 Menaxhimi i cilësisë nuk është një funksion i veçantë i firmës; ai është integrimi i një kulture që demonstroi një angazhim ndaj cilësisë, nëpërmjet strategjisë së firmës, aktiviteteve operacionale dhe proceseve të biznesit. Si rrjedhojë, hartimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe aktiviteteve operacionale të firmës dhe proceseve të biznesit, në mënyrë të integruar mund të promovojnë një metode të harmonizuara për menaxhimin e firmës dhe, përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të cilësisë.

A31. Cilësia e gjyqimeve profesionale të ushtruara nga firma ka të ngjarë të përmirësohet kur individët që bëjnë këto gjyqime demonstrojnë një qëndrim që përmban një mendim kërkues, i cili përfshin:

- Vlerësimin e burimit, përshtatshmërisë dhe mjaftueshmërisë së informacionit të siguruar në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë, përfshirë informacionin që lidhet me natyrën dhe rrethanat e firmës dhe angazhimet e saj; dhe
- Të qenurit i hapur dhe vigjilent ndaj nevojës për investigime të mëtejshme ose veprime të tjera.

Përgjegjësitë (Ref: Para. 20–21, 28 (d))

- A32 Komponenti i qeverisjes dhe lidershipit përfshin një objektiv cilësor, se firma ka një strukturë organizative dhe caktim të roleve, përgjegjësi dhe autoritetit, të përshtatshëm, për të bërë të mundur hartimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të saj të menaxhimit të cilësisë.
- A33 Pavarësisht caktimit të përgjegjësi që lidhen me sistemin e menaxhimit të cilësisë në përputhje me paragrafin 20, firma mbetet përfundimisht përgjegjëse për sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe mbajtjen individëve përgjegjës për rolet që ju janë caktuar atyre. Për shembull, në përputhje me paragrafët 53 dhe 54, edhe pse firma bën vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe nxjerr konkluzionet përkatëse për individët e caktuar me përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënia për sistemin e menaxhimit të cilësisë, firma është përgjegjëse për vlerësimin dhe konkluzionin.
- A34 Një individ, të cilit i është caktuar përgjegjësi për çështjet në paragrafin 20, është zakonisht një partner i firmës, kështu që ai ka influencën dhe autoritetin e duhur brenda firmës, siç kërkohet nga paragrafi 21. Megjithatë, bazuar në strukturën ligjore të firmës, mund të ketë rrethana kur një individ mund të mos jetë partner i firmës, por individ ka influencën dhe autoritetin e duhur brenda firmës, për të kryer rolin e tij të caktuar për shkak të marrëveshjeve formale të firmës ose rrjeti i firmës
- A35. Mënyra se si firma cakton rolet, përgjegjësitë dhe autoritetin brenda saj, mund të ndryshojë dhe ligj ose rregulli mund të imponojnë disa kërkesa për firmën, të cilat ndikojnë në lidershipin dhe strukturën e menaxhimit ose përgjegjësitë që ju janë caktuar atyre. Një individ, të cilit i është caktuar përgjegjësi për një çështje në paragrafin 20, mund të caktoj më tej role, procedura, detyra ose veprime për individët e tjerë, për t'i ndihmuar ata në përmbushjen e përgjegjësi të tyre. Sidoqoftë, një individ që i është caktuar përgjegjësi për një çështje në paragrafin 20, do të mbetet përgjegjës dhe llogaridhënës për përgjegjësitë që i janë caktuar atij.

Shembull i shkallëzimit për të demonstruar se si mund të bëhet caktimi i roleve dhe përgjegjësi

- Në një firmë më pak komplekse, përgjegjësia përfundimtare dhe llogaridhënia për sistemin e menaxhimit të cilësisë mund t'i caktohet një partneri të vetëm menaxhues, i cili është i vetmi përgjegjës për mbikëqyrjen e firmës. Gjithashtu, ky individ mund të marrë përgjegjësi për të gjitha aspektet e sistemit të menaxhimit të cilësisë, përfshirë përgjegjësinë operacionale për sistemin e menaxhimit të cilësisë, pajtueshmërinë me kërkesat e pavarësisë, monitorimin dhe procesin e korrigjimit të mangësive.
- Në një firmë më shumë komplekse, mund të ketë nivele të shumfishta të qeverisjes, të cilat reflektojnë strukturën organizative të firmës, dhe firma mund të ketë një organ qeverisës të pavarur që bën mbikëqyrjen jo-ekzekutive të firmës, i cili mund të përfshijë individë të jashtëm. Për më tepër, firma mund të caktojë përgjegjësi operacionale për aspekte të veçanta të sistemit të menaxhimit të cilësisë, përtej atyre të specifikuar në paragrafin 20 (c), siç është

përgjegjësia operationale për pajtueshmërinë me kërkesat etike ose përgjegjësia operationale për menaxhimin e një linje shërbimi.

- A36 Pajtueshmëria me kërkesat e pavarësisë është thelbësore për kryerjen e auditimeve, ose rishikimeve të pasqyrat financiare, apo angazhimet e tjera të sigurisë, dhe një gjë e tillë pritet nga palët e interesuara, të cilat mbështeten në raportet e firmës. Individët e caktuar me përgjegjësinë operationale për pajtueshmërinë me kërkesat e pavarësisë, zakonisht janë përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha çështjeve që lidhen me pavarësisë, kështu që për të trajtuar kërkesat e pavarësisë, firma harton dhe zbaton një metode të fuqishme dhe të qëndrueshme.
- A37 Ligji, rregullat ose standardet profesionale mund të vendosin kërkesa shtesë për një individ, të cilit i është caktuar përgjegjësi për një çështje në paragrafin 20, siç janë kërkesat për licencimin profesional, edukimin profesional ose zhvillimi i vazhdueshëm profesional.
- A38 Kërkesat për eksperiencën dhe njohuritë e duhura, për individët e ngarkuar me përgjegjësinë operationale të sistemit të menaxhimit të cilësisë, zakonisht përfshijnë një kuptim të strategjisë së firmës, vendimet dhe veprimet dhe përvojën me operacionet e biznesit të firmës.

Procesi i vlerësimit të rrezikut të firmës (Ref: Para. 23)

- A39. Mënyra se si firma harton procesin e vlerësimit të rrezikut, mund të ndikohet nga natyra dhe rrethanat e firmës, përfshirë mënyrën e strukturimit dhe organizimit të firmës.

<i>Shembuj të shkallëzimit për të treguar se si mund të ndryshojë procesi i vlerësimit të rrezikut të firmës</i>
--

- Në një firmë më pak komplekse, individë, të cilit i është caktuar përgjegjësia operationale për sistemin e menaxhimit të cilësisë mund të ketë një kuptim të mjaftueshëm për firmën dhe angazhimet e saj për të kryer procesin e vlerësimit të rrezikut. Për më tepër, dokumentimi i objektivave të cilësisë, rreziqeve të cilësisë dhe përgjigjeve/reagimeve, mund të jenë më pak të komplikuar krahasuar me atë çfarë kërkohet për një firmë më shumë komplekse (p.sh., kjo mund të behet nëpërmjet një dokumenti të vetëm).
- Në një firmë më shumë komplekse, mund të ketë një proces formal të vlerësimit të rrezikut, që përfshin disa individë dhe aktivitete të shumta. Procesi mund të jetë i centralizuar (p.sh., objektivat e cilësisë, rreziqet e cilësisë dhe reagimet/përgjigjet janë vendosur në mënyrë të centralizuar për të gjitha njësitë e biznesit, funksionet dhe linjat e shërbimit) ose i decentralizuar (p.sh., objektivat e cilësisë, rreziqet e cilësisë dhe përgjigjet/reagimet janë vendosur në nivel të njësisë së biznesit, nivel funksioni ose linje shërbimi, me rezultate të kombinuara në nivel firme). Gjithashtu, rrjeti i firmës mund të pajisë firmën me objektiva të cilësisë, rreziqe të cilësisë dhe përgjigje/reagime për t'u përfshirë në sistemin e menaxhimit të cilësisë së firmës

A40. Procesi i vendosjes së objektivave të cilësisë, identifikimit dhe vlerësimit të rrezeve të cilësisë dhe hartimit e zbatimit të përgjigjeve/reagimeve është përsëritës, dhe kërkesat e këtij SNMC nuk parashikohet të adresohen në mënyrë lineare. Për shembull:

- Për identifikimin dhe vlerësimin e rrezeve të cilësisë, firma mund të vendose të përfshijë një objektiv shtesë.
- Gjatë hartimit dhe zbatimit të përgjigjeve, firma mund të zbulojë se nuk është identifikuar dhe vlerësuar një rrezik i cilësisë.

A41 Burimet e informacionit, që i japin mundësi firmës të vendose objektiva të cilësisë, të identifikojë dhe vlerësojë rreziqet për cilësinë dhe të hartojë e zbatojë përgjigjet/reagimet, janë pjesë e komponentit të informacionit dhe komunikimit të firmës dhe përfshijnë:

- Rezultatet e procesit të monitorimit dhe përmirësimit përmes korrigjimit të mangësive të firmës (shih paragrafët 42 dhe A171).
- Informacione nga rrjeti ose ofruesit e shërbimeve, përfshirë:
 - Informacione në lidhje me kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit (shiko paragrafin 48); dhe
 - Informacione të tjera nga rrjeti, përfshirë informacionin për rezultatet e aktiviteteve të monitorimit, të kryera nga rrjeti në firmat e rrjetit (shiko paragrafët 50–51).

Gjithashtu, për procesin e vlerësimit të rrezikut të firmës, mund të jenë të përshtatshme informacione të tjera, të brendshme ose të jashtme, si për shembull:

- Informacionet në lidhje me ankesat dhe pretendimet për mos kryerjen e punës në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme, ose në lidhje me papajtueshmërinë me politikën ose procedurat e firmës, të vendosura në përputhje me këtë SNMC.
- Rezultatet e inspektimeve të jashtme.
- Informacionet nga rregullatorët, për entitetet për të cilat firma kryen angazhime, që i vihen në dispozicion të firmës, siç është informacioni nga një rregullator i letrave me vlerë për një entitet për të cilin firma kryen angazhime (p.sh. parregullsi në pasqyrat financiare të entitetit ose papajtueshmëri me rregullat e letrave me vlerë).
- Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të cilësisë, që ndikojnë në aspekte të tjera të sistemit, për shembull, ndryshimet në burimet e firmës.
- Burime të tjera të jashtme, siç janë veprimet rregullatore dhe proceset gjyqësore kundër firmës ose firmave të tjera në juridiksion, që mund të nxjerrin në pah fushat që firma duhet të mbaje në konsideratë.

Vendosja e objektivave të cilësisë (Ref: Para. 24)

- A42. Ligji, rregulli ose standardet profesionale mund të përcaktojnë kërkesa që çojnë në vendosjen e objektivave shtesë për cilësinë. Për shembull, një firmë mund të kërkohej me ligj ose rregulla të emërojnë individët jo-ekzekutive në strukturën qeverisëse të firmës dhe firma e konsideron të nevojshme të vendose objektiva shtesë të cilësisë për të adresuar kërkesat.
- A43. Natyra dhe rrethanat e firmës dhe, angazhimet e saj, mund të jenë të atilla që firma mund të mos e shikojë të nevojshme të vendose objektivave shtesë për cilësinë.
- A44. Firma mund të vendosë nën-objektiva për të përmirësuar identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të cilësisë së firmës dhe të hartojë e zbatojë përgjigjet/reagimet përkatëse.

Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të cilësisë (Ref. Para. 25)

- A45. Mund të ketë kushte, ngjarje, rrethana, veprime ose mosveprime të tjera, që nuk janë përshkruar në paragrafi n25 (a), të cilat mund të ndikojnë negativisht arritjen e një objekti për cilësinë.
- A46. Një rrezik lind nga mënyra dhe shkalla në të cilën, një kusht, ngjarje, rrethanë, veprim ose mosveprim, mund të ndikojë negativisht arritjen e një objekti për cilësinë. Jo të gjithë rreziqet plotësojnë përkufizimin e rrezikut të cilësisë. Gjykimi profesional e ndihmon firmën në përcaktimin nëse një rrezik është një rrezik i cilësisë, i bazuar në vlerësimin e firmës për faktin nëse ekziston një mundësi e arsyeshme që rreziku të ndodhë, dhe individualisht ose në kombinim me rreziqe të tjera, mund të ndikojë negativisht arritjen e një ose më shumë objektivave të cilësisë.

<i>Shembuj të njohjes dhe kuptimit nga firma të kushteve, ngjarjeve, rrethanave, veprimeve ose mosveprimeve të tjera, të cilat mund të ndikojnë negativisht arritjen e objektivave për cilësinë</i>	Shembuj të rreziqeve për cilësinë që mund të lindin
<ul style="list-style-type: none"> Vendimet dhe veprimet strategjike dhe operacionale, proceset e biznesit dhe modeli i biznesit të firmës: Qëllimet e përgjithshme financiare të firmës janë tepër të varura nga shtrirja e shërbimeve që jepen nga firma, të cilat nuk janë brenda objektit të këtij SNMC. 	<p>Ne kontekstin e qeverisjes dhe të lidërshiptit , kjo mund të çojë në një numër rreziqesh për cilësinë, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> Burimet janë alokuar ose janë caktuar në një mënyrë që i jep prioritet shërbimeve, të cilat nuk janë brenda objektit të këtij SNMC dhe kjo mund të ndikojë negativisht cilësinë e angazhimeve që janë brenda objektit të këtij SNMC. Vendimet rreth prioriteteve financiare dhe operacionale, nuk mbajnë parasysh fare ose nuk konsiderojnë në mënyrë të mjaftueshme, rëndësinë e cilësisë në

	performancën e angazhimeve brenda objektit të këtij SNMC.
<ul style="list-style-type: none"> Karakteristikat dhe stili i menaxhimit dhe lidershipit: Firma është e vogël, me pak partnere angazhimi me autoritet të përbashkët (qe ndahet midis tyre) 	<p>Ne kontekstin e qeverisjes dhe të lidershipit , një gjë e tillë mund të çojë në një numër rreziqesh për cilësinë, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> Përgjegjësitë e lidershipit dhe llogaridhenia për cilësinë nuk janë përkufizuar dhe caktuar në mënyrën e duhur Veprimet dhe sjelljet e lidershipit, të cilat nuk promovojnë cilësi, nuk janë analizuar.
<ul style="list-style-type: none"> Kompleksiteti dhe karakteristikat e shfrytëzimit të firmës: Kohët e fundit, firma ka realizuar bashkimin/shkrirjen e saj me një firmë tjetër 	<p>Ne kontekstin e burimeve, kjo mund të çojë në një numër rreziqesh për cilësinë, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> Burimet teknologjike të përdorura nga të dy firmat që bashkohen, mund të jenë inkompatibel Grupet e angazhimit mund të përdorin burime intelektuale të zhvilluara nga një firmë para bashkimit, të cilat nuk janë në koherence me metodologjinë e re që po përdoret nga firma e re, e krijuar nga bashkimi

A47. Duke pasur parasysh natyrën në zhvillim të sistemit të menaxhimit të cilësisë, përgjigjet/ reagimet që hartohen dhe zbatohen nga firma, mund të çojnë në kushte, ngjarje, rrethana, veprime ose mosveprime, që rezultojnë në rreziqe të mëtejshme të cilësisë. Për shembull, firma mund të zbatojë një burim (p.sh., një burim teknologjik) për të adresuar një rrezik të cilësisë, dhe nga përdorimi i këtij burimi mund të lindin rreziqe të cilësisë.

A48 Shkalla në të cilën një rrezik, individualisht, ose në kombinim me rreziqe të tjera, mund të ndikojë negativisht arritjen e një objektivi cilësor mund të ndryshojë në bazë të kushteve, ngjarjeve, rrethanave, veprimeve ose mosveprimeve që çojnë në rrezik, duke marrë parasysh, për shembull:

- Mënyrën se si do të ndikonte kushti, ngjarja, rrethana, veprimi ose mosveprimi në arritjen e objektivit të cilësisë.
- Sa shpesh pritet të ndodhë kushti, ngjarja, rrethana, veprimi ose mosveprimi.
- Sa kohë do të duhej për efektin, pasi të ndodhte kushti, ngjarja, rrethana, veprimi ose mosveprimi, dhe fakti nëse brenda kësaj kohe firma do të kishte një mundësi të përgjigjet/reagonte për të zbutur efektin e kushtit, ngjarjes, rrethanës, veprimit ose mosveprimit.
- Sa kohë, kushti, ngjarja, rrethana, veprimi ose mosveprimi do të ndikonin arritjen e objektivit të cilësisë, pasi ato kanë ndodhur.

Vlerësimi i rreziqeve të cilësisë nuk ka nevojë të përfshijë vlerësime ose rezultate formale, megjithëse firmat nuk e përjashtojnë përdorimin e tyre.

Hartimi dhe zbatimi i reagimeve/përgjigjeve për të adresuar rreziqet e cilësisë (Ref: Para. 16 (u), 26)

- A49. Natyra, afatet dhe shtrirja e përgjigjeve/reagimeve bazohen në arsyet e dhëna për vlerësimin e rreziqeve të cilësisë, që është konsideruar ndodhja dhe efekti në arritjen e një ose më shumë objektivave të cilësisë.
- A50. Përgjigjet e hartuara dhe të zbatuara nga firma, mund të jenë në nivel firmë ose angazhimi ose mund të ketë një kombinim të përgjegjësisë për veprimet që duhen ndërmarrë në nivel firmë dhe nivel angazhimi.

Shembull i një përgjigje të hartuar (përgatitur) dhe zbatuar nga firma e cila përdoret si në nivel firmë ashtu edhe në niveli i angazhimi

Firma vendos politika ose procedura për konsultimet, të cilat tregojnë se me kë duhet të konsultohen grupet e angazhimit dhe, çështjet specifike për të cilat kërkohen konsultime. Firma cakton individë që kanë kualifikimin dhe përvojën e duhur për të dhënë konsultime. Grupi i angazhimit ka përgjegjësinë për identifikimin e çështjeve që kanë nevojë për konsultim, inicion konsultimin, dhe zbaton konkluzionet e konsultimit.⁹

- A51 Nevoja për politika ose procedura të dokumentuara zyrtarisht, mund të jetë më e madhe për firmat që kanë shumë personel ose që janë të shpërndarë gjeografikisht, në mënyrë që të arrihet qëndrueshmëri e tyre për të gjithë firmën.

Ndryshimet në natyrën dhe rrethanat e firmës ose angazhimet e saj (Ref. Para. 27)

A52 *Shembull i shkallëzimit që shërben për të treguar mënyrën se si mund të ndryshojnë politikat ose procedurat për identifikimin e informacionit rreth ndryshimeve në natyrën dhe rrethanat e firmës dhe angazhimet e saj*

- Në një firmë më pak komplekse, mund të ketë politika ose procedura jo formale për të identifikuar informacionet në lidhje me ndryshimet në natyrën dhe rrethanat e firmës ose angazhimet e saj, veçanërisht kur individët përgjegjës për vendosjen e objektivave të cilësisë, identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të cilësisë dhe hartimin e zbatimit të përgjigjeve /reagimeve, janë në gjendje të identifikojë këto informacione në rrjedhën normale të aktiviteteve të tyre.
- Në një firmë më shumë komplekse, mund të lindë nevoja të vendosen politika ose procedura më formale, për të identifikuar dhe vlerësuar informacionet rreth ndryshimeve në natyrën

⁹ SNA 220 (i rishikuar) paragrafi 35

dhe rrethanat e firmës ose angazhimet e saj. Këto mund të përfshijnë, për shembull, një rishikim periodik të informacioneve, që lidhet me natyrën dhe rrethanat e firmës dhe angazhimet e saj, përfshirë gjurmimin e vazhdueshëm dhe ndjekjen e tendencave dhe dukurive në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të firmës.

- A53 Si pjesë e veprimeve përmirësuese të korigjimit të mangësive të kryera nga firma për të adresuar një mangësi të identifikuar në përputhje me paragrafin 42, mund të linde nevoja të vendosen objektiva shtesë për cilësinë, të shtohen ose modifikohen rreziqet dhe përgjigjet/reagimet ndaj rreziqeve për cilësinë.
- A54 Firma mund të ketë vendosur objektiva shtesë të cilësisë, përveç atyre të përcaktuara në këtë SNMC. Gjithashtu, firma mund të identifikojë informacionin që tregon se objektivat shtesë të cilësisë tashmë të vendosura nga firma nuk janë më të nevojshme, ose kanë nevojë të modifikohen.

Qeverisja dhe lidershipi

Angazhimi për cilësinë (Ref: Paragrafi 28 (a))

- A55 Kultura e firmës është një faktor i rëndësishëm që influencon sjelljen e personelit. Kërkesat përkatëse etike, zakonisht përcaktojnë parimet e etikës profesionale, ato janë adresuar më tej në komponentin e kërkesave përkatëse etike të këtij SNMC. Vlerat dhe qëndrimet profesionale mund të përfshijnë:
- Mënyrën profesionale, për shembull, afatin kohor, mirësjelljen, respektin, llogaridhënien, përgjegjshmërinë dhe ndërvlerësinë.
 - Angazhimin për punën në grup.
 - Mbajtjen e një mendje të hapur ndaj ideve të reja ose perspektivave të ndryshme në mjedisin profesional.
 - Ndjekjen e përsosmërisë.
 - Angazhimin për përmirësim të vazhdueshëm (p.sh., vendosjen e pritshmërive përtej kërkesave minimale dhe vendosja e fokusit në edukimin e vazhdueshëm).
 - Përgjegjësinë sociale.
- A56 Procesi i vendimmarrjes strategjike të firmës, përfshirë vendosjen e një strategjie biznesi, mund inkludojë çështje të tilla, si vendimet e firmës në lidhje me çështjet financiare dhe operacionale, qëllimet financiare, mënyrën e menaxhimit të burimeve financiare, rritjen e pjesës së tregut të firmës, specializimin sipas sektorëve ose ofrimi i shërbimeve të reja. Prioritetet financiare dhe operacionale të firmës mund të ndikojnë drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte në angazhimin e firmës ndaj cilësisë, për shembull, firma mund të ketë stimuluj që janë të fokusuar në prioritetet financiare dhe operacionale, të cilat mund të dekurajojnë sjelljet që nuk demonstrojnë një angazhim për cilësinë.

Lidershipi (Ref: Paragrafi 28 (b) dhe 28 (c))

- A57 Përgjigjet e hartuara (te përgatitura) dhe të zbatuara nga firma për të mbajtur përgjegjësitë e lidershit dhe llogaridhënien për cilësinë, përfshijnë vlerësimet e performancës të kërkuara nga paragrafi 56.
- A58 Megjithëse lidershi e vendos tonin në krye përmes veprimeve dhe sjelljeve të tij, veprimet e qarta dhe komunikimet e qëndrueshme dhe të shpeshta në të gjitha nivelet brenda firmës kontribuojnë kolektivisht në kulturën e firmës dhe demonstrojnë një angazhim ndaj cilësisë.

Struktura organizative (Ref: Paragrafi 28 (d))

- A59 Struktura organizative e firmës mund të përfshijë njësite operative (te shfrytëzimit), proceset operacionale, departamentet ose vendndodhjet gjeografike dhe struktura të tjera. Në disa raste, firma mund të përqendrojë ose centralizojë proceset apo aktivitetet në një qendër të dhënies së shërbimeve dhe grupet e angazhimit mund të kenë personel nga qendra e dhënies së shërbimeve të firmës, të cilët kryejnë detyra specifike që përsëriten ose kanë natyrë të specializuar.

Burimet (Ref: Paragrafi 28 (e))

- A60 Individët me përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien ose përgjegjësinë operacionale për sistemin e menaxhimit të cilësisë, në shumicën e rasteve janë në gjendje të ndikojë në natyrën dhe shtrirjen e burimeve që firma merr, zhvillon, përdor dhe mirëmban, si dhe mënyrën se si këto burime janë ndare ose caktuar, përfshirë afatet kur ato janë përdorur.
- A61 Meqenëse nevojat për burime mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, nuk mund të parashikohen të gjitha nevojat për burime. Planifikimi i burimeve të firmës mund të përfshijë përcaktimin e burimeve që kërkohen aktualisht, parashikimin e nevojave të firmës për burime të ardhshme dhe vendosjen e proceseve për t'u marrë me nevojat për burime të paparashikuara, kur ato lindin.

Kërkesat përkatëse etike (Ref: Paragrafi 16 (t), 29)

- A62 Kodi IESBA shpall parimet themelore të etikës, të cilat vendosin standardet e sjelljes që priten nga një profesionist kontabël dhe vendos Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë. Parimet themelore janë integriteti, objektiviteti, kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur, konfidencialiteti dhe sjellja profesionale. Kodi IESBA gjithashtu, specifikon metodën që duhet të zbatohet nga një profesionist kontabël për të qenë në përputhje me parimet themelore dhe, kur është e zbatueshme, Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë. Veç kësaj, Kodi IESBA adreson çështje specifike, që lidhen me pajtueshmërinë me parimet themelore. Ligji ose rregulli në një juridiksion të caktuar gjithashtu, mund të përmbajë dispozita që adresojnë kërkesat etike, përfshirë pavarësinë, siç janë ligjet e privatësisë që ndikojnë në konfidencialitetin e informacionit.
- A63 Në disa raste, çështjet e adresuara nga firma, në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë mund të jenë më specifike, ose shtesë, e dispozitave të kërkesave përkatëse etike.

Shembuj të çështjeve që një firmë mund të përfshijë në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë, të cilat janë më shumë specifike, ose shtesë e dispozitave të kërkesave përkatëse etike

- Firma ndalon pranimin e dhuratave dhe të mikpritjes nga një klient, edhe nëse vlera është e vogël dhe krejt e parëndësishme.
- Firma cakton periudha rotacioni për të gjithë partnerët e angazhimit, përfshirë ata që kryejnë angazhime të tjera të sigurisë ose angazhime të shërbimeve të lidhura, dhe zgjeron periudhat e rotacionit për të gjithë individët në pozicionin e anëtarit senior në grupin e angazhimit.

A64 Komponentë të tjerë mund të ndikojnë ose që lidhen me komponentin e kërkesave përkatëse etike.

Shembuj të marrëdhënieve midis komponentit të kërkesave përkatëse etike dhe komponentëve të tjerë

- Komponenti i informacionit dhe komunikimit mund të adresojë komunikimin e çështjeve të ndryshme që lidhen me kërkesat përkatëse etike, dhe përfshin si me poshtë:
 - Firma komunikon kërkesat e pavarësisë për të gjithë personelin dhe të tjerët që i nënshtrohen kërkesave të pavarësisë.
 - Personeli dhe grupet e angazhimit i komunikojnë firmës informacionin përkatës, pa patur frikë nga hakmarrjet, siç janë situatat që mund të krijojnë kërcënime ndaj pavarësisë, ose shkeljet e kërkesave përkatëse etike.
- Si pjesë e komponentit të burimeve, firma mund të:
 - Caktojë individët me detyrën për të menaxhuar dhe monitoruar pajtueshmërinë me kërkesat përkatëse etike ose për të dhënë konsultime për çështjet që lidhen me kërkesat përkatëse etike.
 - Përdore aplikacionet e TI -së për të monitoruar pajtueshmërinë me kërkesat përkatëse etike, përfshirë regjistrimin dhe ruajtjen e informacionit në lidhje me pavarësinë.

A65 Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për të tjerët, varen nga dispozitat e kërkesave përkatëse etike dhe mënyra se si firma përdor të tjerët në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë ose për kryerjen e angazhimeve.

Shembuj të kërkesave përkatëse etike që zbatohen për të tjerët

- Kërkesat përkatëse etike mund të përfshijnë kërkesat për pavarësinë, që zbatohen për firmat e rrjetit ose punonjësit e firmave të rrjetit, për shembull, Kodi IESBA përfshin kërkesat e pavarësisë që zbatohen për firmat e rrjetit.
- Kërkesat përkatëse etike mund të përfshijnë një përkufizim të grupit të angazhimit ose koncepte të tjera të ngjashme dhe përkufizimi mund të përfshijë çdo individ që kryen

procedura të sigurisë për angazhimin (p.sh., audituesi i një komponenti ose një ofrues shërbimi i angazhuar për të marrë pjesë në numërimin fizik të inventarit fizik në një vend të largët). Prandaj, çdo kërkesë e kërkesave përkatëse etike që zbatohen për grupin e angazhimit, siç përcaktohet në kërkesat përkatëse etike ose koncepte të tjera të ngjashme, mund të jenë gjithashtu, të përshtatshme për këta individë.

- Parimi i konfidencialitetit mund të zbatohet për rrjetin e firmës, firmat e tjera të rrjetit ose ofruesit e shërbimeve, kur ata kanë akses në informacionin e klientit të siguruar nga firma.

Konsiderata për sektorin publik

A66 Për arritjen e objektivave të cilësisë në këtë SNMC, në lidhje me pavarësinë, audituesit e sektorit publik mund të adresojnë pavarësinë në kontekstin e mandatit të audituesit në sektorin publik dhe masave statusore.

Pranimi dhe vazhdimi i marrëdhënieve me klientin dhe angazhimet specifike

Natyra dhe rrethanat e angazhimit dhe integriteti e vlerat etike të klientit (Ref: Para 30 (a) (i))

A67 Informacioni i siguruar në lidhje me natyrën dhe rrethanat e angazhimit, mund të përfshijë:

- Sektorin e ekonomisë të entitetit për të cilin është ndërmarrë angazhimi dhe faktorët përkatës rregullatore;
- Natyrën e entitetit, për shembull, operacionet e tij, strukturën organizative, pronësinë dhe qeverisjen, modelin e tij të biznesit dhe mënyrën e financimit; dhe
- Natyrën e çështjes baze që shqyrtohet dhe kriteret e zbatueshme, për shembull, në rastin e raportimit të integruar:
 - Çështja në fjale mund të përfshijë informacion për sigurinë, shëndetin dhe mjedisin; dhe
 - Kriteret e zbatueshme mund të jenë matësit e performancës, të përcaktuara nga një organizëm i njohur i ekspertëve

A68 Informacioni i siguruar për të mbështetur gjykimet e firmës në lidhje me integritetin dhe vlerat etike të klientit mund të përfshijë identitetin dhe reputacionin e biznesit, të pronarëve kryesorë të klientit, drejtuesve kryesorë dhe personave të ngarkuar me qeverisjen e tij.

Shembuj të faktorëve që mund të ndikojnë natyrën dhe shtrirjen e informacionit të marrë në lidhje me integritetin dhe vlerat etike të klientit

- Natyra e entitetit për të cilin kryhet angazhimi, përfshirë kompleksitetin e strukturës së pronësisë dhe të menaxhimit të tij.
- Natyra e operacioneve të klientit, përfshirë praktikën e tij të biznesit.
- Informacioni në lidhje me qëndrimin e pronarëve kryesorë të klientit, drejtuesve kryesorë dhe personat e ngarkuar me qeverisjen, ndaj çështjeve të tilla si interpretimi agresiv i standardeve të kontabilitetit dhe mjedisi i kontrollit të brendshëm.

- Fakti nëse klienti është shume i shqetësuar për mbajtjen e tarifave të firmës sa të jete e mundur të ulëta.
- Indikacionet se një klient imponon kufizim në objektin e punës.
- Indikacionet se klienti mund të jetë i përfshirë në pastrim parash ose aktivitete të tjera kriminale.
- Arsyet për emërimin e propozuar të firmës dhe mos emërimin e firmës së mëparshme.
- Identiteti dhe reputacioni i biznesit të palëve të lidhura.

A69 Firma mund të siguroje informacionet nga një sërë burimesh të brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë:

- Në rastin e një klienti ekzistues, informacione nga angazhimet aktuale ose të mëparshme, nëse kjo është e mundur, ose nga kërkesat drejtuar anëtarëve të tjerë të personelit, të cilët kanë kryer angazhime të tjera për klientin.
- Në rastin e një klienti të ri, nga kërkesat për informacione për ofruesit ekzistues ose të mëparshëm të shërbimeve profesionale kontabël për klientin, në përputhje me kërkesat përkatëse etike.
- Nga diskutimet me palët e tjera të treta, të tilla si bankierë, këshilltarë ligjorë dhe kolegë të sektorit të ekonomisë.
- Nga kërkimet në bazat e të dhënave përkatëse (të cilat mund të jenë burime intelektuale). në disa raste, firma mund të përdorë një ofrues shërbimi për të kryer kërkime në sfond.

A70 Informacioni që është siguruar gjatë procesit të pranimit dhe vazhimit me firmën, shpesh mund të jetë gjithashtu, i përshtatshëm për grupin e angazhimit kur planifikon dhe kryen angazhimin. Në mënyrë specifike, standardet profesionale mund të kërkojnë që grupi i angazhimit të siguroje ose të marrë në konsideratë këto informacione. Për shembull, SNA 220 (i rishikuar)¹⁰ kërkon që partneri i angazhimit të mbajë parasysh informacionin e siguruar gjatë procesit të pranimit dhe vazhimit në planifikimin dhe kryerjen e angazhimit të auditimit.

A71 Standardet profesionale ose kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, mund të përfshijnë dispozita specifike, të cilat duhet të jenë adresuar përpara se të pranohet ose vazhdohet një marrëdhënie me klientin ose një angazhim specifik dhe gjithashtu, ato mund të kërkojnë nga firma që të bëjë kërkesa për informacione tek një firmë ekzistuese ose e mëparshme, kur pranohet një angazhim. Për shembull, kur ka patur një ndryshim të audituesve, SNA 300¹¹ kërkon që audituesi, para nisjes së punës në një auditim fillestar, të komunikojë me audituesin paraardhës në pajtueshmëri me kërkesat përkatëse etike. Kodi IESBA gjithashtu, përfshin kërkesa për vlerësimin e konfliktit të interesave në pranimin ose vazhdimin e një marrëdhënie me klientin ose kryerjen e

¹⁰SNA 220 (i rishikuar), paragrafi 23

¹¹ SNA 300, Planifikimi i një auditimi të pasqyrave financiare, paragrafi 13(b)

një angazhimi specifik dhe komunikimin me firmën ekzistuese ose të mëparshme, kur pranohet një angazhim që është një auditim ose rishikim i pasqyrave financiare.

Aftësia e firmës për të kryer angazhimin (Ref: Paragrafi 30 (a) (ii))

A72 Aftësia e firmës për të kryer angazhimin në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore mund të ndikohet nga:

- Disponibiliteti i burimeve të përshtatshme për të kryer angazhimin;
- Te paturit akses në informacion për të kryer angazhimin, ose tek personat që e japin këtë informacion; dhe
- Fakti nëse firma dhe grupi i angazhimit janë në gjendje të përmbushin përgjegjësitë e tyre në lidhje me kërkesat përkatëse etike
-

Shembuj të faktorëve që firma mund të konsiderojë kur përcakton nëse janë në dispozicion burimet e duhura për të kryer angazhimin

- Rrethanat e angazhimit dhe afati i raportimit.
- Disponibiliteti i individëve me kompetencat dhe aftësitë e duhura, përfshirë kohën e mjaftueshme, për të kryer angazhimin. Kjo kërkon:
 - Individët të marrin përgjegjësitë e përgjithshme për drejtimin dhe mbikëqyrjen e angazhimit;
 - Individë që kanë njohuri për sektorin përkatës të ekonomisë ose çështjen kryesore në shqyrtim ose kriteret që do të aplikohen në përgatitjen e informacionit për çështjen në shqyrtim dhe eksperiencën me kërkesat përkatëse rregullatore ose të raportimit; dhe
 - Individët të kryejnë procedura auditimi mbi informacionin financiar të një përbërësi për qëllime të një auditimi të pasqyrave financiare të grupit.
- Disponibiliteti i ekspertëve, nëse duhet.
- Kur nevojitet një rishikim i cilësisë së angazhimit, fakti nëse ka një individ disponibël, i cili plotëson kërkesat për t'u përzgjedhur, siç janë dhëna në SNMC 2.
- Nevoja për burime teknologjike, për shembull, aplikacione të TI -së, të cilat i japin mundësi grupit të angazhimit të kryejnë procedura mbi të dhënat e entitetit.
- Nevoja për burime intelektuale, për shembull, një metodologji, udhëzues të veçantë të industrisë ose të çështjes në fjale., apo akses (te drejta hyrje) në burimet e informacionit

Prioritetet financiare dhe operacionale të firmës (Ref. Paragrafi 30 (b))

A73 Prioritetet financiare mund të fokusohen në përfitueshmërinë e firmës, dhe tarifat (honorarët) e arkëtuara nga kryerja e angazhimeve ndikojnë në burimet financiare të firmës. Prioritetet operacionale mund të përfshijnë fusha me fokus strategjik, siç janë rritja e pjesës së tregut, specializimi i sektorit të ekonomisë ose ofrimi nga firma i shërbimeve të reja. Ne disa rrethana mund të jete e kënaqur me honorarin e kuotuar për një angazhim, por nuk është e përshtatshme

që ajo të pranojë ose vazhdojë angazhimin apo marrëdhënien me klientin (p.sh., kur klientit i mungon integriteti dhe vlerat etike).

- A74 Në rrethana të tjera kur honorari i kuotuar për një angazhim mund të mos jete i mjaftueshëm, për shkak të natyrës dhe rrethanave të angazhimit, dhe kjo mund të zvogëlojë aftësinë e firmës për të kryer angazhimin në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore e rregullatore në fuqi. Kodi IESBA adreson honorarët dhe llojet e tjera të shpërblimit, përfshirë rrethanat që mund të krijojnë një kërcënim për pajtueshmërinë me parimin themelor të kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur, nëse honorari i kuotuar për një angazhim është shumë i ulët.

Performanca (kryerja) e angazhimit

Përgjegjësitë e grupit të angazhimit dhe drejtimi, mbikëqyrja dhe rishikimi (Ref: Paragrafi 31 (a) dhe 31 (b))

- A75 Standardet profesionale ose kërkesat e zbatueshme ligjore e rregullatore mund të përfshijnë dispozita specifike në lidhje me përgjegjësinë e përgjithshme të partnerit të angazhimit. Për shembull, SNA 220 (i rishikuar) trajton përgjegjësinë e përgjithshme të partnerit të angazhimit për menaxhimin dhe arritjen e cilësisë në angazhim dhe për të marrë pjesë në mënyrë të mjaftueshme dhe të përshtatshme gjatë gjithë angazhimit, përfshirë përgjegjësinë për drejtimin dhe mbikëqyrjen e duhur të grupit të angazhimit dhe rishikimin e punës së tyre.

A76 Shembuj të drejtimit, mbikëqyrjes dhe rishikimit

- Drejtimi dhe mbikëqyrja e grupit të angazhimit mund të përfshijë:
 - Ndjekjen e progresit të angazhimit;
 - Vlerësimin e anëtarëve të grupit të angazhimit, nëse:
 - Ata i kuptojnë udhëzimet e tyre; dhe
 - Puna po kryhet në përputhje me metodën e planifikuar për angazhimin
 - Adresimin e çështjeve që dalin gjatë angazhimit, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre dhe modifikimin e metodës së planifikuar në mënyrë të përshtatshme; dhe
 - Identifikimin e çështjeve që gjatë angazhimit kanë nevojë për konsultim ose shqyrtim nga anëtarët e grupit të angazhimit me më shumë përvojë.
- Një rishikim i punës së kryer mund të përfshijë vlerësimin nëse:
 - Puna është kryer në përputhje me politikat ose procedurat e firmës, standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore;
 - Janë ngritur për shqyrtim të mëtijshëm çështje të rëndësishme;
 - Janë ndërmarrë konsultimet e duhura dhe përfundimet e tyre janë dokumentuar dhe zbatuar;
 - Ekziston nevoja për të rishikuar natyrën, afatet dhe shtrirjen e punës së planifikuar;
 - Puna e kryer mbështet përfundimet e arritura dhe është dokumentuar në mënyrë të përshtatshme

- Evidenca e siguruar për një angazhim të sigurisë, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur raportin; dhe
- Janë arritur objektivat e procedurave të angazhimit.

A77 Në disa rrethana, firma mund të përdorë personelin nga një qendër e dhënies së shërbimeve në firmë, ose individët nga një qendër e dhënies të shërbimeve të një firmë tjetër të rrjetit, për të kryer procedurat për angazhimin (d.m.th., në grupin e angazhimit janë përfshirë personel ose individë të tjerë). Në këto rrethana, politikat ose procedurat e firmës mund të adresojnë, në mënyrë specifike, drejtimin dhe mbikëqyrjen e individëve dhe rishikimin e punës së tyre, siç janë:

- Cilat aspekte të angazhimit mund t'u caktohen individëve në qendrën e ofrimit të shërbimeve;
- Mënyra që parashikohet nga partneri i angazhimit, ose i deleguari i tij, për të drejtuar, mbikëqyrur dhe rishikuar punën e kryer nga individët në qendrën e ofrimit të shërbimeve; dhe
- Protokollet e komunikimit midis grupit të angazhimit dhe individëve në qendrën e dhënies së shërbimeve.

Gjykimi profesional dhe skepticizmi profesional (Ref: Paragrafi 31 (c))

A78 Skepticizmi profesional mbështet cilësinë e gjykimeve të bëra në një angazhim të sigurisë dhe, përmes këtyre gjykimeve, efektivitetin e përgjithshëm të grupit të angazhimit, në kryerjen e angazhimit të sigurisë. Deklarata të tjera të BSNAS-se-së mund të adresojnë ushtrimin e gjykimit profesional ose skepticizmit profesional në nivel angazhimi. Për shembull, SNA 220 (i rishikuar)¹² jep shembuj të pengesave në ushtrimin e skepticizmit profesional në nivel angazhimi, për paragjykimet e pavullnetshme të audituesit, të cilat mund të pengojnë ushtrimin e skepticizmit profesional dhe për veprimet e mundshme, që grupi i angazhimit mund të ndërmarrë për të zbutur këto pengesa.

Konsultimi (Ref: Paragrafi 31 (d))

A79 Konsultimi zakonisht përfshin një diskutim në nivelin e duhur profesional me individë brenda ose jashtë firmës, të cilët kanë ekspertizë të specializuar për çështje të vështira ose të diskutueshme. Një mjedis që përforcon rëndësinë dhe përfitimin e konsultimit dhe inkurajon grupet e angazhimit për t'u konsultuar mund të kontribuojnë në mbështetjen e një kulture që demonstroi një angazhim ndaj cilësisë.

A80 Çështjet e vështira ose të diskutueshme, për të cilat nevojitet konsultimi, mund të specifikohen nga firma ose, vete grupi i angazhimit mund të identifikojë çështje që kanë nevojë për konsultim. Firma gjithashtu mund të specifikojë mënyrën se si duhet të dakordohen dhe zbatohen përfundimet.

¹² SNA 220 (i rishikuar), paragrafët A34-A36

A81 SNA 220 (i rishikuar)¹³ përfshin kërkesa për partnerin e angazhimit në lidhje me konsultimin.

Diferencat (dallimet) në opinion (Ref: Paragrafi 31 (e))

A82 Firma mund të inkurajojë që dallimet (diferencat) në opinion të identifikohen në një fazë të hershme dhe për këtë, mund të specifikojë hapat që duhen ndiqen për ngritjen dhe trajtimin e tyre, përfshirë mënyrën se si do të zgjidhet çështja dhe si duhet të zbatohen dhe dokumentohen përfundimet përkatëse. Në disa rrethana, zgjidhja e diferencave në opinione mund të arrihet përmes konsultimit me një profesionit ose një firmë tjetër ose me një organizëm profesional apo rregullator.

Dokumentacioni i angazhimit (Ref: Paragrafi 31 (f))

A83 Ligji, rregulli ose standardet profesionale mund të përcaktojnë afate se kur duhet të përfundojë sistemimi i dosjeve përfundimtare të angazhimit, sipas llojeve të ndryshme të angazhimeve. Aty ku ligji ose rregulli nuk kanë vendosur kufizime të tilla kohore, afatet mund të vendosen nga vete firma. Në rastin e angazhimeve të kryera sipas SNA-ve ose SNAR-ve, një afat kohor i përshtatshëm brenda të cilit duhet përfunduar sistemimi i dosjes përfundimtare të angazhimit, zakonisht nuk është më shumë se 60 ditë pas datës së raportit të angazhimit.

A84 Ruajtja dhe mbajtja e dokumentacionit të angazhimit mund të përfshijë menaxhimin e ruajtjes së sigurte, integritetin, të drejtat e hyrjes ose rivendosjen e të dhënave baze dhe teknologjinë përkatëse. Ruajtja dhe mbajtja e dokumentacionit të angazhimit mund të behet përmes aplikacioneve të TI -së. Integriteti i dokumentacionit të angazhimit mund të komprometohet nëse ndryshohet, plotësohet ose fshihet pa autorizim apo nëse humbet ose dëmtohet përgjithmonë.

A85 Ligji, rregulli ose standardet profesionale mund të përshkruajnë periudhën e ruajtjes për dokumentacionin e angazhimit. Nëse periudhat e mbajtjes nuk janë të përshkruara, firma mund të mbajë parasysh natyrën e angazhimeve të kryera nga firma dhe rrethanat e firmës, përfshirë faktin nëse dokumentacioni i angazhimit nevojitet për të siguruar një regjistrim të çështjeve me rëndësi të vazhdueshme për angazhimet e ardhshme. Në rastin e angazhimeve të kryera sipas SNA-ve ose SNAR-ve periudha e ruajtjes zakonisht është jo më e shkurtër se pesë vjet nga data e raportit të angazhimit, ose, nëse më vonë, nga data e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare të grupit, kur kjo është e aplikueshme.

Burimet (Ref: Para. 32)

A86 Për qëllime të komponentit të burimeve, ne burimet përfshihen:

- Burimet njerëzore.
- Burimet teknologjike, për shembull, aplikimet e TI -së.

¹³ SNA 220 (i rishikuar), paragrafi 35

- Burimet intelektuale, për shembull, politikat ose procedurat e shkruara, një metodologji ose udhëzuesit.

Burimet financiare janë gjithashtu, të përshtatshme për sistemin e menaxhimit të cilësisë, sepse ato duhen për të siguruar, zhvilluar dhe mbajtur burimet njerëzore, burimet teknologjike dhe burimet intelektuale të firmës. Duke qenë se menaxhimi dhe alokimi i burimeve financiare ndikohet shumë nga lidhshipit, objektivat e cilësisë në qeverisje dhe lidhship, siç janë ato që adresojnë prioritetet financiare dhe operacionale, adresojnë burimet financiare.

- A87 Burimet mund të jenë të brendshme të firmës, ose ato mund të merren nga jashtë, prej rrjetit të firmës, një firmë tjetër të rrjetit ose ofruesi i shërbimit. Burimet mund të përdoren në kryerjen e aktiviteteve brenda sistemit të menaxhimit të cilësisë të firmës, ose në kryerjen e angazhimeve si pjesë e funksionimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Në rrethanat kur një burim është siguruar nga rrjeti i firmës ose një firmë tjetër e rrjetit, paragrafët 48–52 janë pjesë e përgjigjeve/reagimeve të hartuara dhe zbatuara nga firma, për arritjen e objektivave në këtë komponent.

Burimet njerëzore

Marrja në pune, zhvillimi dhe mbajtja e personelit dhe kompetencës e aftësive të personelit (Ref: Para. 32 (a), 32 (d))

- A88 Kompetenca është aftësia e individit për të kryer një rol dhe shkon përtej njohjes së parimeve, standardeve, koncepteve, fakteve dhe procedurave; është integrimi dhe aplikimi i kompetencës teknike, zotësive profesionale dhe etikes profesionale, vlerave dhe qëndrimeve profesionale. Kompetenca mund të zhvillohet përmes një shumëllojshmërie metodash, përfshirë edukimin profesional, zhvillimin e vijueshëm profesional, trajnimin, eksperiencën e punës ose stërvitjen/trajnimin e anëtarëve të grupit të angazhimit me më pak përvojë nga anëtarët e grupit të angazhimit me më shumë përvojë.
- A89 Ligji, rregullat ose standardet profesionale mund të vendosin kërkesa të cilat adresojnë kompetencën dhe aftësitë, të tilla si kërkesat për licencimin profesional të partnerëve të angazhimit, përfshirë kërkesat në lidhje me edukimin dhe zhvillimin e vijueshëm profesional.

A90 *Shembuj të politikave ose procedurave që lidhen me marrjen në pune, zhvillimin dhe mbajtjen e personelit*

Politikat ose procedurat e hartuara dhe të zbatuara nga firma në lidhje me marrjen në pune, zhvillimin dhe mbajtjen e personelit mund të adresojnë:

- Rekrutimin e individëve që kanë, ose janë në gjendje të zhvillojnë, kompetencën e duhur.
- Programet e trajnimit, të fokusuara në zhvillimin e kompetencës së personelit dhe zhvillimin e tij të vijueshëm profesional.

- Mekanizmat e vlerësimit, që ndërmerren në intervale të përshtatshme dhe përfshijnë fushat e kompetencës dhe matësit e tjerë të performancës.
- Kompensimin, promovimin dhe stimuj të tjerë, për të gjithë personelin, përfshirë partnerët e angazhimit dhe individët me role e përgjegjësi që lidhen me sistemin e menaxhimit të cilësisë së firmës.

Angazhimi i personelit ndaj cilësisë dhe llogaridhënies dhe pranimi prej tij, i angazhimit ndaj cilësisë (Ref: Para 32 (b))

- A91 Vlerësimet në kohe dhe informacionet e marra ndihmojnë në mbështetjen dhe promovimin e zhvillimit të vazhdueshëm të kompetencës së personelit. Në rastet e firmave që kanë pak personel, për vlerësimin dhe marrjen e informacioneve mund të përdoren metoda më pak formale.
- A92 Veprimet ose sjelljet pozitive të personelit mund të njihen dhe vlerësohen, duke përdorur mjete të ndryshme, si përmes kompensimit, promovimit ose stimujve të tjerë. Në disa rrethana, mund të jenë të përshtatshme stimuj të thjeshtë ose joformale, që nuk bazohen në shpërblime monetare
- A93 Mënyra në të cilën firma e mban personelin llogaridhënës (përgjegjës) për veprimet ose sjelljet që ndikojnë negativisht mbi cilësinë, siç është dështimi për të demonstruar një angazhim për cilësinë, zhvillimin dhe mbajtjen e kompetencës, për të kryer rolin e tyre ose për të zbatuar përgjigjet/reagimet e firmës ashtu siç janë hartuar, mund të varet nga natyra e veprimit ose sjelljes, duke përfshirë seriozitetin e saj dhe frekuencën e ndodhjes. Kur personeli demonstroi veprime ose sjellje që ndikojnë negativisht në cilësinë, firma mund të kryejë veprimet e mëposhtme:
- Trajnimin ose zhvillime të tjera profesionale.
 - Duke marrë parasysh efektin e çështjes që vlerësohet, të ndikojë në kompensimin, promovimin ose stimulimet e tjera për individët e përfshirë.
 - Veprimet disiplinore, nëse është nevoja.

Individët e marre nga burimet e jashtme (Ref. Paragrafi 32 (c))

- A94 Standardet profesionale mund të përfshijnë përgjegjësitë për partnerin e angazhimit në lidhje me përshtatshmërinë e burimeve. Për shembull, SNA 220 (i rishikuar)¹⁴ adreson përgjegjësinë e partnerit të angazhimit për vlerësimin nëse janë siguruar ose janë vene në dispozicion të grupit të angazhimit në kohën e duhur dhe në përputhje me politikat ose procedurat e firmës, burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të kryer angazhimin.

Anëtarët e grupit të angazhimit të caktuar për çdo angazhim (Ref: Paragrafi 32 (d))

- A95 Anëtarët e grupit të angazhimit mund të jenë caktuar për kryerjen e angazhimeve nga:
- Firma, përfshirë caktimin e personelit nga një qendër e ofrimit të shërbimeve në firmë.

¹⁴ SNA 220 (i rishikuar), paragrafi 25

- Rrjeti i firmës ose një firmë tjetër e rrjetit, kur firma përdor individë të firmës rrjet ose të një firmë tjetër të rrjetit, për të kryer procedura mbi angazhimin (p.sh., audituesi i një komponenti ose një qendër e ofrimit të shërbimeve e rrjetit ose një firmë tjetër të rrjetit).
- Një ofrues shërbimi kur, për të kryer procedurat mbi angazhimin, firma përdor individë nga një ofrues shërbimi (p.sh., audituesi i një komponenti nga një firmë që nuk është brenda rrjetit të firmës).

A96 SNA 220 (i rishikuar)¹⁵ adreson përgjegjësinë e partnerit të angazhimit për të vlerësuar se anëtarët e grupit të angazhimit dhe çdo ekspert i jashtëm i audituesit dhe audituesit e brendshëm, të cilët japin ndihmë të drejtpërdrejtë, por nuk janë pjesë e grupit të angazhimit, kolektivisht kanë kompetencën dhe aftësitë e duhura, dhe kohën e mjaftueshme, për të kryer angazhimin. SNA 600, thellohet me tej në mënyrën se si do të zbatohet SNA 220 (i rishikuar)¹⁶ në lidhje me një auditim të pasqyrave financiare të grupit. Përgjigjet/reagimet e hartuara dhe të zbatuara nga firma për të adresuar kompetencën dhe aftësitë e anëtarëve të grupit të angazhimit të caktuar me angazhimin mund të përfshijnë politika ose procedura që adresojnë:

- Informacionin që mund të jete siguruar nga partneri i angazhimit dhe faktorët që duhen mbajtur parasysh kur vlerësohet nëse anëtarët e grupit të angazhimit të caktuar për angazhimin, përfshirë ata të caktuar nga rrjeti i firmës, një firmë tjetër rrjeti ose ofruesi i shërbimit, kanë kompetencën dhe aftësitë për të kryer angazhimin.
- Mënyrën se si mund të zgjidhen shqetësimet për kompetencën dhe aftësitë e anëtarëve të grupit të angazhimit, veçanërisht të atyre të caktuar nga rrjeti i firmës, një firmë tjetër e rrjetit, ose ofruesi i shërbimit.

A97 Kërkesat në paragrafët 48–52 janë gjithashtu, të zbatueshme kur në një angazhim përdoren individë nga rrjeti i firmës ose një firmë tjetër e rrjetit, përfshirë audituesit e komponentëve (shih, për shembull, paragrafin A179).

Burimet teknologjike (Ref: Para. 32 (f))

A98 Burimet teknologjike, të cilat zakonisht janë aplikacione të TI -së, janë pjesë e mjedisit të TI-së të firmës. Mjedisi i TI-së i firmës përfshin gjithashtu, infrastrukturën mbështetëse të TI-se, proceset e TI-së dhe burimet njerëzore të përfshira në ato procese:

- Një aplikacion i TI-së është një program ose një grup programesh, i krijuar për të kryer një funksion specifik drejtpërdrejt për përdoruesin ose, në disa raste, për një program tjetër aplikimi.
- Infrastruktura e TI -së përbëhet nga rrjeti i TI-se, sistemet operative dhe bazat e të dhënave, dhe hardueri dhe softueri përkatës i tyre.

¹⁵ SNA 220 (i rishikuar), paragrafi 26

¹⁶ SNA 600, Konsiderata të veçanta për auditimin e pasqyrave financiare të grupit (përfshirë punën e audituesve të komponentëve), paragrafi 19

- Proceset e TI-së janë procese të firmës për të menaxhuar aksesin në mjedisin e TI-së, për të menaxhuar ndryshimet në program ose ndryshimet në mjedisin e TI-së dhe për menaxhimin e operacionet e TI-së, që përfshin monitorimin e mjedisit të TI-së.

A99. Një burim teknologjik mund të shërbejë për shume qëllime brenda firmës por disa prej këtyre qëllimeve mund të mos ketë lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë. Burimet teknologjike që janë të rëndësishme për qëllimet e këtij SNMC janë:

- Burimet teknologjike që janë përdorur drejtpërdrejt për hartimin, zbatimin ose funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së firmës;
- Burimet teknologjike që janë përdorur drejtpërdrejt nga grupet e angazhimit në kryerjen e angazhimeve; dhe
- Burimet teknologjike që janë thelbësore për të mundësuar funksionimin efektiv të sa më sipër, të tilla si, në lidhje me një aplikacion të TI-së, infrastruktura e TI-së, dhe proceset e TI-së që mbështesin aplikacionin e TI-se

Shembuj të përdorimit të shkallëzuar (skalabilitetit) për të treguar se si mund të ndryshojnë burimet teknologjike që janë të përshtatshme për qëllimet e këtij SNMC

- Në një firmë më pak komplekse, burimet teknologjike mund të përfshijnë një aplikacion komercial të TI-se, blerë nga një ofrues shërbimi, i cili përdoret e nga grupet e angazhimit. Proceset e TI -së që mbështesin funksionimin e aplikacionit të TI-së mund të jenë gjithashtu, të përshtatshme, edhe pse ato mund të jenë të thjeshta (p.sh., procese për autorizimin e aksesit në aplikacionin e TI-së dhe përpunimin e përditësimeve të aplikacionit të TI-se).
- Në një firmë më shume komplekse, burimet teknologjike mund të jenë më komplekse dhe mund të përfshijnë:
 - o Aplikacione të shumfishta të TI-se, përfshirë aplikacione të zakonshme ose aplikacione të zhvilluara nga rrjeti i firmës, të tilla si:
 - Aplikacionet e TI-së, të përdorura nga ekipet e angazhimit (p.sh., softueri i angazhimit dhe mjete të automatizuara të auditimit).
 - Aplikacionet e TI-se, të zhvilluara dhe të përdorura nga firma për të menaxhuar aspektet e sistemit të menaxhimit të cilësisë (p.sh. aplikacionet e TI-së për të monitoruar pavarësinë ose caktimin e personelit në angazhime).
 - o Proceset e TI-së që mbështesin funksionimin e këtyre aplikacioneve të TI-së, përfshirë individët përgjegjës për menaxhimin e infrastrukturës së TI-së dhe proceseve të TI-se, dhe proceset e firmës për menaxhimin e ndryshimeve të programit në aplikacionet e TI-së

A100. Për marrjen, zhvillimin, zbatimin dhe mbajtjen e një aplikacioni të TI-së firma mund të konsiderojë çështjet e mëposhtme:

- Te dhënat e regjistruara (inputet) janë të plota dhe të përshtatshme;

- Ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave;
- Faktin nëse aplikacioni i TI-së funksionon ashtu siç është krijuar dhe arrin qëllimin për të cilin është parashikuar;
- Rezultatet (outputet) e aplikacionit të TI-së arrijnë qëllimin për të cilin do të përdoren;
- Kontrollat e përgjithshme të TI-së, të nevojshme për të mbështetur funksionimin e vazhdueshëm të aplikacionit të TI-së ashtu siç është hartuar, janë të përshtatshme;
- Nevoja për zotësi të specializuara për të përdorur aplikacionin e TI-së në mënyrë efektive, përfshirë trajnimin e individëve që do të përdorin aplikacionin e TI -së; dhe
- Nevoja për të zhvilluar procedura që përshkruajnë mënyrën si funksionon aplikacioni i TI -së.

A101. Firma mund të ndalojë në mënyrë specifike përdorimin e aplikacioneve të TI -së ose disa aspekte të aplikacioneve të TI-së për një kohe të caktuar, derisa ato të funksionojnë në mënyrë të përshtatshme dhe të jenë aprovuar nga firma për t'u përdorur. Përndryshe, firma mund të vendosë politika ose procedura për të adresuar rrethanat, kur grupi i angazhimit do të përdor një aplikacion të TI-se, të pa miratuar nga firma. Këto politika ose procedurat mund të kërkojnë që grupi i angazhimit të vlerësojë nëse aplikacioni i TI-së është i përshtatshëm për t'u përdorur para se të përdoret në angazhim, përmes vlerësimit të çështjeve në paragrafin A100. SNA 220 (i rishikuar)¹⁷ trajton përgjegjësitë e partnerit të angazhimit për burimet e angazhimit.

Burimet intelektuale (Ref: Para. 32 (g))

A102. Burimet intelektuale përfshijnë informacionet që firma përdor për të mundësuar funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe promovimin e qëndrueshmërisë në kryerjen e angazhimeve.

Shembuj të burimeve intelektuale

Politikat ose procedurat e shkruara, një metodologji, udhëzues i veçantë për sektorin e ekonomisë ose udhëzues për çështje specifike, udhëzues për kontabilitetin, dokumentacioni i standardizuar ose aksesit në burimet e informacionit (p.sh. abonimet në faqet e internetit, të cilat ofrojnë informacion të thelluar në lidhje me entitetet ose informacione të tjera që zakonisht përdoren për kryerjen e angazhimeve).

A103. Burimet intelektuale mund të vihen në dispozicion përmes burimeve teknologjike, për shembull, metodologjia e firmës mund të futet në aplikacionin e TI-së, duke lehtësuar planifikimin dhe kryerjen e angazhimit

Përdorimi i burimeve teknologjike dhe intelektuale (Ref: Para. 32 (f) –32 (g))

A104. Firma mund të vendosë politika ose procedura në lidhje me përdorimin e teknologjisë së firmës dhe të burimeve intelektuale. Këto politika ose procedura mund të:

¹⁷ SNA 220 (i rishikuar), paragrafët 25-28

- Kërkojnë përdorimin e disa aplikacioneve të TI-së ose të burimeve intelektuale për kryerjen e angazhimit, apo për aspekte të tjera të angazhimit, siç është arkivimi i dosjes së angazhimit.
- Specifikojnë kualifikimet ose eksperiencën, që ju nevojitet individëve për të përdorur burimet, përfshirë nevojën për një ekspert ose trajnim, për shembull, firma mund të specifikojë kualifikimet ose ekspertizën e nevojshme për të përdorur një aplikacion të TI-së që analizon të dhënat, duke u nisur nga fakti që për të interpretuar rezultatet mund të kërkojnë aftësi të specializuara.
- Specifikojnë përgjegjësitë e partnerit të angazhimit në lidhje me përdorimin e teknologjisë dhe të burimeve intelektuale.
- Shpjegojnë mënyrën se si do të përdoren burimet teknologjike ose intelektuale, përfshirë mënyrën se si individët do të ndërveprojnë me një aplikacion të TI-së, ose si duhet të përdoren burimet intelektuale, dhe disponibiliteti i mbështetjes ose ndihmës në përdorimin e burimeve teknologjike ose intelektuale.

Ofruesit e shërbimeve (Ref: Paragrafi 16 (v), 32 (h))

A105. Në disa rrethana, firma mund të përdorë burimet që sigurohen nga një ofrues shërbimi, veçanërisht në rrethanat kur firma nuk zotëron burimet e duhura. Pavarësisht se një firmë mund të përdorë burimet e një ofrues shërbimi, ajo ka përgjegjësin për sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë.

Shembuj të burimeve nga një ofrues shërbimi

- Individët që janë angazhuar për të kryer aktivitetet monitoruese të firmës ose rishikimet e cilësisë së angazhimit, ose për të dhënë konsultime për çështje teknike.
- Një aplikacion komercial i TI-së, i përdorur për të kryer angazhimet e auditimit.
- Individët që kryejnë procedura mbi angazhimet e firmës, për shembull, audituesit e komponentit, audituesit nga firma të tjera që nuk janë brenda rrjetit të firmës, ose individët e angazhuar për të marrë pjesë në inventarizimin fizik në një vend të largët.
- Eksperti i jashtëm i një audituesi, i përdorur nga firma për të ndihmuar grupin e angazhimit në sigurimin e evidencës së auditimit.

A106. Për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të cilësisë, firmës i kërkohet të njohe dhe të kuptojë kushtet, ngjarjet, rrethanat, veprimet ose mosveprimet që mund të ndikojnë negativisht në arritjen e objektivat e cilësisë, të cilat përfshijnë kushtet, ngjarjet, rrethanat, veprimet ose mosveprimet që lidhen me ofruesit e shërbimeve. Për këtë firma mund të marrë parasysh natyrën e burimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve, si dhe mënyrën dhe shtrirjen në të cilën ato do të përdoren nga firma, dhe karakteristikat e përgjithshme të ofruesve të shërbimeve të përdorura nga firma (p.sh., llojet e ndryshme të shërbimeve profesionale të firmave të tjera që janë përdorur), me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të cilësisë që lidhen me përdorimin e këtyre burimeve.

A107. Për të përcaktuar nëse një burim nga një ofrues shërbimi është i përshtatshëm për t'u përdorur në sistemin e menaxhimit të cilësisë firmës, ose në kryerjen e angazhimeve, firma mund të marrë informacion lidhur me ofruesin e shërbimit dhe për burimin që ata ofrojnë, nga një numër i ndryshëm burimesh. Çështjet që mund konsiderohen nga firma përfshijnë:

- Objektivin e cilësisë dhe rreziqet e cilësisë. Për shembull, në rastin e një metodologjie nga një ofrues shërbimi, mund të ketë rreziqe cilësore që lidhen me objektivin e cilësisë në paragrafin 32 (g), siç është rreziku i cilësisë që ofruesi i shërbimit nuk përditëson metodologjinë për të pasqyruar ndryshimet në standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.
- Natyrën dhe shtrirjen e burimeve dhe kushtet e shërbimit (p.sh., në lidhje me një aplikacion të TI-së, sa shpesh do të bëhen përditësimet, kufizimet në përdorimin e aplikacionit të TI-së dhe mënyrën se si ofruesi i shërbimit adreson konfidencialitetin).
- Shkallen në të cilën burimi përdoret në të gjithë firmën, mënyrën se si do të përdoret burimi nga firma dhe nëse ai është i përshtatshëm për këtë qëllim.
- Shkallen e personalizimit (customizimit) të burimit për firmën.
- Përdorimin e mëparshëm nga firma të ofruesit të shërbimit.
- Eksperiencën e ofruesit të shërbimit në sektorin e ekonomisë dhe reputacionin në treg.

A108. Firma mund të ketë një përgjegjësi për të kryer veprime të mëtejshme në përdorimin e burimeve nga një ofrues shërbimi, me qëllim që burimi të funksionojë në mënyrë efektive. Për shembull, firma mund të ketë nevojë të komunikojë informacion për ofruesin e shërbimit në mënyrë që burimi të funksionojë në mënyrë efektive, ose, në lidhje me një aplikacion të TI-së, firmës mund ti linde nevoja të ketë infrastrukturë mbështetëse të TI-së dhe procese të TI-së .

Informacioni dhe komunikimi (Ref.: Para. 33)

A109. Marrja, gjenerimi ose komunikimi i informacionit është përgjithësisht një proces i vazhdueshëm që përfshin të gjithë personelin dhe nënkupton shpërndarjen e informacionit brenda firmës dhe jashtë saj. Informacioni dhe komunikimi janë të përhapur në të gjithë komponente e sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Sistemi i informacionit të firmës (Ref: Paragrafi 33 (a))

A110. Informacioni i besueshëm dhe i përshtatshëm përfshin informacionin që është i saktë, i plotë, në kohë dhe i vlefshëm, për të bërë të mundur funksionimin e duhur të sistemit të menaxhimit të cilësisë të firmës dhe për të mbështetur vendimet në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë.

A111. Sistemi i informacionit mund të përfshijë përdorimin e elementeve manualë ose të TI-së, të cilët ndikojnë në mënyrën, në të cilën informacioni identifikohet, kapet, përpunohet, mbahet dhe komunikohet. Procedurat e identifikimit, kapjes, përpunimit, mbajtjes dhe komunikimit të informacionit mund të zbatohen përmes aplikacioneve të TI-së dhe në disa raste, ato mund të

përfshihen brenda përgjigjeve/reagimeve të firmës për komponentët e tjerë. Përveç kësaj, regjistrat digjitale mund të zëvendësojnë ose plotësojnë regjistrat fizike.

Shembull i përdorimit të shkallëzuar për të demonstruar mënyrën se si sistemi i informacionit mund të hartohet (dizajnohet) në një firmë më pak komplekse

Firmat më pak komplekse, që kanë me pak personel dhe përfshirje të drejtpërdrejtë të lidërshit, mund të mos kenë nevojë për politikën dhe procedurën rigoroze që specifikojnë mënyrën sesi informacioni duhet të identifikohet, kapet, përpunohet dhe mbahet.

Komunikimi brenda firmës (Ref: Paragrafi 33 (b), 33 (c))

A112. Firma mund të njohë dhe përforcojë përgjegjësinë e personelit dhe të grupeve të angazhimit, për të shkëmbyer informacione me firmën dhe me njëri -tjetrin, përmes vendosjes së kanaleve të komunikimit për të lehtësuar komunikimin në të gjithë firmën.

Shembuj të komunikimit midis firmës, personelit dhe grupeve të angazhimit

- Firma komunikon përgjegjësinë për zbatimin e përgjigjeve/reagimeve të firmës tek personeli dhe grupet e angazhimit.
- Firma i komunikon personelit dhe grupeve të angazhimit ndryshimet në sistemin e menaxhimit të cilësisë, në masën që këto ndryshime janë të lidhura me përgjegjësitë e tyre dhe, i jep mundësi personelit dhe grupeve të angazhimit, të ndërmarrin veprime të shpejta dhe të përshtatshme në përputhje me përgjegjësitë e tyre.
- Firma komunikon informacionin që është siguruar gjatë procesit të firmës për pranimin dhe vazhdimin, i cili është i përshtatshëm për grupet e angazhimit, për planifikimin dhe kryerjen e angazhimeve.
- Grupet e angazhimit i komunikojnë firmës informacione rreth:
 - Klientit, që janë siguruar gjatë kryerjes së një angazhimi, të cilat mund të kishin bere që firma të refuzonte marrëdhënien me klientin ose angazhimin specifik, në qoftë se këto informacione do të ishin njohur para pranimin ose vazhdimin të marrëdhënies me klientin ose angazhimin specifik.
 - Funksionimit të përgjigjeve/reagimeve të firmës (p.sh. shqetësimet në lidhje me proceset e firmës për caktimin e personelit në angazhimet), të cilat në disa raste, mund të tregojnë një mangësi në sistemin e menaxhimit të cilësisë së firmës.
- Grupet e angazhimit i komunikojnë informacione rishikuesit të cilësisë së angazhimit ose individëve që japin konsultime.
- Grupet e angazhimit të grupit ju komunikojnë çështje audituesve të komponentëve, në përputhje me politikën ose procedurat e firmës, përfshirë çështjet që lidhen me menaxhimin e cilësisë në nivel angazhimi.

- Individët e ngarkuar me përgjegjësinë operationale për pajtueshmërinë me kërkesat e pavarësisë, komunikojnë me personelin përkatës dhe grupet e angazhimit, për ndryshimet në kërkesat e pavarësisë dhe politikat ose procedurat e firmës për të adresuar këto ndryshime.

Komunikimi me palët e jashtme

Komunikimi me ose brenda rrjetit të firmës dhe me ofruesit e shërbimeve (Ref: Paragrafi 33 (d) (i))

A113. Përveç komunikimit të informacionit nga firma për ose brenda rrjetit të firmës, apo për një ofrues shërbimi, firma mund të ketë nevojë të marrë informacione nga rrjeti, një firmë e rrjetit ose një ofrues shërbimi, të cilët mbështetin firmën në hartimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të saj të menaxhimi cilësisë.

Shembull i informacionit të siguruar nga firma nga brenda rrjetit të firmës

Firma merr informacion nga rrjeti, ose firma të tjera të rrjetit, për klientët e firmave të tjera të rrjetit, ku ka kërkesa të pavarësisë që ndikojnë tek firma.

Komunikimi me të tjerët jashtë firmës (Ref: Para. 33 (d) (ii))

A114 *Shembuj të rasteve kur ligji, rregullat ose standardet profesionale mund t'i kërkojnë firmës të komunikojë informacionin tek palët e jashtme*

- Firma vihet në dijeni të papajtueshmërive me ligjet dhe rregullat nga një klient dhe kërkesat përkatëse etike kërkojnë që firma të raportojë këtë mospërputhjen me ligjet dhe rregullat tek një autoritet i përshtatshëm jashtë entitetit klient, ose për të vlerësuar nëse ky raportim është një veprim i përshtatshëm për rrethanat.
- Ligji ose rregullat kërkojnë që firma të publikojë një raport për transparencën dhe specifikon natyrën e informacionit që duhet të përfshihet në raportin për transparencën.
- Ligji ose rregullat e letrave me vlerë kërkojnë që firma të komunikojë disa çështje tek personat e ngarkuar me qeverisjen.

A115 Në disa raste, ligji ose rregullat mund të pengojnë komunikimin e firmës me të tretet të informacionit në lidhje me sistemi e saj të menaxhimit të cilësisë.

Shembuj se kur firma mund të pengohet të komunikojë informacionin tek të tretet

- Ligji ose rregullat për privacinë ose fshehtësinë ndalon zbulimin e disa informacioneve.
- Ligji, rregullat ose kërkesat përkatëse etike, përmbajnë dispozita që trajtojnë detyrimin për konfidencialitetin

Reagimet specifike (Ref: Para. 34)

A116. Përgjigjet e specifikuar mund të adresojnë rreziqe të cilësisë, të shumëfishta, të cilat lidhen me më shumë se një objektiv të cilësisë midis komponentë të ndryshëm. Për shembull, politikat ose procedurat për ankesat dhe pretendimet, mund të adresojnë rreziqet e cilësisë që lidhen me objektivat e cilësisë në komponentin e burimeve (p.sh., angazhimi për cilësinë e personelit), të kërkesave përkatëse etike dhe qeverisjes e lidershipit. Përgjigjet/reagimet e specifikuar të vetme nuk janë të mjaftueshme për të arritur objektivat e sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Kërkesat përkatëse etike (Ref: Paragrafi 34 (a))

A117. Kërkesat përkatëse etike mund të përmbajnë dispozita që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e kërcënimeve dhe mënyrën se si ato duhet të adresohen. Për shembull, për këtë qëllim Kodi IESBA përmban një kuadër konceptual dhe për zbatimin e kuadrit konceptual, kërkohet që firma të përdorë testin e palës së trete të arsyeshme dhe të informuar.

A118. Kërkesat përkatëse etike mund të specifikojnë mënyrën se si firma duhet të përgjigjet/reagoje ndaj një shkeljeje. Për shembull, Kodi IESBA përcakton kërkesa për firmën, në rast të një shkelje të Kodit IESBA, dhe përfshin kërkesa specifike që adresojnë shkeljet e Standardeve Ndërkombëtare të Pavarësisë, ku përfshihen kërkesa për komunikimin me palët e jashtme.

A119. Në lidhje me shkeljet e kërkesave përkatëse etike, firma mund të adresojë çështjet e mëposhtme:

- Komunikimin e shkeljeve të kërkesave përkatëse etike tek personeli përkatës;
- Vlerësimin e rëndësisë së një shkelje dhe efektin i saj në pajtueshmërinë me kërkesat përkatëse etike ;
- Veprimet që duhen ndërmarrë për të adresuar në mënyrë të kënaqshme pasojat e një shkelje, përfshirë faktin që këto veprime duhet të ndërmerren sa më shpejt të jetë e mundur;
- Përcaktimin nëse një shkelje do t'u raportohet palëve të jashtme (te treta), siç janë personat e ngarkuar me qeverisjen e entitetit, me të cilën lidhet shkelja, ose një autoriteti të jashtëm mbikëqyrës; dhe
- Përcaktimin e veprimeve të duhura, që duhen kryer ndaj individëve përgjegjës për shkeljen.

Ankesat dhe pretendimet (Ref: Paragrafi 34 (c))

A120. Vendosja e politikave ose procedurave, për trajtimin e ankesave dhe pretendimeve, mund të ndihmojë firmën në parandalimin e lëshimit të raporteve të angazhimit, të papërshtatshme. Gjithashtu, mund të ndihmojë firmën për:

- Identifikimin dhe trajtimin e individëve, përfshirë lidershipin, të cilët nuk veprojnë ose sillen në një mënyrë që demonstroi angazhim/zotim ndaj cilësisë dhe mbështet angazhimin e firmës për cilësinë; ose
- Identifikimin e mangësive në sistemin e menaxhimit të cilësisë.

A121. Ankesat dhe pretendimet mund të bëhen nga personeli, ose të tjerët jashtë firmës (p.sh. klientët, audituesit e komponentëve, ose individët brenda rrjetit të firmës).

Informacionet që bëhen të njohura pas pranimit ose vazhdimit të një marrëdhënieje me klientin ose angazhimin specifik (Ref: Para. 34(d))

A122. Informacionet që bëhen të njohura pas pranimit ose vazhdimit të një marrëdhënieje me klientin ose angazhimin specifik, mund të:

- kenë ekzistuar në kohën kur firma ka vendosur për të pranuar ose vazhduar marrëdhënien me klientin ose angazhimin specifik, por nuk ka qenë në dijeni të këtyre informacioneve, ose
- lidhet me informacione të reja, që kanë dale pasi firma ka vendosur për të pranuar ose vazhduar marrëdhënien me klientin ose angazhimin specifik.

Shembuj të çështjeve të adresuara në politikat ose procedurat e firmës, në rrethanat kur informacioni bëhet i njohur pas pranimit ose vazhdimit të një marrëdhënieje me klientin ose angazhimin specifik, të cilat mund të kenë efekt në vendimin e firmës për të pranuar ose vazhduar marrëdhënien me një klient ose angazhimin specifik.

- Kryerja e konsultimeve brenda firmës ose me këshilltarin ligjor.
- Vlerësimi i faktit nëse ka ndonjë kërkesë profesionale, ligjore ose rregullatore për firmën që ajo të vazhdojë me angazhimin.
- Diskutimi me nivelin e duhur të drejtimit të klientit dhe, me personat e ngarkuar me qeverisjen, ose me palën angazhuese, për veprimin që firma mund të ndërmarrë bazuar në faktet dhe rrethanat përkatëse.
- Kur tërheqja nga angazhimi vlerësohet një veprim i përshtatshëm:
 - Informimi i drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen e klientit ose i palës angazhuese për vendimin dhe arsyet e tërheqjes.
 - Shikohet nëse firma ka ndonjë kërkesë profesionale, ligjore ose rregullatore për të raportuar tek autoritetet rregullatore për tërheqjen e saj nga angazhimi, ose nga të dyja edhe angazhimi edhe marrëdhënia me klientin, si dhe për arsyet e tërheqjes,

A123. Në disa rrethana, ligji juridiksional ose rregulli, mund t'i imponojnë firmës një detyrim për të pranuar ose vazhduar angazhimin me një klient, ose në rastin e sektorit publik, firma mund të jete emëruar përmes dispozitave statusore.

Shembull i çështjeve të adresuara në politikat ose procedurat e firmës, në rrethanat kur firma është e detyruar të pranojë ose të vazhdojë një angazhim ose nuk është në gjendje të tërhiqet nga një angazhim, dhe firma është në dijeni të informacionit që do të kishte shkaktuar tërheqjen e saj ose ndërprerjen e angazhimit

- Firma merr parasysh efektin e informacionit në kryerjen e angazhimit.

- Firma komunikon informacionin tek partneri i angazhimit dhe i kërkon atij të rrite shtrirjen dhe frekuencën e drejtimit dhe mbikëqyrjes të anëtarëve të grupit të angazhimit dhe rishikimit të punës së tyre.
- Firma cakton në angazhim personelin me shume eksperience
- Firma vlerëson se duhet të bëhet një rishikim i cilësisë së angazhimit.

Komunikimi me palët e jashtme (Ref. Paragrafi: 34 (e))

A124. Aftësia e firmës për të ruajtur besimin e palëve të interesuara në cilësinë e angazhimeve, mund të përmirësohet përmes komunikimit të përshtatshëm, të besueshëm dhe transparent, për aktivitetet që ajo ka ndërmarrë, për të adresuar cilësinë dhe efektivitetin e këtyre aktiviteteve.

A125. Palët e jashtme që mund të përdorin informacion në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë të firmës, dhe shtrirja e interesit të tyre, në sistemin e menaxhimit të cilësisë së firmës, mund të ndryshojë bazuar në natyrën dhe rrethanat e firmës dhe angazhimeve të saj.

Shembuj të palëve të jashtme që mund të përdorin informacionin për sistemin e menaxhimit të cilësisë së firmës

- Drejtimi dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e klientëve të firmës, mund të përdorin informacionin për të përcaktuar nëse do të emërojnë firmën për të kryer një angazhim.
- Autoritetet e jashtme të mbikëqyrjes mund të tregojnë dëshirën për informacionin, për të mbështetur përgjegjësitë e tyre në monitorimin e cilësisë së angazhimeve në të gjithë juridiksionin dhe për të kuptuar punën e firmave.
- Firmat e tjera, që përdorin punën e firmës në kryerjen e angazhimeve (p.sh., në lidhje me auditimin e një grupi) mund të kenë kërkuar informacione të tilla.
- Përdorues të tjerë, të raporteve të angazhimit të firmës, siç janë investitorët që përdorin raportet e angazhimit për vendimmarrjet e tyre, mund të kenë treguar dëshirën për këto informacione.

A126. Informacioni në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë, që ju është dhënë palëve të jashtme, përfshirë informacion e komunikuar për personat e ngarkuar me qeverisjen ,rreth mënyrës se si sistemi i menaxhimit të cilësisë mbështet kryerjen në vazhdimësi të angazhimeve cilësore, mund të adresojë çështjet e mëposhtme:

- Natyrën dhe rrethanat e firmës, të tilla si struktura organizative, modeli i biznesit, strategjia dhe mjedisi i funksionimit.
- Qeverisjen dhe lidhshërinë e firmës, siç është kultura e saj, mënyra se si firma demonstroi një angazhim për cilësinë, dhe rolet, përgjegjësitë e autoritetin e caktuar në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- Si i përmbush firmat përgjegjësitë e saj, në përputhje me kërkesat përkatëse etike, përfshirë ato që lidhen me pavarësinë.

- Faktorët që kontribuojnë në angazhimet cilësore, për shembull, një informacion i tillë mund të jetë paraqitur në formën e treguesve të cilësisë së angazhimit, ku treguesit shpjegohen në mënyrë përshkruese.
- Rezultatet e aktiviteteve të monitorimit të firmës dhe i inspektimeve të jashtme, dhe i mënyrës se si ka firma i ka korrigjuar mangësitë e identifikuara ose përndryshe, ka reaguar ndaj tyre.
- Vlerësimi i kryer në përputhje me paragrafët 53–54, për faktin nëse sistemi i menaxhimit të cilësisë i jep firmës një siguri të arsyeshme se janë arritur objektivat e sistemit dhe përfundimet përkatëse, përfshirë bazën për gjykimet bëra në kryerjen e vlerësimit dhe nxjerrjen e konkluzioneve.
- Mënyrës se si firma ka reaguar/është përgjigjur ndaj zhvillimeve dhe ndryshimeve në rrethanat e firmës ose angazhimet e saj, përfshirë mënyrën se si është përshtatur sistemi i menaxhimit të cilësisë për t'iu përgjigjur këtyre ndryshimeve.
- Marrëdhënia midis firmës dhe rrjetit, struktura e përgjithshme e rrjetit, një përshkrim i kërkesave të rrjetit dhe shërbimeve të rrjetit, përgjegjësitë e firmës dhe të rrjetit (duke përfshirë faktin që firma është përfundimisht përgjegjëse për sistemin e saj menaxhimit të cilësisë), dhe informacion në lidhje me objektin e përgjithshëm dhe rezultatet e aktiviteteve të monitorimit të rrjetit në firmat e rrjetit.

Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen (Ref. Para: 34 (e) (i))

A127. Mënyra e komunikimit me personat e ngarkuar me qeverisjen (d.m.th., nga firma ose grupi i angazhimit) mund të varet nga politikat ose procedurat e firmës dhe rrethanat e angazhimit.

A128. SNA 260 (i rishikuar) trajton përgjegjësitë e audituesit në një auditim të pasqyrave financiare për të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen dhe adreson përcaktimin prej audituesit të personit (personave) të përshtatshëm, brenda strukturës qeverisëse të entitetit, me të cilin do të komunikojë¹⁸ dhe procesin e komunikimit¹⁹. Në disa rrethana, mund të jetë e nevojshme të komunikohet me persona të ngarkuar me qeverisjen nga entitete të tjera, të cilat nuk janë entitete të listuara (ose kur kryhen angazhime të tjera), për shembull, entitetet që mund të kenë interes publik ose tipare të përgjegjësisë publike, të tilla si:

- Entitetet që mbajnë një sasi të konsiderueshme aktivesh, në cilësinë e një të besuari për një numër të madh palesh të interesuara, duke përfshirë institucionet financiare, të tilla si disa banka, kompani sigurimesh, dhe fonde të pensione.
- Entitetet që kanë një profil të lartë publik, ose drejtuesit apo pronarët e të cilëve, kanë një profil të lartë publik.
- Entitetet me një numër të madh dhe gamë të gjerë të palëve të interesit.

Konsiderata për sektorin publik

¹⁸ SNA 260 (i rishikuar), Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen, paragrafët 11-13

¹⁹ SNA 260 (i rishikuar), paragrafët 18-22

A129. Firma mund të gjykoje si të përshtatshme për të komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen e një entiteti të sektorit publik, për mënyrën sesi sistemi i menaxhimit të cilësisë të firmës mbështet kryerjen në vazhdimësi të angazhimeve cilësore, duke mbajtur parasysh madhësinë dhe kompleksitetin e entitetit të sektorit publik, gamen e palëve të interesit, natyrën e shërbimeve që entiteti jep dhe rolin e përgjegjësitë e personave të ngarkuar me qeverisjen.

Përcaktimi kur është e përshtatshme të komunikohet me palët e jashtme (Ref. Para: 34 (e) (ii))

A130. Përcaktimi se kur firma duhet të komunikojë me palët e jashtme, rreth sistemit të saj menaxhimit të cilësisë, është një çështje e gjykimit profesional dhe mund të ndikohet nga:

- Llojet e angazhimeve të kryera nga firma dhe llojet e entiteteve për të cilat kryhen këto angazhime.
- Natyra dhe rrethanat e firmës.
- Natyra e mjedisit të funksionimit të firmës, siç është praktika e zakonshme e biznesit në juridiksionin e firmës, dhe karakteristikat e tregjeve financiare në të cilat firma operon.
- Shkalla në të cilën firma ka komunikuar me palët e jashtme në përputhje me ligjin ose rregullat (d.m.th., nëse nevojitet komunikim i mëtejshëm, dhe nëse po, çështjet për të cilat do të komunikohet).
- Pritshmëritë e palëve të interesuara në juridiksionin e firmës, përfshirë mirëkuptimin dhe interesin që palët e jashtme kanë shprehur në lidhje me angazhimet e ndërmarra nga firma, dhe proceset e firmës në kryerjen e angazhimeve.
- Tendencat në juridiksionin përkatës.
- Informacioni në dispozicion të palëve të jashtme.
- Mënyra se si palët e jashtme mund ta përdorin informacionin dhe kuptimi i tyre i përgjithshëm për çështjet që lidhen me sistemin e menaxhimit të cilësisë të firmës dhe auditimet ose rishikimet e pasqyrave financiare, ose angazhime të tjera të sigurisë apo shërbimeve të lidhura.
- Përfitimet me interes publik nga komunikimi i jashtëm dhe nëse ai në mënyrë të arsyeshme pritët të tejkalojë kostot (monetare ose të tjera) e komunikimit.

Çështjet e mësipërme mund të ndikojnë gjithashtu, në informacionin e dhënë nga firma në komunikim, dhe natyrën, afatet dhe shtrirjen dhe forma e përshtatshme të komunikimit.

Natyra, afatet, shtrirja dhe forma përshtatshme e komunikimit me palët e jashtme (Ref. Para: 34 (e) (iii))

A131. Në përgatitjen e informacionit që i komunikohet palëve të jashtme, firma mund të marrë parasysh cilësitë e mëposhtme:

- Informacioni të jetë specifik për rrethanat e firmës. Lidhja e çështjeve që firma komunikon direkt, me rrethanat specifike të firmës, ndihmon të minimizohet mundësia që informacioni të bëhet tepër i standardizuar dhe më pak i dobishëm me kalimin e kohës.

- Informacioni paraqitet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, dhe mënyra e paraqitjes nuk është as çorientuese dhe as nuk do të influenconte, në mënyrë të papërshtatshme, në përdoruesit e komunikimit (p.sh., informacioni është paraqitur në një mënyrë që balancon në mënyrë të përshtatshme aspektet pozitive dhe negative të çështjes që komunikohet).
- Informacioni është i saktë dhe i plotë në të gjitha aspektet materiale dhe nuk përmban të dhëna që çorientojnë.
- Informacioni merr parasysh nevojat për informacion të përdoruesve, për të cilët ai është parashikuar. Për vlerësimin e nevojave të përdoruesve për informacione, firma mund të marrë parasysh çështje të tilla si, niveli i detajimit që do të kishte kuptim për përdoruesit, dhe faktin nëse përdoruesit kanë akses në informacionet përkatëse, përmes burimeve të tjera (p.sh., nga faqja e internetit e firmës).

A132. Kur kryen një auditim të pasqyrave financiare të entiteteve të listuara, firma do të përdorë gjykimin profesional, për të përcaktuar për rrethanat, formën e përshtatshme të komunikimit me palën e jashtme, përfshirë komunikimin me personat e ngarkuar me qeverisjen, që mund të bëhet me gojë ose me shkrim. Për rrjedhojë, forma e komunikimit mund të ndryshojë.

Shembuj të formës së komunikimit me palët e jashtme

- Një publikim, siç është për shembull, raporti i transparencës ose raporti i cilësisë së auditimit.
- Komunikimi me shkrim, me objektiv disa palë të veçanta të interesit (p.sh., informacion në lidhje me rezultatet e procesit të monitorimit dhe korrigjimit të mangësive të firmës).
- Bisedat dhe ndërveprimet e drejtpërdrejta me palën e jashtme (p.sh., diskutimet midis grupit të angazhimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen).
- Një faqe në internet.
- Forma të tjera të mediave digjitale, të tilla si mediat sociale, ose intervista apo prezantime nëpërmjet transmetim në internet ose me video.

Angazhimet që i nënshtrohen një rishikimi të cilësisë së angazhimit

Rishikimi i cilësisë së angazhimit i kërkuar nga ligji ose rregullat (Ref: Paragrafi 34 (f) (ii))

A133. Ligji ose rregullat mund të kërkojnë kryerjen e një rishikimi të cilësisë së angazhimit, për shembull, për angazhimet e auditimit të entiteteve që:

- Janë entitete me interes publik, sikurse ky term përkufizohet në një juridiksion të veçantë;
- Operojnë në sektorin publik, ose janë përfitues të financimit qeveritar, apo entitete me përgjegjshmëri publike;
- Operojnë në disa sektorë të ekonomisë (p.sh., institucione financiare, të tilla si bankat, kompanitë e sigurimeve dhe fondet e pensioneve);
- Plotësojnë një kufi të specifikuar të totalit të aktivitetit; ose
- Janë nën administrimin e një gjykate, ose në një proces gjyqësor (p.sh., në likuidim).

Rishikimi i cilësisë së angazhimit si përgjigje/reagim për adresimin e një ose më shumë rreziqeve të cilësisë (Ref: Paragrafi 34 (f) (iii))

A134. Njohja dhe kuptimi prej firmës i kushteve, ngjarjeve, rrethanave, veprimeve ose mosveprimeve që mund të ndodhin, të cilat mund të ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të cilësisë, siç kërkohet nga paragrafi 25 (a) (ii), lidhet me natyrën dhe rrethanat e angazhimeve të kryera nga firma. Gjatë hartimit dhe zbatimit të përgjigjeve/reagimeve, për të adresuar një ose më shumë rreziqe të cilësisë, firma mund të përcaktojë një rishikim të cilësisë së angazhimit, si një përgjigje të përshtatshme bazuar në arsyet për vlerësimet e dhëna për rreziqet e cilësisë.

Shembuj të kushteve, ngjarjeve, rrethanave, veprimeve ose mosveprimeve që shkaktajnë një ose më shumë rreziqe të cilësisë, për të cilat një rishikim i cilësisë së angazhimit, mund të jetë një përgjigje/reagim i përshtatshëm

Ato që lidhen me llojet e angazhimeve të kryera nga firma dhe raportet që do të lëshohen:

- Angazhimet që përfshijnë një nivel të lartë kompleksiteti ose gjykimi, siç janë:
 - Auditimet e pasqyrave financiare të entiteteve që operojnë në një sektor të ekonomisë ku zakonisht ka çmuarje kontabël me një shkallë të lartë të pasigurisë së çmuarjes (p.sh., disa institucione financiare të mëdha ose entitetet minerare), ose për entitetet për të cilat ka pasiguri lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime të mëdha për aftësinë e tyre për të vazhduar aktivitetin në vijimësi.
 - Angazhimet e sigurisë që kërkojnë aftësi dhe njohuri të specializuara në matjen ose vlerësimin e çështjes në fjale kundrejt kriterëve të zbatueshme (p.sh., një pasqyre e emetimit të gazrave serë kur ka pasiguri të mëdha të lidhura me sasitë e raportuara).
- Angazhimet, në të cilat janë hasur çështje, siç janë angazhimet e auditimit me gjetje të përsëritura të inspektimit të brendshëm ose të jashtëm, mangësi të rëndësishme të pakorrigjuara të rëndësishme në kontrollin e brendshëm, ose një anomali materiale në informacionin krahasues në pasqyrat financiare.
- Angazhimet, për të cilat janë identifikuar rrethana të pazakonta gjatë procesit të pranimit dhe vazhdimet (p.sh., një klient i ri që kishte një mosmarrëveshje me audituesin e mëparshëm ose profesionistin kontabël të dhënies së sigurisë).
- Angazhimet që përfshijnë raportimin e informacionit financiar ose jo-financiar, i cili pritët të përfshihet në një dosje të rregullatorit, dhe që mund të përfshijë një shkallë më të lartë gjykimi, siç është një informacion financiar pro forma, i cili do të përfshihet në një prospekt.

Ato që lidhen me llojet e entiteteve për të cilat ndërmerren angazhimet:

- Entitetet në sektorët në zhvillim, ose për të cilat firma nuk ka përvojë të mëparshme.
- Entitetet për të cilat ka shqetësime nga komunikimet me bursën e letrave me vlerë ose me rregullatorët e mbikëqyrje së kujdesshme
- Entitetet e pa listuara të cilat mund të kenë interes publik ose karakteristika të përgjegjësisë publike, për shembull:

- Entitetet që mbajnë një sasi të madhe aktivesh në kapacitetin e administratoreve të besuar, për një numër të madh të palëve të interesuara, përfshirë institucionet financiare, siç janë disa banka, shoqëritë e sigurimeve, dhe fondet e pensioneve, për të cilat me ligj ose me rregulla, nuk kërkohet një rishikim i cilësisë së angazhimit.
- Entitetet me profil të lartë publik, ose ato ku drejtuesit ose pronarët e tyre kanë një profil publik të lartë
- Entitetet me një numër të madh dhe gamë të gjerë të palëve të interesuara.

A135. Reagimet e firmës, për të adresuar rreziqet e cilësisë, mund të përfshijnë forma të tjera të rishikimeve të angazhimit që ndryshojnë nga një rishikim i cilësisë së angazhimit. Për shembull, për auditimet e pasqyrave financiare, reagimet e firmës mund të përfshijnë rishikime të procedurave të grupit të angazhimit në lidhje me rreziqe të konsiderueshme ose rishikimet e disa gjykimeve të rëndësishme, nga personeli që ka ekspertizë teknike të specializuar. Në disa raste, këto lloje të tjera të rishikimeve të angazhimit, mund të kryhen pavarësisht një rishikimi i cilësisë së angazhimit.

A136. Në disa raste firma mund të mos ketë auditime ose angazhime të tjera, për të cilat një rishikim i cilësisë së angazhimit ose një formë tjetër e rishikimit të angazhimit do të konsiderohej si një reagim/përgjigje e përshtatshme për të adresuar rrezikun (at) e cilësisë.

Konsideratat për sektorin publik

A137. Natyra dhe rrethanat e entiteteve të sektorit publik (p.sh., për shkak të madhësisë dhe kompleksitetit të tyre, gamës së palëve të tyre të interesit, ose natyrës dhe shërbimeve që ato ofrojnë) mund të çojnë në rreziqe cilësore. Në këto kushte, firma mund të vlerësojë se kryerja e një rishikimi të cilësisë së angazhimit është përgjigje e përshtatshme për të adresuar rreziqet e cilësisë. Ligji ose rregullat mund të vendosin, për audituesit e entiteteve të sektorit publik, kërkesa raportimi shtese (p.sh., një raport i veçantë mbi rastet e papajtueshmërisë me ligjin ose rregullat për legjislatorin (kuvendin) apo për një organ tjetër qeverisës, ose edhe për komunikimin e këtyre rasteve në raportin e audituesit mbi pasqyrat financiare). Në këto raste, kur përcakton nëse një rishikim i cilësisë së angazhimit do të ishte një përgjigje e përshtatshme, firma mund të marrë në konsideratë edhe kompleksitetin e raportimit dhe rëndësinë e tij për përdoruesit.

Monitorimit dhe procesi i korrigjimit të mangësive (Ref: Para. 35–47)

A138. Përveç mundësit të vlerësimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë, monitorimi dhe procesi i korrigjimit të mangësive ndihmon në përmirësimin proaktiv dhe të vazhdueshëm të cilësisë së angazhimit dhe të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Për shembull:

- Nisur nga kufizimet e vetvetishme të një sistemi të menaxhimit të cilësisë, identifikimet nga firma, të mangësive nuk janë të pazakonta, ato janë një aspekt i rëndësishëm i sistemit të menaxhimit të cilësisë, sepse identifikimi i shpejtë i mangësive, i jep mundësi firmës t'i

korrigjojë ato në kohën e duhur dhe në mënyrë efektive, dhe kontribuon në një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm.

- Aktivitetet e monitorimit mund të japin informacione, të cilat bëjnë të mundur që firma të parandalojë një mangësi përmes reagimit ndaj një gjetje, e cila gjatë një periudhe kohe mund të çojë në një mangësi.

Hartimi dhe kryerja e aktiviteteve të monitorimit (Ref: Para. 37–38)

A139. Aktivitetet e monitorimit të firmës mund të përfshijnë një kombinim të aktiviteteve të vazhdueshme me ato periodike. Aktivitetet e vazhdueshme të monitorimit përgjithësisht janë aktivitete rutinë, të trupëzuara në proceset e firmës dhe të kryera në kohë reale, duke reaguar ndaj ndryshimit të kushteve. Aktivitetet periodike të monitorimit kryhen nga firma në intervale kohe. Në shumicën e rasteve, aktivitetet e monitorimi të vazhdueshëm japin informacion në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë në një kohë më afër reale.

A140. Aktivitetet e monitorimit mund të përfshijnë inspektimin e angazhimeve në proces. Inspektimet e angazhimeve kanë për qëllim të monitorojnë një aspekt të sistemit të menaxhimit të cilësisë, nëse ai është hartuar, zbatohet dhe operon në mënyrën e parashikuar. Në disa rrethana, sistemi i menaxhimit të cilësisë mund të përfshijë reagime që synojnë të rishikojnë angazhimet, ndërkohë që ato kryhen, të cilat ngjasojnë në natyrë me një inspektim të angazhimeve në proces (p.sh., rishikimet e hartuara për të zbuluar dështimet ose mangësitë në sistemin e menaxhimit të cilësisë, në mënyrë që të parandalojnë ndodhjen e një rreziku të cilësisë). Qëllimi i aktivitetit është të udhëheqë hartimin dhe zbatimin e tij, dhe përshtatjen brenda sistemit të menaxhimit të cilësisë (d.m.th., nëse është një inspektim i një angazhimi në proces që është një aktivitet monitorimi ose një rishikim i një angazhimi që është një përgjigje për të adresuar një rrezik të cilësisë).

A141. Natyra, afatet dhe shtrirja e aktiviteteve të monitorimit mund të ndikohen gjithashtu, nga çështje të tjera, ku përfshihen:

- Madhësia, struktura dhe organizimi i firmës.
- Përfshirja e rrjetit të firmës në aktivitetet e monitorimit.
- Burimet që firma synon të përdorë për të mundësuar monitorimin e aktiviteteve, siç është përdorimi i aplikacioneve të TI-se.

A142. Kur kryen aktivitete monitorimi, firma mund të përcaktojë si të nevojshme, të beje ndryshime në natyrën, afatet dhe shtrirjen e aktiviteteve monitoruese, si për shembull, në rastet kur gjetjet tregojnë se ka nevojë për më shumë aktivitete monitorimi.

Hartimi i procesit të vlerësimit të rrezikut të firmës, procesi i monitorimit dhe korrigjimit të mangësive (Ref: Para.37 (c))

A143. Mënyra se si është hartuar procesi i vlerësimit të rrezikut të firmës (p.sh., një proces i centralizuar ose i decentralizuar, apo frekuenca e rishikimit) mund të ndikojë në natyrën, kohën dhe shtrirjen e aktiviteteve të monitorimit, përfshirë aktivitetet e monitorimit mbi procesin e vlerësimit të rrezikut të firmës.

A144. Mënyra si është hartuar procesi i monitorimit dhe korrigjimit të mangësive të firmës (d.m.th., natyra, afatet dhe shtrirja e aktiviteteve të monitorimit dhe korrigjimit të mangësive, duke marrë parasysh natyrën dhe rrethanat e firmës) mund të ndikojë në aktivitetet e monitorimit të kryera nga firma për të përcaktuar nëse monitorimi dhe procesi i korrigjimit të mangësive arrin qëllimin e parashikuar siç përshkruhet në paragrafin 35.

Shembull i shkallëzueshmërisë për të demonstruar aktivitetet e monitorimit për monitorimin dhe procesin e korrigjimit të mangësive

- Në një firmë më pak komplekse, aktivitetet e monitorimit mund të jenë të thjeshta, pasi informacioni në lidhje me procesin e monitorimit dhe korrigjimit të mangësive mund të jetë i disponoheshim në formën njohurive të lidershit, bazuar në ndërveprimin e tyre të shpeshtë me sistemin e menaxhimit të cilësisë, për natyrën, afatet dhe shtrirjen e aktiviteteve të monitorimit të ndërmarra, rezultatet e aktiviteteve monitorimit, dhe veprimet e firmës për të adresuar rezultatet.
- Në një firmë më shumë komplekse, aktivitetet e monitorimit për procesin e monitorimit dhe të korrigjimit të mangësive mund të jenë hartuar posaçërisht për të përcaktuar që procesi i monitorimit dhe korrigjimit të mangësive, siguron informacionet përkatëse, të besueshme dhe në kohën e duhur, në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë, dhe i përgjigjet në mënyrën e duhur mangësive të identifikuara.

Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të cilësisë (Ref: Paragrafi 37 (d))

A145. Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të cilësisë mund të përfshijnë:

- Ndryshimet për të adresuar një mangësi të identifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- Ndryshimet në objektivat e cilësisë, rreziqet e cilësisë ose reagimet/përgjigjet, si rezultat i ndryshimeve në natyrën dhe rrethanat e firmës dhe angazhimet e saj.

Kur ndodhin ndryshime, aktivitetet e mëparshme të monitorimit, të kryera nga firma, mund të mos i japim më firmës informacion për të mbështetur vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe, prandaj, aktivitetet e monitorimit të firmës, mund të përfshijnë monitorimin e atyre fushave ku kanë ndodhur ndryshime.

Aktivitetet e mëparshme të monitorimit (Ref: Paragrafi 37 (e))

A146. Rezultatet e aktiviteteve të monitorimit, të mëparshme të firmës, mund të tregojnë fushat e sistemit ku mund të lindin mangësi, veçanërisht zonat ku ka histori të mangësive të identifikuar.

A147. Veprimtaritë e monitorimit, të mëparshme të kryera nga firma, mund të mos i japin më firmës informacion për të mbështetur vlerësimin e sistemit, përfshirë fushat e sistemit të menaxhimit të cilësisë, të cilat nuk kanë ndryshuar, veçanërisht kur ka kaluar kohe e gjate nga koha kur u kryen aktivitetet e monitorimit.

Informacione të tjera të përshtatshme (Ref: Paragrafi 37 (f))

A148. Përveç burimeve të informacionit, të treguara në paragrafin 37 (f), informacione të tjera të përshtatshme mund të jone:

- Informacionet e komunikuara nga rrjeti i firmës, në përputhje me paragrafët 50 (c) dhe 51 (b), në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë të firmës, përfshirë kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit, që firma ka përfshirë në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë.
- Informacionet e komunikuara nga një ofrues shërbimi, për burimet që firma përdor në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë.
- Informacionet nga rregullatorët, për entitetet për të cilat firma kryen angazhime, të cilat vihen në dispozicion të firmës, siç janë informacionet nga një rregullator i letrave me vlerë për një entitet, për të cilin firma kryen angazhime (p.sh. parregullsi në pasqyrat financiare të entitetit).

A149. Rezultatet e inspektimeve të jashtme ose informacione të tjera përkatëse, të brendshme dhe të jashtme, mund të tregojnë se aktivitetet e mëparshme të monitorimit të kryera nga firma nuk kanë arritur të identifikojnë një mangësi në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Ky informacion mund të ndikojë në vlerësimin e firmës për natyrën, afatet dhe shtrirjen e aktiviteteve të monitorimit.

A150. Inspektimet e jashtme nuk zëvendësojnë aktivitetet e monitorimit të brendshëm të firmës. Sidoqoftë, rezultatet e inspektimeve të jashtme informojnë natyrën, afatet dhe shtrirjen e aktiviteteve të monitorimit.

Inspektimet e angazhimit (Ref: Para. 38)

A151. *Shembuj të çështjeve në paragrafin 37, që mund të merren parasysh nga firma në përzgjedhjen për inspektim të angazhimeve të përfunduara*

- Në lidhje me kushtet, ngjarjet, rrethanat, veprimet ose mosveprimet që shkaktojnë rreziqe të cilësisë:
 - Llojet e angazhimeve të kryera nga firma dhe eksperiencia e firmës për kryerjen e llojit përkatës të angazhimit.
 - Llojet e entiteteve për të cilat ndërmerren angazhime, për shembull:

- Entitetet e listuara.
- Entitetet që operojnë në sektorët e rinj.
- Entitetet që operojnë në sektorët me nivel të larte kompleksiteti ose gjykimi.
- Entitetet që operojnë në një sektor të ri për firmën.
- Qëndrimi në detyre dhe përvoja e partnerëve të angazhimit.
- Rezultatet e inspektimeve të mëparshme të angazhimeve të përfunduara, përfshirë për secilin partner të angazhimit.
- Në lidhje me informacionet e tjera përkatëse:
 - Ankesat ose pretendimet për një partner angazhimi.
 - Rezultatet e inspektimeve të jashtme, përfshirë për secilin partner angazhimi.
 - Rezultatet e vlerësimit të firmës në lidhje me angazhimin për cilësinë të cdo partneri të angazhimit

A152. Firma mund të kryejë aktivitete monitorimi të shumëfishta, që janë të ndryshme nga inspektimi i angazhimeve të përfunduara, të cilat fokusohen në përcaktimin nëse angazhimet kanë qenë në përputhje me politikat ose procedurat. Këto aktivitete monitorimi mund të ndërmerren në disa angazhime ose partnerë angazhimi. Natyra dhe shtrirja e këtyre aktiviteteve të monitorimit dhe rezultatet e tyre mund të përdoren nga firma për të përcaktuar se:

- Cilat angazhime të përfunduara duhet të zgjidhen për inspektim;
- Cilët partnerë të angazhimit do të përzgjedhin për inspektim;
- Sa shpesh duhet të zgjidhet një partner angazhimi për inspektim; ose
- Cilat aspekte të angazhimit do të merren parasysh gjatë kryerjes së inspektimit të angazhimeve të përfunduara.

A153. Inspektimi i angazhimeve të përfunduara për partnerët e angazhimit mbi baza ciklike, mund të ndihmojë firmën në monitorimin nëse partnerët e angazhimit kanë përmbushur përgjegjësinë e tyre të përgjithshme për menaxhimin dhe arritjen e cilësisë në angazhimet që u janë caktuar.

Shembull se si një firmë mund të aplikojë një bazë ciklike për inspektimin e angazhimeve të përfunduara për çdo partner angazhimi

Firma mund të vendosë politika ose procedura që adresojnë inspektimin e angazhimeve të përfunduara, të cilat:

- Përcaktojnë një periudhë standarde të ciklit të inspektimit, siç është inspektimi i një angazhimi të përfunduar për çdo partner të angazhimit që kryen auditime të pasqyrave financiare, një herë në çdo tre vjet, dhe për të gjithë partnerët e tjerë të angazhimit, një herë në çdo pesë vjet;

- Përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen e angazhimeve të përfunduara, përfshirë ato për një partner angazhimi që kryen auditime të pasqyrave financiare, angazhimet e përzgjedhura do të përfshijnë një angazhim auditimi.
- Adresojnë përzgjedhjen e partnerëve të angazhimit në një mënyrë të paparashikueshme; dhe
- Adresojnë, kur është e nevojshme ose e përshtatshme, përzgjedhjen e partnerëve të angazhimit për një periudhë me të gjatë ose me të shkurtër sesa periudha standarde e përcaktuar në politikën e firmës, për shembull:
 - Firma mund të zgjedhë partnerët e angazhimit më shpesh sesa periudha standarde e përcaktuar në politikën e firmës kur:
 - Nga firma janë identifikuar mangësi të shumëfishta, të cilat janë vlerësuar serioze, dhe firma përcakton se nevojitet një inspektim ciklik më i shpeshtë për të gjithë partnerët e angazhimit.
 - Partneri i angazhimit kryen angazhime për entitetet që operojnë në një sektor ekonomik të caktuar në të cilin ka nivele të larta kompleksiteti ose gjykimi.
 - Një angazhim i kryer nga partneri i angazhimit i është nënshtruar aktiviteteve të tjera të monitorimit, dhe rezultatet e tyre kanë qenë të pakënaqshme.
 - Partneri i angazhimit ka kryer një angazhim për një entitet që vepron në një sektor në të cilën partneri i angazhimit ka përvojë të kufizuar.
 - Partneri i angazhimit është një partner i sapoemëruar i angazhimit, ose kohët e fundit është bërë pjesë e firmës, nga një firmë tjetër ose një juridiksion tjetër.
 - Firma mund të shtyjë në kohë përzgjedhjen e partnerit të angazhimit (p.sh., shtyrjen për një vit përtej periudhës standarde, të përcaktuar në politikën e firmës) kur:
 - Angazhimet e kryera nga partneri i angazhimit kanë qenë subjekt i aktiviteteve të tjera të monitorimit gjatë periudhës standarde të përcaktuar në politikën e firmës; dhe
 - Rezultatet e aktiviteteve të tjera të monitorimit, japin informacion të mjaftueshëm për partnerin e angazhimit (d.m.th. kryerja e inspektimit të angazhimit të përfunduar nuk ka gjasa t'i japë firmës informacion të mëtijshëm në lidhje me partnerin e angazhimit)

A154. Çështjet që konsiderohen në një inspektim të një angazhimi, varen nga mënyra se si do të përdoret inspektimi për të monitoruar sistemin e menaxhimit të cilësisë. Zakonisht, inspektimi i një angazhimi përfshin përcaktimin që reagimet/përgjigjet në nivel angazhimi (p.sh., politikat dhe procedurat e firmës në lidhje me performancën e angazhimit), janë zbatuar ashtu siç janë hartuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive.

Individët që kryejnë aktivitete të monitorimit (Ref: Paragrafi 39 (b))

A155. Dispozitat e kërkesave përkatëse etike janë të rëndësishme në hartimin e politikave ose procedurave që adresojnë objektivitetin e individëve, të cilët kryejnë aktivitetet e monitorimit. Një kërcënim i vete rishikimit mund të lindë kur një individ, i cili kryen:

- Një inspektim i një angazhimi ishte:
 - Në rastin e një auditimi të pasqyrave financiare, një anëtar i ekipit të angazhimit ose rishikues i cilësisë së angazhimit të atij angazhimi, ose një angazhimi për një periudhë financiare të mëpasshme; ose
 - Për të gjitha angazhimet e tjera, një anëtar i grupit të angazhimit ose një rishikues i cilësisë së angazhimit të atij angazhimi
- Një lloj tjetër të aktivitetit monitorues ka marrë pjesë në hartimin, kryerjen ose operimin e përgjigjes së monitoruar.

A156. Në disa rrethana, për shembull, një firmë më pak komplekse, mund të mos ketë personelin me kompetencën, aftësitë, kohën ose objektivitetin për të kryer aktivitetet e monitorimit. Në këto rrethana, për aktivitetet e monitorimit, firma mund të përdorë shërbimet e rrjetit ose të një ofruesi të shërbimit

Vlerësimi i gjetjeve dhe identifikimi i mangësive (Ref: Paragrafi 16 (a), 40–41)

A157. Firma akumulon gjetjet nga kryerja e aktiviteteve të monitorimit, nga inspektimet e jashtme dhe nga burime të tjera të përshtatshme.

A158. Informacioni që firma ka akumuluar nga aktivitetet e monitorimit, inspektimet e jashtme dhe nga burime të tjera të përshtatshme, mund të zbulojë fakte të tjera në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë të firmës, siç janë:

- Veprimet, sjelljet ose kushtet, që kanë çuar në rezultate pozitive në kontekstin e cilësisë ose efektivitetin e sistemit të menaxhimit të cilësisë; ose
- Rrethanat e ngjashme, ku nuk janë konstatuar gjetje (p.sh., angazhimet ku nuk janë vrenjtur gjetje, të cilat kanë natyrë të ngjashme me angazhimet ku janë vërejtur gjetje).

Për firmën mund të jenë të dobishme edhe fakte të tjera të vërejtura, pasi ato mund të ndihmojnë në investigimin rrënjësor të shkaqeve të mangësive të identifikuara, të tregojnë për praktikën që mund të mbështeten ose zbatohen gjerësisht nga firma (p.sh., në të gjitha angazhimet) ose nxjerrin në pah mundësitë që ka firma për të përmirësuar sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë.

A159. Për të përcaktuar nëse gjetjet, individualisht ose të kombinuara me gjetjet e tjera, çojnë në një mangësi në sistemin e menaxhimit të cilësisë, firma përdor gjykimin profesional. Për të bere gjykimin, firma mund të mbaje parasysh rëndësinë relative të gjetjeve në kontekstin e objektivave të cilësisë, rreziqeve të cilësisë, përgjigjeve/reagimeve ose aspekteve të tjera të sistemit të menaxhimit të cilësisë, me të cilat ato lidhen. Gjykimet e firmës mund të ndikohen nga faktorët sasiore dhe cilësorë, të cilët lidhen me gjetjet. Në disa rrethana, firma mund ta gjykojë të përshtatshme marrjen e më shumë informacioneve në lidhje me gjetjet, në mënyrë që të

përcaktohet nëse ekziston një mangësi. Jo të gjitha gjetjet, përfshirë gjetjet e angazhimit, do të jenë një mangësi

A160 *Shembuj të faktorëve sasiorë dhe cilësorë që një firmë mund të marrë parasysh kur përcakton nëse gjetjet çojnë në një mangësi*

Rreziqet dhe përgjigjet/reagimet për cilësinë

- Nëse gjetjet lidhen me një përgjigje/reagim:
 - Si është hartuar përgjigja, për shembull, natyra e përgjigjes, frekuenca e përdorimit të saj (nëse është e zbatueshme), dhe rëndësia relative e përgjigjes për adresimin e rreziqeve të cilësisë dhe arritjen e objektivave të cilësisë me të cilat lidhen.
 - Natyra e rrezikut të cilësisë me të cilën lidhet përgjigja dhe shkalla në të cilën gjetjet tregojnë se rreziku i cilësisë nuk ka qenë adresuar.
 - Fakti nëse ka përgjigje/reagime të tjera që adresojnë të njëjtin rrezik të cilësisë dhe nëse ka gjetje për ato përgjigje.

Natyra e gjetjeve dhe përhapja e tyre

- Natyra e gjetjeve. Për shembull, gjetjet që lidhen me veprimet dhe sjelljet e lidërshiptit mund të jenë cilësish të rëndësishme, duke pasur parasysh efektin e përhapur, që mund të ketë në sistemin e menaxhimit të cilësisë në tërësi.
- Faktin nëse gjetjet, në kombinim me gjetjet e tjera, tregojnë për një tendencë ose çështje sistemike. Për shembull, gjetjet e ngjashme të angazhimit, të cilat shfaqen në angazhime të shumta, mund të tregojnë për një çështje sistemike.

Shtrirja e aktivitetit të monitorimit dhe shtrirja e gjetjeve

- Shtrirja e aktivitetit të monitorimit nga ku kanë dale gjetjet, përfshirë numrin ose madhësinë e përzgjedhjeve.
- Shtrirja e gjetjeve në lidhje me përzgjedhjen e mbuluar nga aktiviteti i monitorimit, dhe në lidhje me normën e pritshme të devijimit. Për shembull, në rastin e angazhimeve të inspektimit, numri i angazhimeve të përzgjedhura, ku janë identifikuar gjetjet në raport me numrin e përgjithshëm të angazhimeve të zgjedhura, dhe normën e pritshme të devijimit të përcaktuar nga firma

A161 Vlerësimi i gjetjeve dhe identifikimi i mangësive dhe, vlerësimi i seriozitetit dhe përhapjes së një mangësie të identifikuar, përfshirë investigimin rrënjësor të shkaqeve të një mangësie të identifikuar, janë pjesë e një procesi përsëritës dhe jo-linear.

Shembuj që tregojnë se si procesi i vlerësimit të gjetjeve dhe identifikimi i mangësive, vlerësimi mangësive të identifikuara, investigimi rrënjësor i shkaqeve të mangësive të identifikuara, është përsëritës dhe jo-linear

- Për investigimin rrënjësor të shkaqeve të një mangësie të identifikuar, firma mund të identifikojë një rrethanë, e cila ka ngjashmëri me rrethanat e tjera, ku ka patur gjetje që nuk janë konsideruar si mangësi. Si rezultat, firma rregullon vlerësimin e saj për gjetjet e tjera dhe i klasifikon ato si një mangësi.
- Për vlerësimin e seriozitetit dhe të përhapjes së një mangësie të identifikuar, firma mund të identifikojë një tendencë ose një çështje sistemike, e cila lidhet me gjetjet e tjera që nuk janë konsideruar mangësi. Për rrjedhojë, firma korrigjon vlerësimin e saj për gjetjet e tjera dhe gjithashtu, i klasifikon ato si mangësi.

A162. Rezultatet e aktiviteteve të monitorimit, rezultatet e inspektimeve të jashtme dhe informacioneve të tjera përkatëse (p.sh. aktivitetet e monitorimit të rrjetit ose ankesat dhe pretendimet) mund të zbulojnë informacion në lidhje me efektivitetin e procesit të monitorimit dhe korrigjimit të mangësive. Për shembull, rezultatet e inspektimeve të jashtme mund të japin informacion në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë, të pa identifikuar nga procesi i monitorimit dhe korrigjimit të mangësive të firmës, i cili mund të nxjerrë në pah një mangësi në këtë proces.

Vlerësimi i mangësive të identifikuara (Ref: Para. 41)

A163 Për vlerësimin e seriozitetit dhe përhapjes së një mangësie të identifikuar, firma mund mbaje parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Natyrën e mangësisë së identifikuar, përfshirë aspektin e sistemit të menaxhimit cilësisë së firmës, me të cilin lidhet mangësia dhe nëse mangësia është në formë, zbatimin ose funksionim të sistemit të menaxhimit të cilësisë;
- Në rast të mangësive të identifikuara të lidhura me përgjigjet/reagimet, faktin nëse ka përgjigje kompensuese për të adresuar rrezikun e cilësisë me të cilin lidhet përgjigja;
- Shkaqet rrënjësore të mangësisë së identifikuar
- Frekuenca në të cilën ndodh çështja që ka shkaktuar mangësinë e identifikuar; dhe
- Madhësia e mangësisë së identifikuar, sa shpejt ka ndodhur, kohëzgjatja dhe efekti në sistemin e menaxhimit të cilësisë.

A164. Serioziteti dhe përhapja e mangësive të identifikuara ndikon në vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kryer nga individët me përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënie për sistemin e menaxhimit të cilësisë.

Shkaku rrënjësor i mangësive të identifikuara (Ref: Paragrafi 41 (a))

A165. Objektivi i investigimit të shkaqeve rrënjësore (kryesore) të mangësive të identifikuar është të kuptohen rrethanat themelore, të cilat kanë shkaktuar mangësitë, me qëllim që firma të jete në gjendje të:

- Vlerësoje seriozitetin dhe përhapjen e mangësisë së identifikuar; dhe
- Korrigjoje mangësinë e identifikuar në mënyrën e duhur.

Kryerja e një analize rrënjësore të shkaqeve behet nga ata që kryejnë vlerësimin nëpërmjet ushtrimit të gjykimit profesional bazuar në evidencën disponibël.

A166. Natyra, afatet dhe shtrirja e procedurave të ndërmarra për të kuptuar shkakun rrënjësor të një mangësie të identifikuar, mund të ndikohen edhe nga natyra dhe rrethanat e firmës, siç janë:

- Kompleksiteti dhe karakteristikat e funksionimit të firmës.
- Madhësia e firmës.
- Shpërndarja gjeografike e firmës.
- Mënyra si është e strukturuar firma ose shkalla në të cilën ajo përqendron ose centralizon proceset ose aktivitetet.

Shembuj të mënyrës se si natyra e mangësive të identifikuar, serioziteti i tyre i mundshëm dhe natyra e rrethanat e firmës, mund të ndikojnë në natyrën, afatet dhe shtrirjen e procedurave për të kuptuar shkaqet rrënjësore të mangësive të identifikuar

- Natyra e mangësisë së identifikuar: Procedurat e firmës për të kuptuar shkakun rrënjësor të një mangësie të identifikuar mund të jenë më rigorozë në rrethanat kur një raport angazhimi, i lëshuar për një auditim të pasqyrave financiare të një entiteti të pa listuar, ishte i papërshtatshëm ose mangësia e identifikuar lidhet me veprimet dhe sjelljet e lidershit në lidhje me cilësinë.
- Serioziteti i mundshëm i mangësisë së identifikuar: Procedurat e firmës për të kuptuar shkakun rrënjësor të një mangësie të identifikuar, mund të jenë më rigorozë në rrethanat kur mangësia është identifikuar në disa angazhime ose, kur ka një indikacion se politikat ose procedurat kanë norma të larta të papajtueshmërisë.
- Natyra dhe rrethanat e firmës:
 - Në rastin e një firme më pak komplekse dhe me një vendndodhje të vetme, procedurat për të kuptuar shkakun rrënjësor të një mangësie të identifikuar mund të jenë të thjeshta, pasi informacioni për kuptimin mund të jetë i disponueshëm dhe i koncentruar, dhe shkaku rrënjësor mund të jetë i dukshëm
 - Në rastin e një firme më shumë komplekse, me vendndodhje të shumta, procedurat për të kuptuar shkakun rrënjësor të një mangësie të identifikuar, mund të përfshijnë përdorimin e individëve të trajnuar posaçërisht për të investiguar shkakun rrënjësor të mangësive të identifikuar dhe zhvillimin e një metodologjie me procedura më të formalizuara për identifikimin e shkaqeve rrënjësore.

A167 Për investigimin e shkaqeve rrënjësore të mangësive të identifikuara, firma mund të analizoje pse nuk janë shfaqur mangësi në rrethana të tjera, të cilat kanë natyrë të ngjashme me çështjen me të cilën lidhet mangësia e identifikuar. Ky informacion mund të jetë i dobishëm edhe në përcaktimin e mënyrës se si të korrigjohet një mangësi e identifikuar.

Shembull, kur një mangësi nuk ka lindur në rrethana të tjera të një natyre të ngjashme, dhe si ky informacion ndihmon firmën për identifikimin e shkaqeve rrënjësore të mangësive të identifikuara

Firma mund të konstatojë ekzistencën e një mangësie, sepse gjetje të ngjashme kanë ndodhur në disa angazhime. Megjithatë, në disa angazhime të tjera brenda së njëjtës popullatë që testohet, nuk ka gjetje. Duke krahasuar angazhimet, firma arrin në përfundimin se shkaku kryesor i mangësisë së identifikuar është mos përfshirja e duhur e partnerëve të angazhimit në fazat kryesore të angazhimeve.

A168 Identifikimi i një shkaku rrënjësor të përshtatshëm, mund të mbështesë procesin e firmës për të korrigjuar mangësitë e identifikuara.

Shembull i identifikimit të një shkaku rrënjësor të përshtatshëm

Firma mund të identifikojë se grupet e angazhimit, të cilat kryejnë auditime të pasqyrave financiare, nuk po arrijnë të marrin evidencën e nevojshme mbi çmuarjet kontabël, për të cilat supozimet e drejtimit kanë një shkallë të lartë subjektiviteti. Ndërsa firma vëren se këto grupe angazhimi nuk po ushtrojnë skepticizmin e duhur profesional, shkaku rrënjësor baze i kësaj çështjeje mund të lidhet me një çështje tjetër, siç është një mjedis kulturor, i cili nuk inkurajon anëtarët e grupit të angazhimit të pyesin individët me autoritetin më të lartë ose, drejtim, mbikëqyrje dhe rishikim i pamjaftueshëm i punës së kryer për angazhimet.

A169 Përveç investigimit të shkaqeve rrënjësore të mangësive të identifikuara, firma mund të investigojë edhe shkaqet rrënjësore të rezultateve pozitive, pasi në këtë mënyrë ajo mund të zbulojë mundësi për firmën për të përmirësuar më tej sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë.

Përgjigja/reagimi ndaj mangësive të identifikuara (Ref: Para. 42)

A170 Natyra, afatet dhe shtrirja e veprimeve korrigjuese mund të varen edhe nga një sërë faktorësh të tjerë, duke përfshirë:

- Shkaqet rrënjësore.
- Seriozitetin dhe përhapjen e mangësisë së identifikuar dhe urgjencën për adresimin e saj.
- Efektivitetin e veprimeve korrigjuese në adresimin e shkaqeve rrënjësore, siç është fakti nëse firma ka nevojë të zbatojë më shumë se një veprim të korrigjimit të mangësive, në mënyrë që të adresojë në mënyrë efektive shkaqet rrënjësore, ose nëse ajo ka nevojë të zbatojë veprime

përmirësuese, si masa të ndërmjetme, derisa firma të jetë në gjendje të zbatojë veprime me efektive të korrigjimit të mangësive.

A171 Në disa rrethana, veprimi përmirësues mund të përfshijë vendosjen e objektivave shtesë të cilësisë, ose mund të shtohen apo modifikohen rreziqet e cilësisë ose përgjigjet/reagimet ndaj tyre, për shkak se konstatohet se ato nuk janë të përshtatshme.

A172 Në rrethanat kur firma vlerëson se shkakun rrënjësor i një mangësie të identifikuar lidhet me një burim të siguruar nga një ofrues shërbimi, firma gjithashtu, mund të:

- Vlerësojë nëse do të vazhdojë të përdore burimin e ofruar nga ofruesi i shërbimit.
- Komunikojë çështjen tek ofruesi i shërbimit.

Firma ka përgjegjësinë për adresimin e efektit të mangësisë së identifikuar në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë, të lidhur me një burim të siguruar nga një ofrues shërbimi, dhe për marrjen e masave për të parandaluar përsëritjen e mangësive në sistemin e menaxhimit të cilësisë të firmës. Megjithatë, zakonisht firma nuk është përgjegjëse për të korrigjuar mangësitë e identifikuar në emër të ofruesit të shërbimit ose për të investiguar më tej, shkakun rrënjësor të mungesës së identifikuar tek ofruesi i shërbimit.

Gjetjet rreth një angazhimi të veçantë (Ref. Para. 45)

A173 Në rrethanat kur nuk janë kryer procedurat ose, kur raporti i lëshuar është i papërshtatshëm, firma mund të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- Te konsultohet me individët e duhur në lidhje me veprimin e duhur
- Te diskutojë për çështjen me drejtimin e entitetit ose, me personat e ngarkuar me qeverisjen.
- Te kryejë procedurat që nuk janë kryer.

Veprimet e ndërmarra nga firma nuk e çlirojnë firmën nga përgjegjësia për të ndërmarrë veprime të mëtejshme në lidhje me gjetjen, në kontekstin e sistemit të saj të menaxhimit të cilësisë, përfshirë vlerësimin e gjetjeve, për të identifikuar mangësitë dhe, kur ekziston një mangësi, për investigimin e shkakut rrënjësor të mangësisë së identifikuar.

Komunikimi i vazhdueshëm në lidhje me monitorimin dhe korrigjimin e mangësive (Ref: Para. 46)

A174 Informacioni i komunikuar në lidhje me monitorimin dhe korrigjimin e mangësive, për individët që kanë përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë, mund të komunikohet në mënyrë të vazhdueshme ose periodikisht. Individët mund të përdorin informacionet në mënyra të shumta, për shembull:

- Si një bazë për komunikime të mëtejshme me personelin në lidhje me rëndësinë e cilësisë.

- Për ti bere përgjegjës individët për rolet që u janë caktuar atyre.
- Për të identifikuar shqetësimet kryesore, në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë në kohën e duhur.

Informacioni siguron gjithashtu, një bazë për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, dhe konkluzionet përkatëse, siç kërkohet nga paragrafët 53–54.

Kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit (Ref: Paragrafi 48)

A175 Në disa rrethana, firma mund t'i përkasë një rrjeti. Rrjetet mund të vendosin kërkesa në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë së firmës ose, mund të vënë në dispozicion shërbime apo burime, që firma mund të zgjedhë për t'i zbatuar ose përdorur në hartimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të saj të menaxhimit të cilësisë. Këto kërkesa ose shërbime, mund të kenë për qëllim të promovojnë kryerjen në vazhdimësi të angazhimeve cilësore në firmat që i përkasin rrjetit. Shkalla deri në të cilën rrjeti do t'i përcaktojë firmës objektiva të cilësisë, rreziqe të cilësisë dhe përgjigje/reagime, që janë të zakonshme për të gjithë rrjetin, do të varet nga marrëveshjet që firma ka me rrjetin.

Shembuj të kërkesave të rrjetit

- Kërkesat që firma të përfshijë objektiva shtesë të cilësisë, ose rreziqe të cilësisë, në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë, të cilat janë të zakonshme në firmat e rrjetit.
- Kërkesat që firma të përfshijë përgjigjet/reagimet në sistemin e saj menaxhimit të cilësisë, të cilat janë të zakonshme në firmat e rrjetit. Përgjigje të hartuara nga rrjeti janë politikat ose procedurat e rrjetit, që specifikojnë rolet dhe përgjegjësitë e lidërshiptit, përfshirë mënyrën se si pritët që firma të caktojë autoritetin dhe përgjegjësinë brenda firmës ose burimet, siç janë metodologjitë e zhvilluara nga rrjeti, për kryerjen e angazhimeve ose aplikacionet e TI-se.
- Kërkesat që firma t'i nënshtrohet aktiviteteve të monitorimit të rrjetit. Këto aktivitete monitorimi mund të lidhen me kërkesat e rrjetit (p.sh., monitorimi që firma ka zbatuar në mënyrë të përshtatshme metodologjinë e rrjetit), ose sistemin e menaxhimit të cilësisë të firmës në përgjithësi.

Shembuj të shërbimeve të rrjetit

- Shërbimet ose burimet opsionale për firmën për t'u përdorur në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë, ose në kryerjen e angazhimeve, të tilla si programet e trajnimit vullnetar, përdorimi i audituesve të komponentëve ose ekspertëve nga brenda rrjetit, apo përdorimi i një qendre të ofrimit të shërbimeve në nivel rrjeti, ose nga një firmë tjetër e rrjetit apo grupit të firmave rrjet.

A176 Rrjeti mund të vendosë përgjegjësi për firmën, për zbatimin e kërkesave të rrjetit ose shërbimeve të rrjetit.

Shembuj të përgjegjësi për firmën për zbatimin e kërkesave të rrjetit ose shërbimeve të rrjetit

- Firma kërkohet të ketë një infrastrukturë të caktuar të IT-se dhe procese të TI-se, për të mbështetur një aplikim të TI-se, të ofruar nga rrjeti të cilin firma e përdor në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë.
- Firma kërkohet të ofrojë trajnime mbi metodologjinë e ofruar nga rrjeti, përfshirë trajnime në lidhje me përditësimet e metodologjisë.

A177 Njohja dhe kuptimi nga firma, e kërkesave të rrjetit ose shërbimeve të rrjetit dhe i përgjegjësi të saj në lidhje me zbatimin e tyre, mund të merret përmes pyetjeve ose dokumentacionit të siguruar nga rrjeti për çështje të tilla si:

- Qeverisja dhe lidhshipia e rrjetit.
- Procedurat e ndërmarra nga rrjeti në hartimin, zbatimin dhe, nëse është e aplikueshme, funksionimin, kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit.
- Mënyra se si rrjeti identifikon dhe i përgjigjet ndryshimeve që prekin kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit, apo informacione të tjera, të tilla si ndryshimet në standardet profesionale ose informacionet që tregojnë për një mangësi në kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit.

Mënyra se si rrjeti monitoron përshtatshmërinë e kërkesave të rrjetit ose shërbimeve të rrjetit, të cilat mund të përfshijnë kryerjen e tyre përmes aktiviteteve të monitorimit të firmave të rrjetit, dhe proceset e rrjetit për korrigjimin e mangësive të identifikuara.

Kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit në sistemin e menaxhimit të cilësisë së firmës (Ref: Paragrafi 49)

A178 Karakteristikat e kërkesave të rrjetit ose shërbimeve të rrjetit, janë një kusht, ngjarje, rrethanë, veprim ose mosveprim në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të cilësisë.

Shembull i një kërkesë të rrjetit ose shërbimit të rrjetit që krijon një rrezik të cilësisë

Rrjeti mund të kërkojë nga firma që të përdorë një aplikacion të TI-se, i standardizuar në të gjithë rrjetin, për pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientët dhe angazhimet specifike. Kjo mund të krijojë një rrezik të cilësisë pasi aplikacioni i TI-së, mund të mos adresojë çështjet sipas kërkesave ligjore ose rregullatore lokale, të cilat duhet të merren parasysh nga firma në pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientët dhe angazhimet specifike.

A179 Qëllimi i kërkesave të rrjetit mund të jete promovimi i kryerjes në vazhdimësi të angazhimeve cilësore në të gjithë firmat e rrjetit. Firma mund të ketë pritshmëri nga rrjeti, për të zbatuar kërkesat e rrjetit, megjithatë, firma mund të ketë nevojë të përshtatë ose plotësojë kërkesat e rrjetit, në mënyrë që ato të jenë të përshtatshme për natyrën dhe rrethanat e firmës dhe angazhimet e saj.

<i>Shembuj të mënyrës se si kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit mund të përshtaten ose plotësohen</i>	
Kërkesa të rrjetit ose shërbimit të rrjetit	Si i përshtat ose plotëson firma kërkesat e rrjetit ose shërbimin e rrjetit
Rrjeti kërkon që firma të përfshijë, në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë, disa rreziqe të cilësisë, në mënyrë që të gjitha firmat në rrjet të adresojnë rreziqet e cilësisë.	Si pjesë e identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve të cilësisë, firma përfshin rreziqet e cilësisë që kërkojnë nga rrjeti. Firma gjithashtu, harton dhe zbaton përgjigje për të adresuar rreziqet e cilësisë që kërkojnë nga rrjeti.
Rrjeti kërkon që firma të hartojë dhe zbatojë disa përgjigje/reagime.	Si pjesë e hartimit dhe zbatimit të përgjigjeve, firma përcakton: <ul style="list-style-type: none"> • Cilat rreziqe të cilësisë dhe cilat përgjigje /reagime të adresojë. • Mënyrën se si përgjigjet/reagimet e kërkuara nga rrjeti, do të përfshihen në sistemin e menaxhimit të cilësisë së firmës, nisur nga natyra dhe rrethanat e firmës. Kjo mund të kërkojë përshtatjen e përgjigjes, për të pasqyruar natyrën dhe rrethanat e firmës dhe angazhimet e saj (p.sh., përshtatja e një metodologjie, për të përfshirë çështjet që lidhen me ligjin ose rregullin).
Firma përdor individë nga firma të tjera të rrjetit si auditues të komponentit. Rrjeti ka vendosur kërkesa që nxisin një shkallë të lartë të standardizimit në sistemet e menaxhimit të cilësisë të firmave të rrjetit. Kërkesat e rrjetit përfshijnë kritere specifike që zbatohen për individët e caktuar për të punuar në auditimin e një komponenti ose të një grupi	Firma vendos politika ose procedura të cilat kërkojnë që grupi i angazhimit, të konfirmojë me audituesin e komponentit (d.m.th. me firmën tjetër të rrjetit), se individët e caktuar për komponentin përmbushin kriterin specifik të përcaktuar në kërkesat e rrjetit

A180 Në disa rrethana, për përshtatjen ose plotësimin e kërkesave të rrjetit ose shërbimeve të rrjetit, firma mund të identifikojë përmirësime të mundshme për kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit dhe mund t'i komunikojë këto përmirësime me rrjetin.

Monitorimi i aktiviteteve në sistemin e menaxhimit të cilësisë të firmës, të kryera nga rrjeti (Ref: Para. 50 (c))

A181 Rezultatet e aktiviteteve të monitorimit të rrjetit për sistemin e menaxhimit të cilësisë të firmës mund të përfshijnë këto informacione:

- Një përshkrim të aktiviteteve të monitorimit, duke përfshirë natyrën, afatet dhe shtrirjen e tyre;
- Gjetjet, mangësitë e identifikuar, dhe faktet e tjera në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë së firmës (p.sh., rezultatet pozitive ose mundësitë e firmës për përmirësim, apo përmirësim të mëtejshëm, në sistemin e menaxhimit të cilësisë); dhe
- Vlerësimin nga rrjeti, të shkaqeve rrënjësore të mangësive të identifikuar, efektin e vlerësuar të tyre dhe, veprimet korrigjuese të rekomanduara.

Monitorimi i aktiviteteve të kryera nga rrjeti në firmat e rrjetit (Ref: Para. 51 (b))

A182 Informacioni nga rrjeti për rezultatet e përgjithshme të aktiviteteve të monitorimit të rrjetit, të ndërmarra për sistemet e menaxhimit të cilësisë të firmave të rrjetit, mund të jepet në një formë të përmbledhur, siç përshkruhet në paragrafin A181, duke përfshirë tendencat dhe fushat e zakonshme të mangësive të identifikuar në të gjithë rrjetin, ose rezultatet pozitive që mund të përsëriten/replikohen në të gjithë rrjetin. Një informacion i tillë mund të:

- Jete përdorur nga firma:
 - Në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të cilësisë.
 - Si pjesë e informacionit tjetër përkatës, të mbajtur parasysh nga firma për përcaktimin nëse ekzistojnë mangësi në kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit, të përdorura nga firma në sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë.
- Jete komunikuar me partnerët e angazhimit të grupit, në kontekstin e vlerësimit të kompetencës dhe aftësive të audituesve të komponentëve nga një firmë rrjeti, të cilët i nënshtrohen kërkesave të përbashkëta të rrjetit (p.sh., objektivave të përbashkëta të cilësisë, rreziqet e cilësisë dhe përgjigjet/reagimet).

A183 Në disa rrethana, firma mund të marrë nga rrjeti informacion për mangësitë e identifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë të firmës së rrjetit, të cilat kanë ndikim në firmë. Rrjeti gjithashtu, mund të mbledhë informacion nga firmat e rrjetit, në lidhje me rezultatet e inspektimeve të jashtme mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë të firmave të rrjetit. Në disa raste, ligji ose rregulli në një juridiksion të veçantë, mund të pengojë që rrjeti të ndajë informacion me firmat e tjera të rrjetit, ose mund të kufizojë specifikimin e një informacioni të tillë.

A184 Në rrethanat kur rrjeti nuk jep informacion në lidhje me rezultatet e përgjithshme të aktiviteteve të monitorimit të rrjetit, të kryera në firmat e rrjetit, firma mund të ndërmarrë veprime të mëtejshme, të tilla si:

- Te diskutojë çështjen me rrjetin; dhe
- Te përcaktojë efektin e çështjes në angazhimet e firmës dhe, të komunikojë efektin tek grupet e angazhimit.

Mangësitë në kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit të identifikuar nga firma (Ref: Para. 52)

A185 Përsa kohe kërkesat rrjetit ose shërbimet e rrjetit, të përdorura nga firma janë pjesë e sistemit të menaxhimit të cilësisë të firmës, ato gjithashtu, i nënshtrohen kërkesave të këtij SNMC, në lidhje me monitorimin dhe korrigjimin e mangësive. Kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit, mund të monitorohen nga rrjeti, firma ose një kombinim i të dyjave.

Shembull kur kërkesa e rrjetit ose shërbimi i rrjetit monitorohet si nga rrjeti ashtu edhe nga firma

Një rrjet mund të ndërmarrë aktivitete monitorimi në nivel rrjeti për një metodologji të përbashkët. Firma gjithashtu, monitoron aplikimin e metodologjisë nga anëtarët e grupit të angazhimit, përmes kryerjes së inspektimeve të angazhimit.

A186 Për hartimin dhe zbatimin e veprimeve përmirësuese, për të adresuar efektin e mangësisë së identifikuar në kërkesat e rrjetit ose shërbimet e rrjetit, firma mund të:

- Njohe dhe kuptojë veprimet e planifikuara e korrigjimit të mangësive të rrjetit, përfshirë faktin nëse firma ka ndonjë përgjegjësi për zbatimin e këtyre veprimeve përmirësuese; dhe
- Mbaje parasysh faktin nëse nga firma duhet të ndërmerren veprime plotësuese shtesë, për të adresuar mangësitë e identifikuara dhe shkaqet rrënjësore të tyre, siç janë rastet kur:
 - Rrjeti nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura përmirësuese; ose
 - Veprimet korrigjuese të rrjetit, për të adresuar në mënyrë efektive mangësitë e identifikuara, do të kërkojnë kohë.

Vlerësimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë (Ref: Para. 53)

A187 Për kryerjen e vlerësimit, individët që kanë përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë, mund të ndihmohen nga individë të tjerë. Megjithatë, individët që kanë përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë, mbeten përgjegjës dhe llogaridhënës për vlerësimin.

A188 Momenti kohor kur behet vlerësimi, mund të varet nga rrethanat e firmës dhe mund të koincidojë me fundin e vitit fiskal të firmës ose përfundimin e një cikli vjetor të monitorimit.

A189 Informacioni, që siguron bazën për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, përfshin informacionin që i komunikohet individëve, të cilet kanë përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë në përputhje me paragrafin 46.

Shembuj të shkallëzueshmërisë për të treguar se si mund të merret informacioni që jep bazën për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë

- Në një firmë më pak komplekse, individët, të cilëve ju është caktuar përgjegjësia përfundimtare dhe llogaridhënia për sistemin e menaxhimit të cilësisë, mund të jenë të përfshirë drejtpërdrejt në monitorimin dhe korrigjimin e mangësive dhe, për këtë arsye, janë në dijeni të informacionit që mbështet vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë.
- Në një firmë më shume komplekse, individët, të cilëve ju është caktuar përgjegjësia përfundimtare dhe llogaridhënia për sistemin e menaxhimit të cilësisë, mund të kenë nevojë të krijojnë procese për të mbledhur, përmbledhur dhe komunikuar informacionin e nevojshëm, për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Përfundime mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë (Ref: Para. 54)

A190. Në kontekstin e këtij SNMC, është parashikuar që funksionimi i sistemit në tërësi, ta pajisë firmën me sigurinë e arsyeshme, se objektivat e sistemit të menaxhimit të cilësisë janë arritur. Për të konkluduar në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë, individët e caktuar me përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë, për përdorimin e rezultateve të procesit të monitorimit dhe korrigjimit të mangësive, mund të mbajnë parasysh sa vijon:

- Seriozitetin dhe përhapjen e mangësive të identifikuar, dhe efektin mbi arritjen e objektivave të sistemit të menaxhimit të cilësisë;
- Faktin nëse nga firma janë hartuar dhe zbatuar veprimet përmirësuese (te korrigjimit të mangësive) dhe nëse këto veprime të ndërmarra, deri në momentin e vlerësimit, janë efektive; dhe
- Fakti nëse efekti i mangësive të identifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë, ka qenë korrigjuar në mënyrë të përshtatshme, nëse janë ndërmarrë veprime të mëtijshme në përputhje me paragrafi 45

A191. Mund të ketë rrethana kur mangësitë e identifikuar, të cilat janë serioze (përfshirë mangësitë e identifikuar serioze dhe të përhapura) janë korrigjuar në mënyrë të përshtatshme dhe efekti i tyre është korrigjuar në momentin e vlerësimit. Në këto raste, individët e caktuar me përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë mund të konkludojnë që, sistemi i menaxhimit të cilësisë i jep firmës një siguri të arsyeshme se objektivat e sistemit të menaxhimit të cilësisë janë arritur.

A192. Një mangësi e identifikuar, mund të ketë një efekt të përhapur në hartimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë kur, për shembull:

- Mangësia ndikon në disa komponentë ose aspekte të sistemit të menaxhimit të cilësisë.
- Mangësia kufizohet në një komponent ose aspekt të veçantë, të sistemit të menaxhimit të cilësisë, i cili është themelor për sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- Mangësia ndikon në disa njësi biznesi ose vendndodhje gjeografike të firmës.
- Mangësia kufizohet në një njësi biznesi ose një vendndodhje gjeografike, por njësia e biznesit ose vendndodhja e ndikuar, është thelbësore për firmën në përgjithësi.
- Mangësia ndikon në një pjesë thelbësore të angazhimeve që janë të të njëjtit lloji ose natyre.

Shembull i një mangësie të identifikuar që mund të konsiderohet serioze, por jo e përhapur

Firma identifikon një mangësi në një zyrë rajonale të vogël të firmës. Mangësia e identifikuar lidhet me papajtueshmërinë me shumë politika ose procedura të firmës. Firma përcakton se kultura në zyrën rajonale, veçanërisht veprimet dhe sjelljet e lidërsipit në zyrën rajonale, të cilat kanë qenë më shumë të fokusuara në prioritetet financiare, kanë kontribuar në shkakun rrënjësor të mangësisë së identifikuar. Firma përcakton se efekti i mangësisë së identifikuar është:

- Serioz (i rëndë), sepse lidhet me kulturën e zyrës rajonale dhe pajtueshmërinë e përgjithshme me politikat ose procedurat e firmës; dhe
- Jo i përhapur, sepse është i kufizuar në zyrën rajonale, e cila është një zyrë e vogël.

A193. Individët, të cilëve ju është caktuar përgjegjësi përfundimtare dhe llogaridhënia për sistemin e menaxhimit të cilësisë, në rrethanat kur mangësitë e identifikuar janë serioze dhe të përhapura, mund të konkludojnë se sistemi i menaxhimit të cilësisë nuk i jep firmës sigurinë e arsyeshme se do të arrihen objektivat e sistemit të menaxhimit të cilësisë, se veprimet e ndërmarra për të korrigjuar mangësitë e identifikuar nuk janë të përshtatshme, dhe efekti i mangësive të identifikuar nuk është korrigjuar në mënyrë të përshtatshme.

Shembull i një mangësie të identifikuar që mund të konsiderohet serioze dhe e përhapur

Firma identifikon një mangësi në një zyrë rajonale, e cila është zyra më e madhe e firmës dhe i siguron asaj mbështetje financiare, operacionale dhe teknike për të gjithë rajonin. Mangësia e identifikuar lidhet me papajtueshmërinë me shumë politika ose procedurave të firmës. Firma përcakton që kultura në zyrën rajonale, veçanërisht veprimet dhe sjellja e lidërsipit në zyrën rajonale, e cila ka qenë më tepër e fokusuar në prioritetet financiare, ka kontribuar në shkakun rrënjësor të mangësisë së identifikuar. Firma vlerëson se efekti i mangësisë së identifikuar është:

- Serioz, sepse lidhet me kulturën e zyrës rajonale dhe pajtueshmërinë e përgjithshme me politikat ose procedurat e firmës; dhe
- I përhapur, sepse zyra rajonale është zyra më e madhe dhe jep mbështetje për shumë zyra të tjera, dhe papajtueshmëria me politikat ose procedurat e firmës, mund të ketë pasur një efekt më të gjerë në zyrat e tjera.

A194. Korrigjimi i mangësive të identifikuar të cilat janë serioze dhe të përhapura, mund të kërkojë kohë. Me kryerjen në vazhdimësi, të veprimeve për korrigjimin e mangësive të identifikuar, përhapja e mangësive të identifikuar mund të zvogëlohet dhe mund të vlerësohet se mangësitë e identifikuar janë perseri serioze, por jo serioze dhe të përhapura. Në këto raste, individët e caktuar me përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë, mund të nxjerrin përfundimin se, përveçse për çështjet që lidhen me mangësitë e identifikuar, që kanë një efekt serioz por jo të përhapur në hartimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, sistemi i menaxhimit të cilësisë i jep firmës një siguri të arsyeshme se arrihen objektivat e tij.

A195. Ky SNMC nuk kërkon që firma të marrë një raport të pavarur të sigurisë mbi sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë, dhe as e përjashton firmën që ta bëjë këtë.

Kryerja e veprimeve të shpejta dhe të përshtatshme dhe komunikimi i mëtejshëm (Ref: Para. 55)

A196. Në rrethanat kur individët e caktuar me përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë, arrijnë në përfundimin e përshkruar në paragrafin 54 (b) ose 54 (c), veprimet e shpejta dhe të duhura që ndërmerren nga firma mund të përfshijnë:

- Marrjen e masave për të mbështetur kryerjen e angazhimeve, përmes caktimit të më shumë burimeve ose zhvillimin e më shumë udhëzimeve dhe, për të konfirmuar që raportet e lëshuara nga firma janë të përshtatshme për rrethanat, deri në momentin kur mangësitë e identifikuarat të korrigjohen, dhe komunikimin e këtyre masave tek grupet e angazhimit.
- Marrjen e këshillave ligjore.

A197. Në disa rrethana, firma mund të ketë një organ qeverisës të pavarur, i cili kryen mbikëqyrjen jo-ekzekutive të firmës. Në këto rrethana, komunikimet mund të përfshijnë informimin e organit qeverisës të pavarur

A198. *Shembuj të rrethanave kur mund të jetë e përshtatshme që firma të komunikojë me palët e jashtme në lidhje me vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë*

- Kur firma i përket një rrjeti.
- Kur firmat e tjera të rrjetit përdorin punën e kryer nga firma, për shembull, në rastin e një auditimi të grupit.
- Kur një raport i lëshuar nga firma përcaktohet prej saj si i papërshtatshëm, si rezultat i dështimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë, dhe për këtë duhet të njoftohet drejtimi dhe personat e ngarkuar me qeverisjen.
- Kur ligji ose rregulli kërkon që firma të komunikojë me një autoritet mbikëqyrës ose një organ rregullator.

Vlerësimet e performancës (Ref: Para. 56)

A199. Vlerësimet periodike të performancës nxisin llogaridhënien. Për vlerësimin e performancës së një individi, firma mund të mbaje parasysh:

- Rezultatet e aktiviteteve të monitorimit të firmës për aspektet e sistemit të menaxhimit të cilësisë, të cilat lidhen me përgjegjësinë e individit. Në disa rrethana, firma mund të vendosë objektiva për individin dhe i mat rezultatet e aktiviteteve të monitorimit të firmës kundrejt këtyre objektivave.
- Veprimet e ndërmarra nga individi, në përgjigje të mangësive të identifikuarat që lidhen me përgjegjësinë e atij individi, përfshirë afatin dhe efektivitetin e këtyre veprimeve.

Shembuj të zbatimit të shkallëzuar për të demonstruar se si firma mund të kryejë vlerësimet e performancës

- Një firmë më pak komplekse, për të kryer vlerësimin, mund të angazhojë një ofrues shërbimi, ose rezultatet e aktiviteteve të monitorimit të firmës mund të jenë një tregues i performancës së individit.
- Në një firmë më shumë komplekse, vlerësimet e performancës mund të kryhen nga një anëtar jo-ekzekutiv i pavarur, i organit qeverisës të firmës, ose një komitet i posaçëm i mbikëqyrur nga organi qeverisës i firmës.

A200. Një vlerësim pozitiv i performancës, mund të shpërblehet përmes kompensimit, promovimit dhe me stimuj të tjerë, të cilët fokusohen në angazhimin e individit ndaj cilësisë dhe përforcojnë llogaridhënien. Nga ana tjetër, firma mund të ndërmarrë veprime korrigjuese për të adresuar një vlerësim negativ të performancës, i cili mund të ndikojë në arritjen e objektivave të saj të cilësisë.

Konsiderata për sektorin publik

A201. Në rastin e sektorit publik, mund të mos jetë e mundur të bëhet një vlerësim i performancës së individëve, të cilët kanë përgjegjësinë përfundimtare dhe llogaridhënien për sistemin e menaxhimit të cilësisë, ose për të ndërmarrë veprime për të adresuar rezultatet e vlerësimit të performancës, duke pasur parasysh natyrën e emërimit të individit. Sidoqoftë, vlerësimet e performancës perseri mund të ndërmerren për individë të tjerë në firmë, të cilëve ju është caktuar përgjegjësia operacionale për aspektet e sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Dokumentimi (Ref: Para. 57–59)

A202. Dokumentimi siguron evidence se firma është pajtim me këtë SNMC, si dhe me ligjin, rregullin ose kërkesat përkatëse etike. Ai mund të jetë gjithashtu, i dobishëm për trajnimin e personelit dhe të grupeve të angazhimit, pasi siguron për mbajtjen e njohurive organizative dhe një historik të bazës së vendimmarrjes së firmës për sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë. Nuk është as e nevojshme dhe as e mundur që firma të dokumentojë çdo çështje të trajtuar, ose çdo gjykim të bërë, në lidhje me sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë. Për më tepër, pajtueshmëria me këtë SNMC nga firma mund të evidentohet përmes komponenti të saj të informacionit dhe komunikimit, dokumenteve ose materialeve të tjera të shkruara, ose aplikacioneve të TI -së, që janë pjesë përbërëse e sistemit të menaxhimit të cilësisë.

A203. Dokumentimi mund të ketë formën e manualeve të shkruara zyrtare, listave të kontrollit dhe formularëve, mund të jete i dokumentuar në mënyrë informale (p.sh. komunikimi me postë elektronike ose postimi në webfaqe), ose mund të mbahet në aplikacione të TI-së, apo forma të tjera digjitale (p.sh., në bazat e të dhënave). Faktorët që mund të ndikojnë në gjykimet e firmës në lidhje me formën, përmbajtjen dhe shtrirja e dokumentimit, përfshirë shpeshtësinë e aktualizimit të dokumentacionit, mund të jenë:

- Kompleksiteti i firmës dhe numri i zyrave;
- Natyra dhe kompleksiteti i praktikës dhe organizimit të firmës;
- Natyra e angazhimeve që firma kryen dhe natyra e entiteteve, për të cilët kryhen angazhimet;
- Natyra dhe kompleksiteti i çështjes që dokumentohet, siç është fakti nëse ajo lidhet me një aspekt të sistemit të menaxhimit të cilësisë, i cili ka ndryshuar ose një zonë me një rrezik të madh të cilësisë dhe, kompleksiteti i gjykimeve në lidhje me çështjen; dhe
- Frekuenca dhe shtrirja e ndryshimeve në sistemin e menaxhimit të cilësisë.

Një firmë më pak komplekse, mund të mos ketë nevojë për dokumentim për të mbështetur çështjet e komunikuar, sepse metodat e komunikimit joformal mund të jenë efektive. Sidoqoftë, një firmë më pak komplekse mund të vlerësojë si të përshtatshme të dokumentojë këto komunikime, në mënyrë që të sigurojë evidencë që tregon se ato kanë ndodhur.

- A204. Në disa raste, kërkesat për dokumentimin mund të vendosen nga një autoritet i jashtëm mbikëqyrës, si formalisht ose jo formalisht, për shembull, rezultatet e gjetjeve të inspektimit të jashtëm. Kërkesat përkatëse etike mund të përfshijnë gjithashtu, kërkesa specifike për adresimin e dokumentimit, për shembull, Kodi IESBA kërkon dokumentimin e çështjeve të veçanta, përfshirë disa situata që lidhen me konfliktet e interesit, papajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat dhe pavarësinë.
- A205. Nuk kërkohet që firma të dokumentojë vlerësimin e çdo kushti, ngjarjeje, rrethane, veprimi ose mosveprimi për secilin objektiv të cilësisë, ose për çdo rrezik që mund të krijojë një rrezik të cilësisë. Megjithatë, në dokumentimin e rreziqeve të cilësisë dhe të mënyrës se si përgjigjet e firmës adresojnë rreziqet e cilësisë, firma mund dokumentojë arsyet për vlerësimin e dhënë ndaj rreziqeve të cilësisë (d.m.th., ndodhja e vlerësuar dhe efekti në arritjen e një ose më shumë objektivave të cilësisë), në mënyrë që të mbështesë një zbatim dhe funksionim të qëndrueshëm të përgjigjeve.
- A206. Dokumentimi mund të sigurohet nga rrjeti, nga firma të tjera të rrjetit, ose struktura të tjera apo organizatat brenda rrjetit.